

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

10 prill 2009
Prishtinë/Pristina
Ap.-Kz Nr. 371/2008

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, trupi gjykues përbërë nga Gjykatësi Ndërkombëtar Emilio Gatti Kryetari I Trupit Gjykues, Gjykatësit Ndërkombëtar Maria Giuliana Civinini dhe Guy Van Craen dhe Gjykatësi Vendor Miftar Jasiqi dhe Nesrin Lushta si anëtarë të Trupit Gjykues,

Në procedurën penale kundër:

S. K., djali i [redacted] dhe [redacted], lindur më [redacted] në fshatin [redacted], komuna e Malishevës, Kosovar shqiptar, banon në Prizren, Ortokol, [redacted] Komandant RTG2-TML Prizren, Gjeneral brigade, [redacted] akuzohet për krime lufte, Neni 142 i Kodit Penal RFSJ lidhur me Nenin 22, 26 dhe 30 të Kodit Penal të RFSJ, bazuar në aktakuzën me datë 27 korrik 2004, dhe e ndryshuar nga Prokurori Publik më datë 27 korrik 2006.

B. Z. djali i [redacted] dhe [redacted], i lindur më [redacted] në Gjakova/Dakovica, Kosovar Shqiptar, banor i Prishtinës, [redacted] Oficer protokolli, [redacted] Toger Kolonel, [redacted] i akuzuar për krime lufte siç përcaktohet në Nenin 142 të Kodit Penal të RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 26 dhe 30 i Kodit Penal të RFSJ-së, bazuar në aktakuzën e datës 27 korrik 2004, dhe e ndryshuar nga Prokurori Publik më datë 27 korrik 2006.

A. K. djali i [redacted] dhe [redacted], lindur më datë [redacted] në fshatin [redacted] komuna e Rahovec/Orahovac, Kosovar Shqiptar, banor në [redacted] akuzohet për krime lufte siç përcaktohet nga Neni 142 i Kodit Penal të RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 26 dhe 30 të KP të RFSJ-së, bazuar në aktakuzën e datës 28 shkurt 2006, dhe e ndryshuar nga Prokurori Publik më datë 27 korrik 2006.

Vendimi mbi ankesat e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, P nr. 85/2005, data 10 gusht 2006, dënon tre të pandehurit për kryerjen e veprës penale të krimeve të luftës, trajtimin çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha ose cënimin e shëndetit trupor të të burgosurve civilë dhe/ose zbatimin e masave intimiduese dhe të terrorit në shkelje të Nenit 142 të RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 26 dhe 30 të KP të RFSJ-së, ankesa të parashtruara nga avokatët mbrojtës në emër të S. K. më datë 21 mars 2008 dhe më datë 7 prill 2008, në emër të B. Z. më datë 21 mars 2008 dhe në emër të A. K. më datë 20 mars 2008.

Pasi dëgjuam arsyetimin e avokatëve mbrojtës dhe parashtrimet e Z. B. Z. dhe Z. A. K. dhe opinionin dhe kërkesën e Prokurorit Znj. Anette MILK në seancën e mbajtur më datë 1 prill 2009 dhe pas shqyrtimit dhe votimit më datë 1 dhe 10 prill 2009.

Në bazë të Nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) marrim këtë

AKTGJYKIM

Ankesat e paraqitura në dobi të S. K. më datë 21 mars 2008 dhe 7 prill 2008 PRANOHEN pjesërisht në lidhje me dënimin i cili është ulur në gjashtë vjet burgim.

Ankesa e paraqitur në dobi të B. Z. më datë 21 mars 2008 PRANOHET pjesërisht në lidhje me kohëm e kryerjes së veprave penale, e cila kufizohet në periudhën midis 2 qershorit dhe 31 gushtit 1998 dhe në lidhje me dënimin, i cili zvogëlohet deri gjashtë vjet brugim.

Ankesa e paraqitur në dobi të A. K. më datë 20 mars 2008 PRANOHET pjesërisht në lidhje me kohën e kryerjes së veprave penale, e cila kufizohet në periudhën midis 2 qershorit dhe 31 gushtit 1998 dhe në lidhje me dënimin, i cili zvogëlohet deri katër dhe gjashtë muaj burgim.

Në bazë të Nenit 50 të KP të RFSJ-së, koha e kaluar në paraburgim nga secili i pandehur llogaritet në dënim.

Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë konfirmohet për pjesët e mbetura.

Shpenzimet e procedurës së shkallës së dytë mbeten në ngarkim të Buxhetit të Shtetit.

Në pajtim të Nenit 26 dhe 393 të KPPK është marrë vendim i veçantë në lidhje me paraburgimin e secilit prej të pandehurve.

ARSYETIMI

A. Historiku procedural

1. Prokurori Publik Ndërkombëtar ngri aktakuzë më datë 11 shkurt 2005 kundër S [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] Z [REDACTED] dhe të pandehurve të tjerë; ata akuzohen për Krime Luftë kundër Popullatës Civile dhe kjo aktakuzë është parashtruar në katër pika në lidhje me të burgosurit në qendrën e paraburgimit në fshatin Dranovc/Drenovac në Zatriq, Komuna e Rahovecit/Orahovac.

Pretendimet kishin të bëjnë me arrestimet e paligjshme, burgosjen e paligjshme, rrahjen, torturat dhe vdekjen e Kosovarëve Shqiptarë.

Për dy të pandehurit aktakuza u konfirmua me vendimin e datës 21 maj 2005.

A [REDACTED] K [REDACTED] ishte jashtë Kosovës në kohën e fillimit të hetimit por u ekstradua në Kosovë dhe u arrestua më datë 9 dhjetor 2005.

Prokurori Ndërkombëtar ngri aktakuzë më datë 28 shkurt 2006 për kryerjen e Krimeve të Luftës në katër pika, qendra e paraburgimit e lartpërmendur.

Pretendimet kishin të bënin me arrestimin e paligjshëm dhe/ose burgosjen, trajtimin çnjerëzor, rrahjen, torturat si dhe vrasjen e Kosovarëve Shqiptarë.

Gjykatësi konfirmues konfirmoi pothuajse tërësisht aktakuzën; ai rrëzoi akuzën e vrasjes dhe akuzave të tjera në lidhje me disa prej viktimave.

2. Lënda kundër A [REDACTED] K [REDACTED] u konsolidua me gjykimin kryesor kundër S [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] Z [REDACTED] dhe të pandehurve të tjerë.

Ky gjykim filloi më datë 29 shtator 2005 dhe mbaroi më datë 10 gusht 2006.

Në seancën e 27 korrikut 2006, Prokurori ndryshoi aktakuzën e tij kundër S [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] Z [REDACTED], A [REDACTED] K [REDACTED] dhe një të pandehuri të katërt, duke i akuzuar ata me një pikë të Krimeve të Luftës, atw të trajtimit çnjerëzor.

Gjatë së njëjtës seancë Prokurori tërhoqi të gjitha akuzat kundër dy të pandehurve të tjerë. Vendimi u shqiptua në seancën e datës 10 gusht 2006.

Tre të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] Z [REDACTED] dhe A [REDACTED] K [REDACTED] u shpallën fajtorë për kryerje të Krimeve të Luftës "trajtimi çnjerëzor dhe vuajtja e madhe ose cënimi i shëndetit trupor të të burgosurve civilë dhe kjo përbënte zbatimin masave intimiduese dhe të terrorit në kundërshtim me Nenin 142 të KP të RFSJ-së në lidhje me Nenin 2, 26 dhe 30 të KP të RFSJ-së" dhe dënoi secilin me shtatë (7) vjet burgim.

A [REDACTED] K [REDACTED] u lirua nga akuza në lidhje me një viktimë.

Edhe i pandehuri i katërt (I [REDACTED] G [REDACTED]) u lirua, ndërsa në lidhje me dy të pandehurit e tjerë (X [REDACTED] E [REDACTED] dhe I [REDACTED] G [REDACTED]) akuzat u hodhën meqenëse Prokurori kishte tërhequr të njëjtat aktakuza.

3. S [REDACTED] K [REDACTED] dhe B [REDACTED] Z [REDACTED] u arrestuan më datë 16 shkurt 2004 dhe që atë datë u mbajtën në paraburgim.

Ata u liruan nga Gjykata e Qarkut me vendimin e datës 10 gusht 2006 por, pas një ankese të Prokurorit Publik Ndërkombëtar, Gjykata Supreme e Kosovës më datë 2 shtator 2006

ktheu mbrapsht vendimin e gjykatës të shkallës së parë dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të dy të pandehurve derisa vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

A. K. [REDAKTUAR], siç u tha më lart, u arrestua më datë 9 dhjetor 2005, kur u ekstradua nga Zvicra dhe që atëherë është mbajtur në paraburgim.

4. Avokatët mbrojtës të të tre të dënuarve parashtruan ankesën siç vijon, kundër vendimit.

Ankesa e [REDAKTUAR] nga Mitrovica, avokat mbrojtës i të pandehurit S. K. [REDAKTUAR] u paraqit më datë 21 mars 2008 dhe më datë 7 prill 2008 paraqiti pjesën plotësuese të ankesës.

Ankesa e [REDAKTUAR] nga Prizreni, avokat mbrojtës i të pandehurit B. Z. [REDAKTUAR] u parashtrua më datë 21 mars 2008.

Ankesa e [REDAKTUAR] nga Prishtina, avokat mbrojtës i të pandehurit A. K. [REDAKTUAR] u ngrit më datë 20 mars 2008.

5. Pas transferimit të lëndës tek Gjykatësit e EULEX-it në janar të 2009, Gjykata Supreme e Kosovës caktoi seancën ankimore në datë 1 April 2009, ku pas raportimit të gjykatësit raportues, të pandehurit dhe avokatësit të tyre mbrojtës spjeguan ankesat e tyre dhe Prokurori Ndërkombëtar u përgjigj siç është shënuar në procesverbalin e mbajtur.

6. Shqyrtimi i vendimit u mbajt nga Gjykata më datën 1 dhe 10 prill 2009.

B. Çështjet e ngritura nga Pala ankuese

I

Faza paraprake është e nevojshme për të shqyrtuar disa pika kryesore të cilat janë të përbashkëta për të tre ankesat ose ata duhet të hetohen sipas detyrës zyrtare.

1. Aktualisht e para u ngrit vetëm nga avokati mbrojtës i B. Z. [REDAKTUAR], por ajo përfshin një vlerësim i cili, sipas Nenit 419 KPPPK është i aplikueshëm edhe për dy të pandehurit e tjerë në lidhje me një çështje e cila duhet të ishte hetuar sipas detyrës zyrtare.

Avokati mbrojtës i B. Z. [REDAKTUAR] është i mendimit se vendimi i shkallës së parë është dhënë në shkelje të ligjit nga një gjykatës (kryetari i trupit gjykues Z. Vinod Boolell dhe një pjesëtar tjetër i trupit gjykues, Z. Nurul Khan) i cili në bazë të Nenit 40.2 nr.1 KPPPK-së nuk mund të bënte pjesë në Trupin Gjykues meqënëse ai kishte qenë përkatësisht, Kryetar i Trupit Gjykues dhe anëtar i trupit Gjykues të përbërë nga tre gjykatës i cili gjatë fazës së procedurës paraprake vendosi për vazhdimin e masës së

paraburgimit kundër B. Z. Gjykatës Boolel kishte aprovuar gjithashtu kërkesën e Prokurorit Publik për zgjatjen e periudhës kohore për të ngritur aktakuzën. Kjo çështje duhet të hetohet sipas detyrës zyrtare në pajtim me Nenin 415 paragrafi 1 pika 1 KPPPK, i cila i referohet shkeljeve të mundshme të dispozitave të procedurës penale paraprakë nga Neni Art. 403.1 nr.1 dhe 2 të të njëjtit kod. Kjo ka të bëjë me përbërjen e duhur të trupit gjykues (nr.1) dhe përjashtimi i gjykatësit nga gjykimi kryesor për arsye të diskualifikimit.

Në përgjigjen e tij Prokurori kërkon përjashtimin e kësaj pike dhe informon Trupin Gjykues se gjithashtu anëtari i tretë i Trupit Gjykues të Shkallës së Parë, gjykatës Leonard Assira, ishte në të njëjtën situatë, i cili ka marrë pjesë në marrjen e vendimit për zgjatjen e masës së paraburgimit dhe zgjatjen e periudhës kohore për të ngritur aktakuzën.

Trupi Gjykues i Shkallës së Dytë është i mendimit se kjo shkelje nuk ekziston dhe se Trupi Gjykues i Gjykatës së Qarkut Prizren ishte ngritur ligjërisht për të gjykuar çështjen e kësaj procedure.

Çështja është shqyrtuar dhe u morr gjithashtu një vendim nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit më datë 4 gusht 2005 në bazë të një kërkesë të Prokurorit.

Vendimi i marrë hodhi poshtë këtë kërkesë.

Arsyet e këtij vendimi dhe argumentet e paraqitura sot para këtij Trupi Gjykues janë bindës.

Duhet të theksohet fakti se aktiviteti i këtyre gjykatësve gjatë fazës së procedurës paraprake është zhvilluar në pajtim me ligjin procedural të RFSJ në fuqi para KPPPK-së.

Gjykatësit, të cilët më vonë u bënë anëtarë të Trupit Gjykues nuk kanë ushtruar funksionin e Gjykatësit hetues të atij ligji procedural.

Hapat ligjorë të ndërmarra në bazë të ligjit të mëparshëm nuk kishin të bëjnë as me vetë lëndën dhe nuk kishin të bënin me mbledhjen provave.

Vendimi për zgjatjen e periudhës kohore për të ngritur aktakuzën nuk thotë asnjë fjalë mbi vetë lëndën dhe kufizohet vetëm në vlerësimin e arsyeve të paraqitura nga Prokurori, se kjo lëndë është shumë komplekse dhe nevoja për të përpiluar saktësisht aktakuzën; zgjatja kohore me pesëmbëdhjetë ditë.

Për më tepër këta gjykatës nuk morrën pjesë në seancën për konfirmimin e aktakuzës.

Me fjalë të tjera aktiviteti i tyre nuk mund të konsiderohet si "pjesëmarrje gjatë procedurës të fazës paraprake" për arsye se këtu nuk kemi ushtrim të funksioneve specifike të gjykatësit të procedurës paraprake.

Vendimi i Trupit Gjykues të përbërë nga tre anëtarë mbi zgjatjen (pushimin) e paraburgimit u morr në bazë të kodit të mëparshëm dhe gjithashtu në bazë të KPPPK-së është një aktivitet i veçantë mbi çështjen e sigurisë e cila bie jashtë një faze specifike të procedurës.

Sipas të dyjave dispozitave ky aktivitet nuk është paraprakë vetëm për fazën e procedurës paraprake por gjithashtu edhe në faza të tjera, si ajo pas shqiptimit të vendimit të shkallës së parë (Neni 353.4 LPP të RFSJ-së dhe Neni 393.3 KPPPK) dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet si "fazë e procedurës paraprake".

Si përfundim vlerësimi i bazave për paraburgim dhe vendimi i plotfuqishëm në një lëndë janë objekt vlerësimesh të ndryshme, siç janë pranuar edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Hauschildt v. Denmark, 10486/83 [1989] ECHR 7, 24 maj 1989). Për këtë arsye vendimi për të mos përjashtuar këta gjykatës nga trupi gjykues ishte korrekt.

2. Një pikë e dytë e përgjithshme e cila duhet të diskutohet paraprakisht është nëse në një kohë relevante në Kosovë, ose më mirë në një pjesë të Kosovës ku pretendohet se ka ekzistuar një konflikt i brendshëm i armatosur, *condition sine qua non* e mundësisë për të akuzuar të pandehurit për krime lufte.

Kjo çështje është ngritur nga tre ankesat në bazë të aspektit se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë mund të përmbante shkelje të ligjit penal kur merret në konsideratë ekzistenca e këtij konflikti të brendshëm të armatosur.

Avokati mbrojtës i S. K. supozon se në atë kohë në rajonin Drenovc region UCK nuk kishte një organizim qendror dhe një strukturë komanduese, dhe se dëshira e të gjithë shqiptarëve për të konsideruar veten si pjesë e UCK është e pamjaftueshme: në atë kohë deri në tetor 1998 ishin të pranishëm vetëm grupe rebelësh. Avokati mbrojtës i B. Z. pretendon shkelje të ligjit në kohë lufte për arsye të mungesës së elementëve bazë të një krimi lufte sepse asnjë nga viktimat e supozuara i përkiste palës kundërshtarë, meqënëse të gjithë ishin Kosovarë shqiptarë.

Avokati mbrojtës i A. K. pretendon:

- mungesën e një konflikti të brendshëm në kohën kritike në atë pjesë të Kosovës;
- mungesë e një organizimi qendror dhe e një strukture komanduese të UCK-së në vendin ku ndodhën faktet.

Gjykata e Shkallës së Parë e ngriti këtë në faqet 21 deri 52, dhe përdori faqet në vazhdim për të shqyrtuar përfshirjen konkrete të të gjithë të pandehurve gjatë konfliktit të armatosur dhe në veprat penale.

Kjo Gjykatë është e mendimit se provat e mbledhura në dosjen e lëndës mbështesin vendimin e gjykatës të shkallës së parë.

2.1 Siç është kujtuar saktësisht nga Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ekzistenca e një konflikti të armatosur të brendshëm vendoset në vazë të vlerësimit të çdo rasti dhe nëse ekziston prova positive e a) konfliktit të zgjatur të armatosur, b) organizimit të grupit të armatosur i cili lufton kundër forcave kombëtare të armatosura dhe c) nivelit të armiqësisë i cili i tejkalon karakteristikat e çrregullimeve të brendshme, trazirave dhe akteve kriminale të kufizuara dhe sporadike.

Ky test është i përgjithshëm për jurisprudencën ndërkombëtare dhe mbështetet në traktate ndërkombëtare si Protokollin Shtesë II i Konventave të Gjenevës (neni 1).

Përsa i përket intensitetit të konfliktit të armatosur kriteret e aplikuar nga gjykatësi i shkallës së parë duken të sakta si teorikisht ashtu edhe faktikisht.

Pesha dhe rritja e sulmeve, përhapja e konfliktit në territor dhe kohë, rritja e numrit të pjesëmarrësve nga të dyja anët, rritja e furnizimit me armë, municion dhe pajisjeve ushtarake, vëmendja që Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara i kushtoi konfliktit janë të gjitha kritere të cilat, nëse përmbushen siç duhet, përcaktojnë peshën dhe zgjatjen e një konflikti i cili shkon shumë më larg se episode të çregullimit të brendshëm apo trazirave.

Në fakt gjykata e shkallës së parë ka treguar saktësisht ekzistencën e një konflikti të brendshëm të armatosur të gjatë dhe serioz gjatë shtatë muajve të parë të 1998 midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në një anë dhe Republikës së Serbisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë të mbështetura nga ushtria e tyre dhe nga forcat ushtarake Serbe në anën tjetër.

Ky pretendim mbështetet në një sasi të madhe provash të ndryshme (dëshmi të të pandehurve, dokumente publike, komunikata të Shtabit Qendror të UÇK-së, raporte të OSBE-së dhe të organizatave jo-qeveritare, Rezoluta të KStë OKB-së, vendime të TPNJ-së).

Vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë nuk kundërshtohet në këtë pjesë nga mbrojtja e A. K. i cili pranon se “nga 01.05.1998 dhe më tej në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur, se ky konflikt ishte në Drenica dhe Decani në kufi me Shqipërinë” (ankesa në favor të A. K. faqet 6 dhe 7 versioni anglisht). Mbrojtja kundërshton vendimin në lidhje me shtrirjen e konfliktit në rajonin e Drenovc në kohën kritike, me fjalë të tjera kjo parashtrohet se pari një problem gjeografik dhe pastaj një problem juridik.

Mbrojtja e S. K., në të kundërtën, kundërshton ekzistencën e një konflikti të armatosur në kohën kritike për një arsye tjetër, ajo e mungesës së organizimit të mjaftueshëm të grupeve të armatosura të UÇK-së.

Në paragrafin e vijues do të shqyrtojmë nëse kjo ka të bëjë me organizimin e UÇK-së. Ky Trup Gjykues do të vërejë se, në rast se konflikti i brendshëm ekziston, Ligji Humanitar Ndërkombëtar aplikohet në të gjithë territorin e Shtetit.

Kjo për arsye se i gjithë territori mund të jetë subjekt i operacioneve ushtarakedhe në çdo pjesë të territorit mund të ndodhin sjelljet e ndryshme dhe fakte të cilat arsyetojnë mbrojtjen e kërkuar.

Në përgjithësi kampet e përqendrimit dhe burgjet janë larg zonës ku luftohet. Kjo bëhet për arsye sigurie edhe për autoritetet edhe për të burgosurit vetë; nëse dikush është rob lufte ai duhet të mbahet larg zonës së luftës.

Për më tepër neni 5 i APII parasheh që qendrat e burgimit të mos janë “afër zonës së luftës”.

Qëllimi i këtij neni është që të mbrohen nga rreziqet e konfliktit njerëzit që ndodhen në një situatë të vështirë.

Pra nuk është logjike që të pretendohet se një krim lufte që ka lidhje me drejtimin e një burgu të ekzistojë vetëm në vende ku lufta po zhvillohet aktualisht.

Në këtë kuptim shikoni vendimin e Zyrës 2 të Ankesave të TPNJ-së në lëndën Prokurori kundër Dusko TADIC¹.

“68. Megjithëse Konventat e Gjenevës nuk thonë asgjë në lidhje me qëllimin gjeografik të "konfliktit të armatosur" ndërkombëtar, dispozitat sugjerojnë se të paktën disa nga dispozitat e Konventave janë të aplikueshme në të gjithë territorin e Palëve në konflikt, dhe jo vetëm në afërsi të veprimeve ushtarake. Sigurisht që disa nga dispozitat kanë të bëjnë me konfliktin dhe qëllimi gjeografik i këtyre dispozitave duhet të jetë i kufizuar. Disa të tjera, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e robërve të luftës dhe civilëve, nuk janë aq të kufizuara. Në lidhje me robërit e luftës Konventa vlen për luftëtarët e palës armike; nuk ka ndonjë ndryshim nëse ata mbahen afër zonës së luftimeve. Në të njëjtën linjë Konventa IV e Gjenevës mbron civilët kudo që të jenë në Territorin e Palëve...

69. Kuadri gjeografik i përkohshëm në lidhje me konfliktet e brendshme të armatosura është gjithashtu i gjerë. Ky koncept pasqyrohet në faktin se ata që përfitojnë nga Neni 3 i Konventave të Gjenevës janë personat që nuk marrin pjesë në mënyrë aktive (apo që nuk marrin pjesë tashmë në mënyrë aktive) në konflikt.

Kjo tregon se rregullat e Nenit 3 aplikohen gjithashtu jashtë kontekstit të ngushtë gjeografik të arenës së operacioneve luftarake. Në të njëjtën mënyrë e njëjta gjuhë e përdorur në Protokollin II të Konventave të Gjenevës (një traktat i cili, siç do të shikojmë në paragrafet e mëposhtme 88 dhe 114, mund të shihet si i aplikueshëm për disa aspekte të konflikteve në ish-Jugosllavi) sugjeron gjithashtu një shtrirje të gjerë.

...
Nexusi që kërkohet është vetëm një lidhje midis konfliktit dhe privimit nga liria, dhe jo se privimi nga liria duhet të ketë ndodhur në mes të betejës.

70. Në bazë të të lartpërmendurës konkludojmë se një konflikt i armatosur ekziston kurdo kur kemi përdorimi forcave të armatosur midis Shteteve apo një dhunë nëpërmjet armëve e zgjatur midis autoriteteve qeverisës dhe grupeve të organizuara të armatosura ose midis grupeve të tilla brenda një Shteti. Ligji Humanitar Ndërkombëtar është i aplikueshëm që nga fillimi i një konflikti të tillë të armatosur dhe që vazhdon edhe pas mbarimit të konfliktit derisa është marrë një vendim i përgjithshëm për paqe; ose, në rast konflikti të brendshëm, derisa është arritur një marrëveshje paqësore. Deri në atë moment, është në zbatim ligji humanitar ndërkombëtar në të gjithë territorin e Shteteve ndërluftuese, apo në rastin e konflikteve të brendshme, i gjithë territori që është nën kontroll të një pale, pa marrë parasysh nëse luftimet po ndodhin atje apo jo.

...
Edhe nëse në rajonin Prijedor nuk kishte konflikte të rëndësishme në kohën dhe vendin ku pretendohet se janë kryer veprat penale – një çështje faktike të cilën Dhoma e Ankesave nuk e trajton – në këtë rast vlen ligji humanitar ndërkombëtar. Është i

¹ Prokurori kundër v. Dusko TADIC, 2 tetor 1995 vendim mbi kërkesën e mbrojtjes për ankesë mbi Juridiksionin.

njaftueshëm fakti se krimet e pretenduara kishin lidhje të ngushtë me konfliktin në pjesë të tjera të territorit nën kontrollin e palëve të konfliktit.

Në lëndën Kunara² Dhoma e Ankesave të TPNJ-së konfirmon:

“64 ... Gjendja e konfliktit të armatosur nuk kufizohet në zonat ku aktualisht ka luftime por është në të gjithë territorin nën kontrollin e palëve ndërluftuese”.

Rastësisht dhe në kontrast me opinionin e avokatit mbrojtës të A. K. (faqja 15 versioni anglisht), vihet re se vendimet e TPNJ-së kanë të bëjnë edhe me konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe ato të brendshme.

Në lëndën e përmendur Prokurori kundër Dusko TADIC Zyra e Ankesave pohon juridiksionin e saj në lidhje me shkeljet e ligjeve apo rregullave të luftës (neni 3 i Statutit të TPNJ-së) dhe mbi krimet kundër njerëzimit (neni 5) “pa marrë parasysh nëse ata kanë ndodhur gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar apo të brendshëm” (paragrafi 137).

Në lidhje me situatën faktike të zonës Drenovc mund të shtohet se edhe atje gjatë periudhës kritike kanë ekzistuar operacione ushtarake, siç ka pohuar i pandehuri S. K. kur ai pranon se herën e parë ka shkuar në Drenovc më datë 28 prill 1998 sepse kishte dëgjuar se atje kishte pasur luftime midis forcave serbe dhe UÇK-së.

Ai u kthye në Drenovc më datë 5 maj dhe ka ndenjur atje të paktën deri në korrik sepse ai “kishte dëgjuar se atje ndodhnin shpesh luftime” (deklaratë e dhënë në polici më datë 17 shkurt 2004) dhe se ai donte të ishte në “vendin ku po ndodhnin këto luftime”, duke shtuar se në muajt maj dhe qershor nuk kishte pasur luftime saktësisht në Drenovc por në fshatrat përreth (gjatë shqyrtimit kryesor më datë 21 qershor 2006 faqja 11).

Drenovc dhe Zatriq janë dy fshatra të vegjël afër njëri tjetrit dhe i pandehuri pranon se Zatriq ishte një zonë strategjike ushtarake.

Më vonë kjo zonë u shndërrua në vendin e ofensivës masive serbe në mes të korrikut 1998, periudhë e cila përkon me atë të akuzave.

E. R. (seanca e 15 dhjetorit 2005) kujton të ketë qenë duke hapur istikame midis marsit dhe prillit për të mbrojtur Drenovcin.

Dëshmitarë të tjerë (M. B., “D”, “TT”, “X”, K. P.) kanë treguar mbi luftimet në Drenovc dhe në zonat përreth gjatë kohës kritike, mbi humbjen e shumë jetëve dhe mbi pasojat e ofensivës serbe në mes të korrikut, ashtu siç është përmendur saktësisht në vendimin e kundërshtuar.

2.2 Veçanërisht në lidhje me kërkesat e organizimit të forcave të armatosura të kryengritësve që luftonin kundër forcave kombëtarë të armatosura Protokollin Shtesë II i Konventave të Gjenevës i 1949 parasheh që këto grupe a) të jenë të organizuara dhe b) të veprojnë nën një komandë përgjegjëse, c) të ushtrojnë kontroll mbi një pjesë të territorit, d) domethënë ata janë në gjendje të kryejnë operaione ushtarake të përbashkëta të pandërprera dhe e) të zbatojnë Protokollin.

² Zyra e Ankesave të TPNJ-së 12 qershor 2002, Prokurori kundër Dragoljub KUNARAC, Radomir KOVAC dhe Zoran VUKOVIC, shiko <http://www.icty.org/x/cases/kunarac/acjug/en/kun-aj020612e.pdf>.

Ankesa thekson se në zonën Drenovc gjatë muajve nga maji në gusht 1998 nuk ka ekzistuar ndonjë organizim qendror apo ndonjë strukturë komanduese e UÇK-së: personat atje mund të përcaktohen vetëm si grupe rebele dhe për këtë arsye LHN, dhe veçanërisht AP II nuk do të ishin të aplikueshëm.

Kjo vërejtje nuk është e bazuar dhe nga ana tjetër, nuk është konsekuente nëse i lexojmë me vëmendje dispozitat ligjore.

Në përgjithësi: organizimi, komanda përgjegjëse, mbajtja nën kontroll e një pjese të territorit, operacione ushtarake të përbashkëta dhe të pandërprera dhe aftësia për të implementuar LHN; të gjitha këto janë kërkesa që kanë të bëjnë grupin e armatosur në tërësi: prania e këtyre kërkesave është *conditio sine qua non* e ekzistencës të një konflikti të brendshëm të armatosur.

Logjikisht kontrolli që ushtron një grup i armatosur duhet të ekzistojë vetëm në një pjesë të territorit të një Shteti, përndryshe nuk do të kishte ndonjë konflikt nqs i gjithë territori do të ishte nën kontrollin e një pale të vetme.

Disa operacione ushtarake kryhen në pjesë të territorit kombëtar të cilat janë nën kontrollin e palës kundërshtare, nga forcat me strukturë të kufizuar komanduese.

Ndonjëherë një grup ushtarak ushtron kontroll në një zonë vetëm përkohësisht.

Ndonjëherë në zona periferike nën kontrollin e një pale, struktura komanduese kufizohet vetëm me elementë thelbësore dhe furnizimi me armë dhe mjete ushtarake të pamjaftueshme.

Megjithatë, këto fakte dhe situata të tjera të ngjashme nuk mund të kufizojnë zbatimin e LHN vetëm në ato pjesë të territorit ku të gjitha kërkesat e një grupi të armatosur janë të pranishme në të njëjtin nivel dhe në të njëjtën kohë.

Gjykata e shkallës së parë ka cituar saktësisht jurisprudencën ndërkombëtare³ mbi pamjaftueshmërinë e një shkalle organizimi nga një grup i armatosur kryengritësish, i cili nuk kërkon një sistem të plotë dhe hierarkik ushtarak si në rastin e forcave të armatosura të rregullta.

Ekzistenca e “zonave të lira”, ku janë të pranishme vetëm forcat e armatosura dhe popullsia civile e një prej palëve në konflikt dhe ku trupat armike nuk guxojnë të futen, është domethënëse.

Në ato zona autoritetet shtetërore nuk janë më të pranishme dhe autoriteti është në duart e kryengritësve.

Vihet re se, përveç se pretendohet se në atë zonë nuk kishte asnjë lloj organizmi, ankimesit nuk pohojnë se njësitë e UÇK-së në Drenovcë ishin plotësisht të pavarura, vareshin vetëm nga vetvetja dhe se ata nuk u bindeshin urdhrave që vinin nga komanda e përgjithshme.

2.3 Në fakt vërejtjet e mbrojtjes nuk janë të bazuara.

³ Musema, TPNR Vendimi I shqyrtimit kryesor, 27 janar 2000, Lënda nr. ICTR-96-13-T, paragrafi 257.

Nga dokumentet e paraqitura nga Prokurori (prova nr. 15 në dosjen nr. XVII) rezulton ekzistenca e një Shtabi të Përgjithshëm të UÇK-së që në fillim të 1998. Ekzistenca e një Shtabi të Përgjithshëm shihet si një nga elementët më të rëndësishëm të një organizate ushtarake.

Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka lëshuar komunikata që në shkurt të 1998 për operacione ushtarake, sulme kundër forcave serbe, likuidime bashkëpunëtorësh.

Në këto komunikata UÇK-ja ka deklaruar shpesh se është e gatshme dhe në gjendje të respektojë traktatat ndërkombëtare, Konventat e Gjenevës dhe Konventat në fuqi gjatë kohës së luftës.

Siç kërkohet nga neni 1 i APII organizimi i një grupi të armatosur duhet t'i japë mundësi atij grupi që të zbatojë LHN.

Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së shprej vullnetin e tij për të zbatuar këtë të fundit.

Raportet e Zyrës së Prokurorit të TPNJ-së, shkurt 1999⁴ i referohen hetimeve të zhvilluara midis anëtarëve të UÇK-së me rezultatet e raportuara në dënimin e kundërshtuar (faqja 49) mbi aftësinë e UÇK-së që në fund të 1997 të "fillojë operacione të koordinuara në një zonë të gjerë, e cila tregon një shkallë të lartë të organizimit". Numri i anëtarëve të UÇK-së u rrit nga afërsisht 500 në fillim të 1998 në "disa mijëra në verë" (12 dhe 20.000).

"Në fund të qershorit 1998, një vëzhgues ndërkombëtar me përvojë në Kosovë vuri re se UÇK-ja kishte krijuar një strukturë me një nivel të dallueshëm komandues dhe se policia ushtarake e UÇK-së kishte nën kontroll rrugë dhe se dispononte shtabe".

"Para fillimit të ofensivës serbe/RFJ në fund të korrikut 1998, UÇK-ja kishte nën kontroll pjesë të rëndësishme të zonave kryesore të Kosovës, nga zona e Drenicës deri në jug Malishevë".

Faktet e përmendura konfirmohen në një Raport të Human Right Watch në 1999, i cili përmend se 40% i territorit të Kosovës kontrollohej nga UÇK-ja nga prilli deri në mes të korrikut 1998.

Mbrojtja kundërshton besueshmërinë e informatave të siguruar nga media dhe organizatat joqeveritare për shkak të pasigurisë së burimeve të tyre.

S. K. e konsideron si të ekzagjeruar shifrën 40%, por megjithatë pohon ekzistencën e territoreve nën kontrollin e UÇK-së, të ashtuquajturat "zona të lira". Për shembull në Drenicë, sipas këtij të pandehuri, ekzistonte një "organizim i konsoliduar"⁵.

Fakti se gjatë kohës kritike UÇK-ja mund të kishte pasur nën kontroll zona të gjera të Kosovës deklarohet nga dëshmitarë dhe të pandehur dhe nga Raporti i Zyrës së Prokurorit të TPNJ-së më datë 2 gusht 2004⁶ i cili mbledh informacion nga burime serbe, burime të UÇK-së dhe të ato të vëzhgimit.

⁴ Prova nr. 15e,

⁵ Shiko Procesverbalin e dates of 21 qershor 2006 faqja 12.

⁶ Prova nr 15.

Përveç pikave të cituara në Vendimin e Shkallës së Parë (faqja 50) mbi intensitetin, zgjatjen dhe zgjerimin e konfliktit të armatosur mes Janarit dhe Shtatorit 1998, duhet të vërehet ajo që Forcat Serbe kanë raportuar në mes të Majit 1998 në lidhje me përbërjen e UCK-së (3 500 – 4 500 persona), rritja e sulmeve të saj kundër MUP dhe oragnizatës dhe strukturës së forcave të saj: “forcat terroriste po marrin gjithë e më shumë tiparet e një organizate ushtarake, dhe po formojnë njësi nga toga deri tek kompanitë”
Sipas burimeve Serbe me datë 13 maj 1998 UCK-ja kontrollonte rreth 30% të territorit të Kosovës.

Raportet serbe përkufizojnë anëtarët e UCK-së si “terroristë” por nuk mund të mohojnë organizimin e tyre ushtarak në rritje (njësi, toga, kompani) dhe mbi të gjitha pjesën e territorit të kontrolluar nga UCK-ja.

Sipas dëshmitarit “TT” në luftimet në Bellacerkve/Bela Cerква me datë 18 qershor 1998 kanë marrë pjesë 100 ushtarë të UCK-së.

UCK-ja kishte një strukturë dhe organizim të brendshëm solid, siç është treguar nga nxjerrja në vitin 1998 e “rregullores së përkohshme mbi organizimin e brendshëm të jetës ushtarake”⁷.

Këtu (kapitulli IV) duhet të lexohet “Ushtria çlirimtare e Kosovës është TËRËSIA E FORCAVE TË ARMATOSURA TË KOSOVËS” që do të thotë bashkimi i të gjithë luftëtarëve për pavarësinë e Kosovës nën një zingjir komande formal dhe hierarkik.

Jurisprudenca e TPNJ-së e cituar në vendimin e Shkallës së Parë⁸ konfirmon ekzistencën e zingjirit komandues hierarkik përpara fundit të majit 1998, aftësia e UCK-së për tu angazhuar në përplasje të armatosura me forca të mëdha serbe si shfaqje e nivelit të saj organizativ dhe pranimit i fituar nga UCK-ja si pjesëmarrëse e nevojshme dhe e vlefshme në negociatat me qeveritë ndërkombëtare.

Elementeve të lartpërmendur mund tu shtohet se furnizimi me armë, municione dhe pajisje të tjera ushtarake ishte natyrisht njëri prej shqetësimeve më të rëndësishme të UCK-së.

Për shëmbull, në periudhën nga Maji në Qershor 1998, në Tiranë, R. L. dhe aktivistë të tjerë të UCK-së kanë mbledhur armë dhe municione për ti dërguar UCK-së në Kosovë, duke përfutuar nga gjendja e protestave të përgjithshme në Shqipëri gjatë së cilës depot e armatimit kishin rënë në duart e civilëve të cilët i kanë shitur Shqipëtarëve Kosovarë.

Bashkëkombas të tjerë kanë ardhur nga vendet e Evropës Perëndimore.

Sipas L. në periudhën mes majit dhe qershorit 1998 rreth 10.000 vullnetarë që vinin nga Evropa Perëndimore kanë hyrë në Kosovë përmes Shqipërisë. Në këtë periudhë furnizimi me armë ka qenë në një farë mënyre i rregullt.

Mbi bazat e këtyre elementeve nuk mund të mohohet prania në UCK e kërkesave të organizimit nën një komandë të përgjegjshme, kontrolli i një pjese të territorit të

⁷ Prova nr. 15m.

⁸ Fatmir Limaj et al case, Vendimi i gjyqimit të TPNJ-së, 30 nëntor 2005 paragrafi 171-173

Kosovës, aftësia për të përmbushur operacione ushtarake të mbështetura dhe të organizuara dhe për të zbatuar LHN nga APII.

2.4 Këto karakteristika ishin gjithashtu të pranishme në zonën e fakteve, zona e Drenovcit.

Së pari, duhet të përmendet se Drenovci dhe fshatrat përreth mes Rahovec/Orahovac dhe Malishevës përbënin të ashtuquajturën “zonë e lirë” ku autoriteti i shtetit ishte zëvendësuar nga ai i kryengritësve, që ëahtë ai i UCK-së.

Gjyqtari i Shkallës së Parë bazon vlerësimin e tij në dëshmi: në atë zonë “UCK-ja kishte çdo gjë nën kontroll” (F. H.), njerëzit nuk mund të hynin apo të dilnin lirshëm nga zona e lirë për shkak të kontrolleve të UCK-së (“D”, N. R.).

Natyrisht në këtë zonë nuk kishte serbë. (“D”).

Siç është parë më sipër, Drenovci mbrohej nga llogore të hapura në Mars/Prill (E. R.).

F. H. shton se “çdo ushtri kishte Shtab jo vetëm Drenovci”.

Gjithashtu “X” dhe “Z” përmend praninë e Shtabeve dhe kontrollit në disa fshatra, mes të cilave Drenovci.

N. M. përmend zonën e lirë në Malishevë.

Edhe S. K., siç thuhet më sipër, ka pranuar ekzistencën e një zone të lirë.

Së dyti, Drenovci ishte nën kontrollin e UCK-së, e cila kishte atje, mes të tjerave, zyrat e Policisë Ushtarake dhe Qendrën për Paraburgim.

Policia Ushtarake komandohej nga G. P. deri në vdekjen e tij në mes të Qershorit 1998.

Siç shihet më mirë më poshtë, sipas provave të S. K. ishte fillimisht Zëvendësi i P. pastaj Shefi i ri i Policisë Ushtarake.

Ekzistenca e Policisë Ushtarake dhe Qendrës për Paraburgim në Drenovc është një nga elementet e organizimit të UCK-së, sepse perdorej për të përdorur disa funksione shtetërore si ato të lidhura me policinë dhe funksionet e inteligjencës.

Qendra për Paraburgim nuk menaxhohej në mënyrë “autonome” nga forcat vendore por ka vepruar brenda kuadri më të përgjithshëm të aktiviteteve dhe qëllimeve të UCK-së.

Kjo do të thotë se aktiviteti i Qendrës për Paraburgim dhe i Policisë Ushtarake në Drenovc ishte në kuadrin e qëllimeve dhe operacioneve të përgjithshme të UCK-së, kjo e fundit ishte edhe mbikqyrëse e “likuidimit” të bashkëpunëtorëve⁹.

Së treti fakti se të burgosurit ishin zhvendosur nga Drenovci për shkak të ofensivës së Ushtrisë Serbe është një element tjetër i shfaqjes së organizimit të UCK-së dhe aftësisë së saj për të zbatuar LHN sepse evakuimi i të burgosurve nga zonat e rrezikuara rëndë si pasojë e konfliktit të armatosur është paraparë nga neni 5.2 lit c i Protocollit II të Konventave të Gjenevës.

⁹ Shih komunikatën No. 42 të 28/02/1998 Stafit të përgjithshëm të UCK-së dhënë nga Zyra e Prokurorit të TPNJ-së, referencat e kësaj gjenden në raportin e lëshuar nga kjo zyrë me titull “Konflikti i Armatosur në Kosovë” i datës 2 gusht 2004.

Së katërti, siç është deklaruar nga dëshmitari Dr A. H. në atë rajon UCK-ja kishte në dispozicion një spital ushtarak i cili është zhvendosur shpesh për të mënjeluar ofensivën serbe.

Pesë, S. K. përmend pjesëmarrjen e mundshme të anëtarëve të njësisë së Drenovcit të UCK-së në luftime të ndryshme si në Ratish apo Kramovik.

Në fund, nga dëshmitë rezulton se në Drenovc funksioni i “komisarit politik” është ushtruar nga B. Z. siç do të shihet më vonë.

Prandaj, në rajonin e Drenovcit nuk mund të mohohet ekzistenca në kohën kritike e një organizate të UÇK-së, një organizate me seli dhe e strukturuar me nivele të ndryshme të komandës, me Shef të Policisë Ushtarake, më Zëvendës-Shef, me agjentë të tjerë dhe me “komisar politik”.

Kjo organizatë ishte në gjendje të kryente detyra të policisë, të menaxhonte një qendër paraburgimi dhe të zhvendoste të burgosurit kur filloi ofensiva serbe.

Kjo organizatë ofronte ndihmë mjekësore për të plagosurit dhe sigurisht që edhe njësi ushtarake jashtë Drenovcit.

Kjo organizatë nuk vepronte në mënyrë autonome, por brenda komandës së aktiviteteve dhe qëllimeve më të përgjithshme të UÇK-së.

Njësia në Drenovc ishte pjesë e UÇK-së dhe së bashku me njësitë e tjera përmbushte kërkesat e Protokollit II Shtesë Kontentës së Gjenevës dhe rrjedhimisht, përfshinte LHN-në.

2.5 Sa i përket karakterit “diskriminues” të sjelljes së të pandehurve, siç përmban ankesa në favor të B. Z., shihni pikën III.9.

3. Pika e tretë ka të bëjë me mënyrat e përgjegjësisë, nëse ishin direkte, në bashkëpunim apo brenda aktivitetit të grupit kriminal.

Tre ankimuesit nga perspektiva të ndryshme kundërshtuan përgjegjësinë e të pandehurve kurdo qoftë që kjo është afirmuar nga Gjykata e Shkallës së Parë jo për veprime direkte, por për pjesëmarrje në veprimtari të përbashkët kriminale.

Pretendohet që i pandehuri S. K. është dënuar për pjesëmarrje në arrestimin dhe paraburgimin e paligjshëm të viktimave kur asnjë provë nuk vërteton veprimin e arrestimit, të kryer nga i pandehuri.

Në ankesë, në favor të B. Z., pretendohet që dispozita e Nenit 26, KP RFSJ është shkelur për shkak të mungesës së sqarimit lidhur me pjesëmarrësit, qëllimeve të grupit dhe përdorimit të tyre.

Ankesa në favor të A. K. afirmon që vendimi është kontradiktor në lidhje me Nenet 22 dhe 26 KP, RFSJ, të cilat në të vërtetë nuk përputhen me njëra-tejtren.

Gjykata e Shkallës së Parë shqyrton mënyrat e ndryshme të përgjegjësisë në faqet nga 78 deri në 82, duke trajtuar hipotezën e bashkëpunimit (në pajtim me Nenin 22, KP SFRJ), duke ndihmuar (“veprime me qëllimin specifik e asistimit, nxitjes apo dhënies së mbështetjes morale në kryerjen e një krimi”) dhe marrë pjesë në një grup kriminal apo

veprimtari të përbashkët kriminale (në pajtim me Nenin 26, KP RSFJ) dhe vë re si të vërtetuar përgjegjësinë e të pandehurve në pajtim me Nenin 22 dhe 26, KP RSFJ.

Kjo Gjykatë vë re që arsyetimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është korrekt.

Pika fillestare është konsiderimi që veprat penale që u ngarkohen të pandehurve si krime lufte përbëhen nga fakte komplekse.

Sipas akt-akuzës, këto fakte kanë qëndruar për tre apo katër muaj, kishin të bënin me shumë viktima, secili akt ndodhi me modalitete të ngjashme por edhe të ndryshme në mënyrë konkrete.

Edhe pjesëmarrja e secilit të pandehur është e përshkruar në akt-akuzë me modalitete të ndryshme.

Prandaj, nuk ka ndonjë kontradiktë në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, me ç'rast afirmohet përgjegjësia e secilit të pandehur, në mënyrë alternative në pajtim me Nenin 22 dhe 26, KP RSFJ.

Kjo është kështu për shkak se në faktin e vetëm konkret, Gjykata e Shkallës së Parë ka njohur përgjegjësinë si rast bashkëpunimi apo si pjesëmarrje në një veprimtari të përbashkët kriminale.

Nga provat e mbledhura, del që sjelljet e ndryshme dhe mënyrat e ndryshme të bashkëpunimit të tre të pandehurve janë vlerësuar në mënyrë të qartë në vendimin e kundërshtuar, qëllimet e grupit të organizuar dhe përdorimi.

Duhet të theksohet si në vijim.

Bashkëpunimi (Neni 22, KP RSFJ) mund të ekzistojë në lidhje me një krim të vetëm, të kryer bashkarisht nga disa persona, në njërën anë gjendet mbajtësi i vendimit dhe vullnetit për të kryer veprën penale dhe në anën tjetër ai që kryen veprën tipike të ndaluar me ligj (vrasje, vjedhje) apo një segment të këtyre, apo sipas disa komentatorëve, edhe një vepër që bie jashtë kësaj, por përfaqëson “një segment esencial në procesin e kryerjes së veprës penale”¹⁰.

Ligji bën dallimin në mes të bashkëkryerësve (bashkëpunëtorëve) nga nxitësit dhe përkrahësit edhe sa i përket dënimit ngase sjellja e grupit të parë (për të kryer veprën tipike penale) vlerësohe si më e rëndësishme.

Mocioni i “përgjegjësisë penale dhe dënueshmërisë së organizatorëve të asociacioneve kriminale” (Neni 26, KP RSFJ) ka një kuptim dhe rëndësi tjetër.

Në këtë rast, një subjekt, diçka me karakteristika stabile dhe organizim specifik krijohet me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave penale sipas një “plani për të kryer krimin”.

Këtu, vetëm për shkak të ekzistencës së këtij “asociacioni”, secili pjesëmarrës është përgjegjës për kryerjen e secili krim që del nga plani për të kryer krimin “sikur t’i kishte kryer ky vetë pavarësisht nga moti dhe mënyra se si ky në mënyrë direkte mori pjesë në kryerjen e ndonjë prej këtyre krimeve”.

Me fjalë të tjera, me rast të veprimtarisë së përbashkët kriminale, përgjegjësia e të vetmit nuk bazon domosdoshmërisht pjesëmarrjen direkte apo ndihmën e dhënë në kryerjen e krimin të vetëm, por në krijimin apo në pjesëmarrjen (për përdorim) të një aktiviteti të organizuar kriminal (actus reus) me dijeninë dhe vullnetin (mens rea) për të dhënë kontributin e tij veprimeve kriminale të organizatës.

¹⁰ Ljubisa Lazarevic, Komentet mbi Kodin Penal RFY, 1995, Neni 22.

Sjellja e "përdorimit" të grupit në mënyrë të qartë i referohet gjithë pjesëmarrësve, edhe pse këta nuk janë krijuesit apo organizatorët.

Në veprimtari të përbashkët kriminale, natyra dhe kualiteti i kontributeve të pjesëmarrësit të vetëm, shpesh nuk përkon me veprën tipike të paraparë si vepër penale me ligj ("pavarësisht nga moti dhe mënyra, ky në mënyrë direkte mori pjesë në kryerjen e ndonjë prej këtyre veprave").

Për shembull pjesëmarrja në një arrest të paligjshëm jo vetëm nga persona që materialisht kapin viktimën, por edhe personat që porositin apo vetëm planifikojnë arrestin, apo ata që marrin pjesë në aktivitetet që janë pasoja logjike dhe të nevojshme të arrestit, siç mund të jetë organizimi i rojes për të burgosurit, të lejojë apo të ndalojë vizitat e të afërme dhe kështu me rradhë.

Krijimi dhe funksionimi i një qendre të paraburgimit është një aktivitet kompleks, i cili kërkon organizim, ndarje të roleve, përballje dhe zgjidhje të aktiviteteve të përditshme.

Në anën tjetër, paraburgimi nuk është logjikisht i mundshëm pa aktin e mëparshëm të arrestit, e para është domosdoshmërisht e lidhur me të dytën.

Për përdorimin e principeve të jurisprudencës, të parapara nga TPNJ, Gjykata e Shkallës së Parë ka deklaruar në mënyrë korrekte (faqja 81) që:

Personi mund të mbahet përgjegjës për veprat penale të një asociacioni kur a) ai merr pjesë në mënyrë direkte së bashku me persona të tjerë në kryerjen e veprës penale, b) vullnetarisht merr pjesë në një sistem shtypës apo keq-trajtues, i cili rezulton në vepra penale apo c) kur vepra penale është pasojë e "natyrshme dhe e parashikuar" e planit të përbashkët.

Një vërejtje tjetër duhet të shtohet.

Neni 26, KP RSFJ nuk e kufizon shtrirjen në rastet kur dikush krijon një asociacion vetëm për qëllim të kryerjes së veprimeve kriminale.

Parasheh edhe rastin kur një grup i ligjshëm ekzistues apo asociacion keqpërdoret nga disa nga pjesëmarrësit për qëllime kriminale¹¹.

Nën hetim apo vendim në këtë rast nuk ishte UÇK-ja si e tillë dhe qëllimet e përgjithshme të aktiviteteve të saj, por sjellja e individit që përfitoi nga ekzistenca e konfliktit, mori kontrollin mbi një pjesë të territorit nga organizata e UÇK-së për të kryer arreste të paligjshme, intervistime, paraburgime, rrahje dhe veprime të tjera që ngarkohen me akt-akuzë dhe në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Këto veprime nuk janë kryer për qëllime personale apo private të kryerësve, por brenda qëllimeve dhe sjelljeve të përgjithshme të operacioneve të UÇK-së, të cilat janë keqpërdorur.

Siç edhe është thënë nga Gjykatësi për Konfirmim, "dispozita e Neni 26, KP RSFJ është e ngjashme me doktrinën e veprimtarisë së përbashkët kriminale (apo qëllimit apo disenjtit të përbashkët), siç është interpretuar nga TPNJ në rastin Tadic¹². Sipas kësaj doktrine, kur krimi rezulton nga një veprim i ndërmarrë nga një mori njerëzish, të gjithë

¹¹ "Megjithatë, kjo formë e bashkëpunimi gjithashtu ekziston në rast kur dikush për kryerjen e veprave penale përdor një asociacion, i cili nuk është krijuar për qëllime kriminale, por aktivitetet e saj janë legjitime si rregull. Gjatë Luftës II Botërore, asociacionet e disa minoriteteve kombëtare, të krijuara për qëllime specifike kulturore janë përdorur për qëllime kriminale". Ljubisa Lazarevic, Komentare në Kodin Penal të FRY, 1995, Neni 26.

¹² P.v. Tadic, Vendimi i Zyrës së Ankesave, 15 korrik 1999, paragrafët 186-228.

pjesëmarrësit janë përgjegjës në mënyrë të barabartë në veprim pavarësisht nga pozita e tyre dhe niveli i kontributit të dhënë dhe dëshirës për angazhim në veprim kriminal të përbashkët¹³.

Këtu mund të shtohet që dispozita e Nenit 26, KP RSFJ është kryesisht e njejtë me atë të Nenit 26, KPPK, i cili ndëshkon pjesëmarrësit në një asociacion kriminal sepse këta janë pajtuar me persona të tjerë për të kryer apo nxitur kryerjen e veprës penale dhe për të ndërmarë veprime përgatitore për përmbushjen e këtij pajtimi.

Përpos nga formulimi i drejtpërdrejtë të dy dispozitave ligjore, identiteti duhet të shihet në marrëveshjen për të kryer (një apo më shumë) vepra penale (26, KPPK), njejtë me disenj kriminal apo qëllim të kryerjes së veprave penale siç përmendet në Nenin 26, KP FSRJ.

Identiteti është gjithashtu edhe sjellja materiale: duke përdorur një asociacion për qëllim kriminal të kryerjes së veprave penale (26, KP RSFJ) është sjellje materiale, e cila rezulton në ose kryerjen e veprës tipike kriminale (vrasje, vjedhje) ose në kryerjen e veprimeve ndihmëse apo përgatitëse për krimin.

Me fjalë të tjera, përdorimi i një asociacioni për qëllimin e kryerjes së veprave penale (26 KP, RSFJ) është i njejtë sikur ndërmarrja e veprimeve përgatitëse për përmbushjen e marrëveshjes për kryerjen e veprave penale (26, KPPK).

Pluraliteti i veprave penale nuk përjashtohet me formulimin e Nenit 26, KPPK dhe i jep asociacionit kriminal një aspekt stabiliteti dhe qëndrueshmërie në atë kohë.

Aspekti i njejtë i stabilitetit i jepet sjelljes së pjesëmarrësit të organizatës apo grupit, i cili përdoret në rast të veprimtarisë së përbashkët kriminale (26 KP, RSFJ).

4. Pika e katërt ka të bëjë më kohën e procedurave.

Në veçanti koha që ka kaluar nga shpallja e vendimit dhe përpilimi dhe dorëzimi i vendimit (nga data 10 gushti 2006 në mars 2008) është përkufizuar si “jashtëzakonisht e madhe” dhe në kundërshtim me nenin 395.1 të KPPK-së, pala mbrojtëse e konsideron atë si prapavijë e një gjykimi politik.

Pala mbrojtëse thekson edhe periudhën e gjatë të kaluar në arrest nga të pandehurit (nga shkurti 2004 për S ■■■■■ K ■■■■■ dhe B ■■■■■ Z ■■■■■, nga data 9 dhjetor 2005 për A ■■■■■ K ■■■■■) pa një gjykim të plotfuqishëm, fakt që pengon ata të marrin përfitimet e mundshme korrektuese, p.sh lirim me kusht.

Gjykata vlerëson se, edhe pse koha e nënvizuar është shume e gjatë, gjykimi politik është vetëm një supozim i avokatit mbrojtës.

Instrumentet ndërkombëtare parashohin zgjatjen “e arsyeshme” të procedurës penale dhe civile.

Në veçanti, neni 6.1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore parasheh se “të gjithë kanë të drejtën e një seance publike brenda një kohe të arsyeshme”.

Kjo përfaqëson një të drejtë të të pandehurit dhe një detyrë të Shtetit.

Kjo është e lidhur jo vetëm me kohën në të cilën duhet të fillojë gjyqi por edhe me kohën në të cilën duhet të mbarojë dhe të jepet vendimi.

Në të gjitha fazat, në shkallën e parë dhe në apel, procedurat duhet të zhvillohen pa vonesë të paarsyetuar.

¹³ Vendimi i Gjykatësit për Konfirmim, Timothy Baland, 21 maj 2005.

Gjyqet e zhvilluara gjatë një periudhe të gjatë të paarsyeshme mundësojnë konsiderimin e njëjtë mes “drejtësi e vonuar” dhe “drejtësi e mohuar”, sepse ato mbajnë për një kohë të gjatë individin në një situatë pasigurie e cila nuk është në përputhshmëri me sundimin e ligjit.

Kriteret e përcaktuara në lëndët në Gjykatë me qëllim që të vlerësohet arsyeshmëria e kohëzgjatjes së lëndës zakonisht kanë të bëjnë me kompleksitetin e lëndës, sjelljen e parashtruesit dhe atë të autoriteteve kompetente.

Në lëndët penale kur i pandehuri është në paraburgim, koncepti i “arsyeshmërisë” është më i ngushtë, meqënëse atij duhet ti jepet vendimi i plotfuqishëm sa më shpejt që të jetë e mundur, që do të thotë në një kohë e cila nuk bën praktikisht të pamundur për të pandehurin ankesën pranë organeve alternative si p.sh. lirimi me kusht.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe ligjislacionit të Vendeve Anëtare të Këshillit të Evropës kohëzgjatja e procedurave kur është e “paarsyeshme” mund të sjellë krijimin e kompensimit ekonomik.

Kjo lëndë është veçanërisht komplekse: shkalla e parë ishte lidhur me gjashtë të pandehur, secili prej tyre i akuzuar për vepra penale specifike, gjatë gjykimit kryesor janë dëgjuar tridhjetë e katër dëshmitarë dhe janë mbajtur katërdhjetë e katër seanca, për arsye të pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, çdo gjë është përkthyer në gjyhën angleze dhe në gjuhën shqipe, përmaset e lëndës së dosjes përfshijnë të paktën dhjetë mijë faqe, prej të cilave pothuajse gjashtë mijë gjatë fazës paraprake, vendimi me shkrim përbën njëqind faqe.

Është e pamohueshme se ky ndërlikim kërkon kohë për zhvillimin e gjyqit, për marrjen dhe përpilimin e vendimit.

Megjithatë koha nga shpallja e vendimit të shkallës së parë (10 gusht 2006) deri në momentin e regjistrimit të vendimit të shkruar në regjistrin e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut (6 mars 2008) ka qenë në mënyrë të paarsyeshme e gjatë.

Kjo kohëzgjatje mund të ketë pasur edhe efekte anësore mbi të drejtat e të pandehurve për të pasur qasje në mundësi alternative.

Nuk është kompetencë kësaj Gjykate që të vendosë mbi një formë kompensimi ekonomik e bazuar në vonesën e paarsyeshme të procedurës penale.

Megjithatë dhe në rast ndëshkimi, kjo pikë mund të konsiderohet sipas dispozitës së nenit 42 nr 2 të LP të RFSJ-së (që gjendet në dispozitën e nenit 66 nr 2 të KPPK-së) si një rrethanë veçanërisht zbutëse¹⁴ e cila tregon se qëllimi i ndëshkimit mund të arrihet me një ndëshkim më të vogël sic do të spjegohet më poshtë..

5. Përfundimi i kësaj pike është se në procedurë shkallës së parë nuk është bërë asnjë shkelje e procedurës penale apo ligjit penal të cilën që Gjykata duhet të theksojë sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 415 të KPPK-së.

¹⁴ Në këtë kuptim të ballafaqohet Gjykata e Qarkut në Prishtinë 9 nëntor 2007 Shkumbin Mehmeti dhe Gjykata e Qarkut Prishtinë 5 tetor 2007 B.M.

II

Siç thuhet më sipër, ankesa e [redacted] nga Mitrovica si avokat mbrojtës i të pandehurit S [redacted] K [redacted] është parashtruar me datë 21 mars 2008 dhe pjesa plotësuese e kësaj ankesë është parashtruar me datë 7 prill 2008.

Gjykimi i shkallës së parë kundërshtohet për shkak të:

- Shkeljeve esenciale të procedurës penale,
- Vertetim i gabuar dhe jo i plotë,
- Shkelje të ligjit penal dhe
- Vendimit për dënim.

Avokati mbrojtës propozon:

- Të ndryshohet vendimi duke gjetur se nuk është vertetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe për pasojë të shfajësojë atë, apo,
- Të dërgojë lëndën në Gjykatën e Shkallës së Parë për rigjykim, duke urdhëruar në të njëjtën kohë ndërprejen e paraburgimit me qëllim që i akuzuari të lejohet të mbrohet në liri, apo,
- to impose to the accused a more lenient punishment.

Bazat e ankesës janë si në vijim.

AD1. Shkelje esenciale të procedurës penale si:

- mospërputhje e pretenduar mes dispozitivit dhe pjesës së arsyetimit,
- mungesë konsiderate për fakte vendimtare,
- kundërshtim i konsiderueshëm mes arsyeve të dhëna dhe përmbajtjes së dosjes së lëndës dhe procesverbaleve të deklaratave dhe vetë procesverbaleve.

Kjo bazë ankesë zhvillohet në pikat në vijim.

1. Mbrojtja ka pretendim në kohën e procedurës dhe në veçanti kohën që ka kaluar në mes të shqiptimit të vendimit dhe përpilimit të vendimit.

Kjo pikë është shqyrtuar më lart (shihni pikën I.4) dhe do të ketë ndikim në secilin të pandehur.

2. Mospërputhja ndërmjet dispozitivit, me ç'rast Selim KRASNIQI dënohet për pjesëmarrje në arrestin dhe paraburgimin e paligjshëm të viktimave, duke e bërë veten e tij përgjegjës për krimin e luftës të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjes së madhe apo cënimit të shëndetit trupor të të paraburgosurve civilë dhe arsyetimi, (faqja 73) ku nuk është sjellë asnjë provë për arrestim të kryer nga i pandehuri.

Kjo pikë nuk është e bazuar për shkak të arsyeve të cekura më lart (shihni pikën I.3).

Nuk mund të vërehet ndonjë kundërshtim ndërmjet dispozitivit dhe arsyetimit të vendimit të kundërshtuar për shkak se përgjegjësia e S [redacted] K [redacted] për arrestimin e paligjshëm dhe mbajtjen e paligjshme në paraburgim të personave, në kushte çnjerëzore, në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, në disa raste konsiderohet si rezultat i drejtimit të drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrjes së tij në veprimtari të përbashkët kriminale në disa raste të tjera.

3. Mbrojtja është e mendimit që ka kundërshtim në mes të arsyetimit në njëerën anë dhe përmbajtjes së dosjes së lëndës dhe proces-verbalit të deklaratave në anën tjetër sa i përket vendimit (faqet 87 dhe 88 të versionit anglisht), i cili shqyrton dhe refuzon alibinë e S. K. si i papranishëm në Kosovë për pjesën më të madhe të korrikut dhe gushtit të vitit 1998.

Alibia pretendon të jetë e bazuar në një numër dëshmitarësh të mbrojtjes, dëshmitë e të cilëve sipas Avokatit Mbrojtës, Gjykata e Shkallës së Parë nuk i ka marrë në konsideratë në mënyrë të duhur, apo thjesht i ka kundërshtuar apo ju është shmangur.

Vendimi i kundërshtuar gjen kundërshtim ndërmjet dëshmisë së R. R. (si dhe M. J. në njëerën anë, sipas të cilit i pandehuri është larguar nga Tirana dhe është nisur në drejtim të Kosovës në periudhën nga 8 deri më 12 gusht nëpërmjet Vlorës (bregu jug-perëndimor i Shqipërisë) dhe dëshmisë së R. L., sipas të cilit, rruga e të pandehurit për në Kosovë ishte nëpërmjet Kukësit (veri-lindjes së Shqipërisë në kufi me Prizrenin në Kosovë).

Vendimi shton që emri i qytetit të Vlorës (dëshmia e M. J.) ishte shënuar gabimisht në proces-verbal si Vlane.

Avokati Mbrojtës nxjerr në pah që dëshmitari foli për Vlanen dhe jo Vlorën, duke shtuar që Vlane është një fshat që ndodhet në afërsi të kufirit Shqiptar-Kosovar, afër qytetit të vogël të Krumës.

Kruma ishte stacioni i luftëtarëve të UÇK-së, të cilët kishin vendosur të kalojnë kufirin Shqipëri-Kosovë për t'u bashkangjitur njësisve brenda Kosovës.

Përpos kësaj, Kruma ishte vendi ku bliheshin armët për t'u transportuar në Kosovë.

Prandaj, Vlahne e jo Vlora, ngase kjo e fundit kurrë nuk është dashur të përmendet nga dëshmitarët.

Më tej, Avokati Mbrojtës bën vërejtje që deklarata e H. K. mbeti e paanalizuar dhe që deklarata e Dëshmitarit Anonim "Z" thjesht është shmangur.

Dëshmitari "Z" deklaroi që ka takuar të pandehurin S. K. më 15 qershor dhe më 17 gusht dhe ai e informoi që në kohën e ofensivës serbe kundër qytetit të Rahovecit (më datën 17 korrik 1998) nuk ishte në Kosovë.

Vërejtja paraprake e Gjykatës së Shkallës së Dytë është që mungesa e vlerësimit të një apo më shumë dëshmive nga ana e Gjykatës të Shkallës së Parë nuk sjellë automatikisht deri te vlerësimi i papërputhshmërisë të vendimi i sfiduar.

Sigurisht që varet nga përmbajtja e këtyre dëshmive: nëse janë të tepërta apo në ndonjë mënyrë nuk ndikojnë në vendimin, shqyrtimi i secilës pjesë të tyre nuk është obligativ.

Në këtë pikë, një vërejtje e dytë e përgjithshme duhet bërë mbi besueshmërinë e dëshmive.

Detyra e dëshmitarit është të flasë të vërtetën (Neni 164.2, KPPPK) lidhur me faktet në hetim, duke thënë atë që ka perceptuar apo ka mësuar nga burimet e tjera.

Dëshmia rezulton nga veprimi i të vrojtuarit dhe kujtuarit.

Mospërputhjet apo kundërshtimet në dëshmi nuk konsiderohen automatikisht shenjë e një dëshmie të rreme duke pasur parasysh që mund të jenë shenjë e një gabimi të thjeshtë në perceptimin apo kujtesën e dëshmitarit apo që ai perceptim apo kujtesë është ndikuar nga

faktorë dhe rrethana të jashtme, siç është bërë e qartë në mënyrë të besueshme nga vendimi i sfiduar në pjesën që në mënyrë specifike i dedikohet “vlerësimin të kredibilitetit të dëshmitarëve”.

Gabimet në dëshmi nuk janë të rralla dhe janë të kuptueshme sidomos kur incidentet kanë ndodhur kohë më parë dhe janë të ndërlidhura me përvoja të dhimbshme dhe të rrezikshme, nga të cilat njerëzit kanë tendencë të dëshirojnë të ikën edhe në mendje.

Një gjë e tillë, siç duhet ta kemi edhe parasysh, vlen për të gjithë dëshmitarët, të prokurorisë dhe atyre të mbrojtjes.

Një ndër mjetet më të rëndësishme, të elaboruara nga jurisprudenca për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit, është prania apo mungesa e interesit të këtij në atë që i referohet.

Pyetja që duhet përgjigjur në këtë rast është “*cui prodest?*” Pra, kush mund të përfitojë nga kjo dëshmi dhe pse.

Te interesi eventual i dëshmitarit të prokurorit do të kthehemi më vonë derisa shqyrtojmë edhe problemin që ngritet në ankesë lidhur me ekzistencën e pretenduar të komplotit kundër të pandehurve.

Në këtë pikë duhet të ceket që dëshmitarët e të pandehurit S. K. nga të cilët varet alibia e këtij të fundit nuk mund të konsiderohen neutralë për të dhe për rezultatin e këtij gjykimi.

Siç është cekur në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, këta janë “shokë lufte, miq të afërt apo zyrtarë aktual të TMK-së, me të cilët ky ka shërbyer gjatë kohës së arrestimit të tij”.

Siç është thënë nga Avokati i tij Mbrojtës, S. K. pandehet të ketë qenë një pjesë e rëndësishme e luftës kundër serbëve, ndër të tjera, ishte edhe një ndër themeluesit e fuqisë së armatosur, e cila më vonë u zhvillua si Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Kjo duhet të sjellë një maturi të veçantë në vlerësimin e deklaratave të këtyre dëshmitarëve, duke e pasur të qartë mundësinë që këta, edhe jo me dashje, i referohen detaleve të cilat janë të gabuara apo të pavërteta, por në favor të këtij personi të rëndësishëm, luftëtari apo shoku të tyre.

Mbi të gjitha, maturi dhe vëmendje duhet të ketë për elementet jashtë këtyre dëshmive, elemente që mund të konfirmojnë apo të kenë kontrast ndaj dëshmive.

Sa i përket pikave të lartpërmendura të ankesës, Gjykata e Shkallës së Dytë vëren si në vijim.

Dëshmitari M. J., anëtar i UÇK-së që nga viti 1993, i ka thënë Gjykatës që për herë të parë ka takuar “Gjeneralin S. K.” në Vlane ndërmjet datës 8 dhe 12 gusht 1998, kur dëshmitari po hynte në Kosovë me një grup imigrantësh që dëshironin të angazhoheshin në luftë, edhe S. K. shkonte në Kosovë.

J. asnjëherë me parë nuk kishte takuar K.

I pranishëm në takimin në Vlane ishte edhe R. R., të cilin J. e njohte nga më parë.

Atë ditë, J. qëndroi në Vlane. Ndërsa Gjeneral S. K. u largua nga ky vend dhe ishte nisur në drejtim të Kosovës.

Secili ushtar i UÇK-së që vinte nga Shqipëria barte armë dhe municion për luftëtarët e tjerë në Kosovë.

Udhëtimi në dhe nga Kosova mund të zgjaste me ditë të tëra për shkak të masave të sigurisë të vëna përgjatë kufirit nga serbët.
Dëshmitari kujtohet që udhëtimi i tij nga Kosova në Shqipëri zgjati 3 ditë, ndërsa herëve të tjera 10 ditë.

Dëshmitari R. [REDACTED] deklaroi që ka takuar S. [REDACTED] K. [REDACTED] në Tiranë ndërmjet datës 8 dhe 10 korrik 1998, nuk ishte shumë i sigurt sa i përket datës, ka kaluar një muaj me të në qytetin e njëjtë, e ka takuar çdo ditë, në mëngjes, drekë dhe darkë.

Që të dy janë futur në Kosovë më 9 gusht, duke vozitur së bashku nëpërmjet Krumës dhe Vlanës, fshat në të cilin R. [REDACTED] la K. [REDACTED]

Rruga që ndërmori R. [REDACTED] ishte më e lehtë se ajo e K. [REDACTED] ngase i pari ishte i shoqëruar nga persona të lënduar lehtë dhe të pajisur me armatim të lehtë.

Disa ditë më vonë, dëshmitari dëgjoi që S. [REDACTED] K. [REDACTED] ishte nisur i vetëm për në Kosovë.

Dëshmitari deklaroi që ka takuar S. [REDACTED] K. [REDACTED] në Gjermani që në 1996, në shtëpinë e R. [REDACTED] L. [REDACTED], që të tre ishin anëtarë të UÇK-së dhe kanë punuar ngusht për lëvizjen çlirimtare.

R. [REDACTED] dhe K. [REDACTED] u bënë shokë të afërt pas vitit 1997.

R. [REDACTED] është kthyer nga Gjermania në Shqipëri në një ndër dhjetë ditët e parë të korrikut të vitit 1998, por nuk ia doli të tregojë pasaportë apo ndonjë dokument tjetër që dëshmon hyrjen e tij në Shqipëri në atë kohë.

Në Tiranë, ky jetoi i vetëm në banesën e një Sokeli, mbiemrin e të cilit nuk e dinte, pagoi me para të gatshme.

Ai takoi S. [REDACTED] K. [REDACTED] dhe qëllimi i këtij të fundit ishte të pajisej me armatim për luftë.

I kujtohet ditë që hyri në Kosovë si 9 gushti. Ishte kjo një ditë e rëndësishme për të, nuk kishte prova në dokumente për ta dëshmuar këtë.

Në përgjigje ndaj Prokurorit, dëshmitari deklaroi që ka udhëtuar nga Tirana në Vlanë së bashku me të pandehurin dhe me M. [REDACTED] J. [REDACTED]

Ai dhe K. [REDACTED] kanë kaluar kohë me J. [REDACTED] edhe në Tiranë, edhe pse jo shpesh.

Dëshmitari përmendi edhe persona të tjerë që ky dhe i pandehuri kanë takuar në Tiranë.

Ai takoi S. [REDACTED] K. [REDACTED] një apo dy ditë pas ardhjes së tij në Tiranë.

R. [REDACTED] kujton një përpjekje për të hyrë në Kosovë, përpjekje që u bë nga ai dhe nëntë persona të tjerë në maj të vitit 1997.

Në atë rast, janë zënë në pritë nga forcat serbe dhe dëshmitari është plagosur.

Atë ditë, së bashku me R. [REDACTED], në mesin e të tjerëve ishte edhe S. [REDACTED] K. [REDACTED]

Në deklaratën e dhënë Gjykatësit Hetues më 5 nëntor të vitit 2004, R. [REDACTED] i është kujtuar prania e edhe R. [REDACTED] L. [REDACTED] me atë rast.

Dëshmitari R. [REDACTED] L. [REDACTED] deklaroi që ka jetuar në Gjermani për disa vite që nga 1993, duke u përgatitur për luftën në Kosovë së bashku me të vëllanë F. [REDACTED] bashkëshortën e vëllait, X. [REDACTED] dhe vëllanë e X. [REDACTED] pra të pandehurin S. [REDACTED] K. [REDACTED]

Ky e njeh K. [REDACTED] që kur ky i fundit ishte fëmijë në vitin 1984 dhe këta janë shokë jashtëzakonisht të mirë.

I kujtohet edhe përpjekja për të hyrë në Kosovë në maj të vitit 1997, e cila kulmoi me pritën e serbëve.

Pas kësaj përpjekje, dëshmitari, S. K. dhe G. P. që të gjithë anëtarë të UÇK-së janë kthyer në Shqipëri nga Gjermania në mars apo prill të vitit 1998, dëshmitari qëndroi aty, ndërsa K. dhe P. shkuan në Kosovë.

Në Tiranë, në emër të UÇK-së, L. kujdesej për gazetarët që ishin të interesuar në luftë dhe dëshironin të hynin në Kosovë.

Sërisht, ai takoi S. K. në Tiranë deri në fund të javës së parë të korrikut të vitit 1998, kur ky i fundit erdhi në këtë qytet për të mbledhur armë dhe njerëz.

K. kishte ardhur i vetëm.

Dëshmitari takoi shpesh, pothuajse çdo ditë, K., i cili qëndroi në Shqipëri deri në javën e fundit të gushtit, kur është kthyer në Kosovë nëpërmjet Kukësit.

Dëshmitari korrigjoi dëshminë e tij duke thënë që nuk ishte java e fundit e gushtit, por pjesa e fundit e javës së parë të gushtit.

Nga i vëllai F. dëshmitari pranoi një telefonatë që S. K. kishte arritur në Kosovë me ca shokë. Kjo ka ndodhur kah fundi i javës së dytë të gushtit, pastaj sqaroi që ka mundur të jetë 11 apo 12 gushti, pa qenë i sigurt lidhur me datën.

Në Tiranë, S. K. në mes të tjerësh takoi edhe A. A. dhe X. H.

Dëshmitari dhe të tjerët kanë mbledhur armë dhe municion në Tiranë për t'i dërguar UÇK-së në Kosovë, duke përfutur nga një situatë proteste të përgjithshme në Shqipëri, me ç'rast depot e armëve kishin rënë në duart e civilëve.

Në periudhën ndërmjet majit dhe korrikut të vitit 1998, rreth 10.000 vullnetarë nga Evropa perëndimore kanë hyrë në Kosovë nëpërmjet Shqipërisë.

Furnizimi me armë ishte disi i rregullt.

Dëshmitari nuk e dinte adresën e S. K. në Tiranë, ai kishte qenë aty me ca të afërm.

Në Tiranë, dëshmitari dhe K. takuan edhe R. R. me të cilin të pandehuri u largua nga Shqipëria për në Kosovë në fund të javës së parë të gushtit.

Dëshmitari nuk e dinte nëse të pandehurit dhe R. kishin udhëtuar të vetëm në Kosovë apo me ndokënd tjetër dhe nëse kishin bartur armë.

Në pyetje lidhur me rrugën që ndoqën të pandehurit, dëshmitari përmendi dy rrugë për në kufirin verior: atë nëpërmjet Kukësit apo Bajram Currit.

Në një pyetje, ky shtoi që Vlahni është "një rrugë tjetër drejt kufirit," por nuk e kishte pyetur të pandehurin për rrugën e tij.

Vlahni është përcaktuar nga dëshmitari si pikë strategjike për UÇK-në afër kufirit, në Vlahn apo në fshatrat më të afërta, sigurisht që kishte shtëpi që përdorehin nga UÇK-ja.

Në deklaratën e dhënë Gjykatësit Hetues më 5 nëntor 2004, H. K. është kujtuar që ka qenë në Zvicër për 12 vite për shkak të politikës së qeverisë serbe dhe që është kthyer në Kosovë në 1998 me formacionin e UÇK-së.

Ai ka hyrë në Kosovë në mënyrë të paligjshme.

Më 6 korrik 1998, ai takoi S. K. të cilin nuk e kishte njohur më parë, në fshatin Rogovë (Kosovë) në shtëpinë e hoxhës së fshatit, që të dy shkonin drejt Shqipërisë, S. për të mbledhur armë dhe H. se deshi të kthehej në Zvicër për arsye shëndetësore.

Të dy janë larguar nga Rugova në mbrëmje dhe kanë arritur në Tiranë pasditën tjetër apo në mbrëmje.

H. [REDAKTUAR] është larguar nga S. [REDAKTUAR] në Tiranë.

Dëshmitari "Z" deklaroi që Selim KRASNIQI i ka thënë që ka qenë në Shqipëri gjatë kohës së largimit të të burgosurve nga Drenovci për shkak të sulmit të serbëve, pa deklaruar asgjë që mund të di në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as kohëzgjatjen e udhëtimit të të pandehurit në Shqipëri.

Gjykata e Shkallës së Dytë është e mendimit të njëjtë me vendimin e kundërshtuar, sipas së cilit alibia e të pandehurit S. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], që nuk ka qenë në Drenovc dhe që ka qëndruar në Shqipëri për rreth një muaj, nuk mund të vërtetohet nga provat e lartpërmendura.

Mirëpo, vlerësimi i Gjykatës së Shkallës së Parë duhet të jetë i saktë.

Sipas proces-verbalit, dëshmitarët kanë folur për Vlanen dhe jo Vlorën.

Sqarimet e dëshmitarëve lidhur me rëndësinë strategjike të Vlanes, Krumës dhe fshatrave të tjera për UÇK-në, mund të pranohet.

Mirëpo, kjo nuk është vendimtare në favor të të pandehurit.

Nuk mund të përjashtohet krejtësisht që S. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] ka udhëtuar nëpërmjet kufirit, arriti në Shqipëri dhe Tiranë në atë periudhë, por fare nuk është vërtetuar që ka qëndruar në Tiranë për një muaj të tërë, nga java e parë e korrikut deri në javën e parë të gushtit.

Dëshmitari i parë që deklaroi kështu, R. [REDAKTUAR] R. [REDAKTUAR] bie në kundërshtim me dëshminë e M. [REDAKTUAR] J. [REDAKTUAR], duke thënë që ai vetë dhe S. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] kanë takuar J. [REDAKTUAR] në Tiranë, gjë të cilën e përjashton krejtësisht dëshmitari J. [REDAKTUAR].

Ky kundërshtim ndërmjet këtyre dëshmitarëve është i qartë dhe nuk mund të sqarohet me anë të një gabimi të thjeshtë në kujtesën e R. [REDAKTUAR] sepse ky deklaroi që këto takime në Tiranë me J. [REDAKTUAR] janë mbajtur më shumë se një herë dhe që këta tre kanë kaluar edhe kohë së bashku, edhe pse jo shpesh.

Kjo përjashtohet nga J. [REDAKTUAR] i cili deklaroi që ka takuar S. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] për herë të parë në Vlane në gusht.

Dëshmia e R. [REDAKTUAR] ka edhe një pikë tjetër të dobët me mungesën e ndonjë dokumenti (pasaportë apo të ngjashme), i cili do të konfirmonte datën e ardhjes së tij në Shqipëri nga Gjermania.

Gjykata nuk e sheh kredibile dëshminë e R. [REDAKTUAR], kundërshton dëshmitarin tjetër të mbrojtjes dhe nuk ka bashkëpunim të jashtëm me dokumente.

Dëshmitari i dytë që afirmon praninë e S. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] në Tiranë është R. [REDAKTUAR] L. [REDAKTUAR]

Ky takoi të pandehurin shpesh, edhe pse jo çdo ditë, siç tha R. [REDAKTUAR].

R. [REDAKTUAR] dhe L. [REDAKTUAR] që të dy janë shokë të afërt, bashkëluftëtarë, edhe i afërm i S. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR].

Pavarësisht nga kjo lidhje e afërt, profesionale dhe e familjarizuar dhe kohën e gjatë që kaluan së bashku në Tiranë, L. [REDAKTUAR] nuk ishte në gjendje të rrëfejë adresën ku i pandehuri ka jetuar në Tiranë dhe kjo nuk është kredibile, sidomos nëse do të ishte e vërtetë që të dy burrat janë takuar shpesh.

Një pikë tjetër, një ndryshim në datën kur K [REDACTED] është kthyer në Kosovë (java e parë apo e fundit e gushtit) është korrigjuar me shpejtësi nga dëshmitari dhe mund të vlerësohet si gabim i thjeshtë kujtese.

As kjo dëshmi nuk është e besueshme dhe nuk mund të sjellë bazën alibisë së pandehurit që ky ka kaluar një muaj në Tiranë.

Dyshimi i interesit të këtyre dëshmitarëve për t'u dalë në ndihmë shokut të tyre është shumë i fuqishëm.

Dëshmitari "Z" nuk është relevant për këtë pikë ngase ky i referohet asaj që i ka thënë i pandehuri, duke mos i shtuar kështu asgjë versionit të këtij të fundit.

Dëshmitarët e tjerë J [REDACTED] H [REDACTED] K [REDACTED] dhe F [REDACTED] B [REDACTED] i referohen pranisë së të pandehurit si në vijim: i pari në Vlahne, i dyti rrugës për në Tiranë dhe në këtë qytet dhe i treti në një fshat rrugës për në Shqipëri vetëm në momente të caktuara dhe jo për një kohë të gjatë.

Kjo është e rëndësishme, ngase nuk mund të përjashtohet që i pandehuri ka shkuar në Shqipëri për të mbledhur vullnetarë dhe armë për luftë, por fare nuk është demonstruar që ky ka kaluar një kohë të gjatë dhe të vazhdueshme jashtë Kosovës.

Ç'është e vërteta, nevoja e UÇK-së për të marrë vazhdimisht burra dhe armë është mjaft e qartë.

Në atë periudhë, sipas L [REDACTED], rreth 10.000 vullnetarë dhe shumë armë kanë arritur në Kosovë nëpërmjet Shqipërisë në një mënyrë të rregullt.

Kjo mund të sqarohet një udhëtim të të pandehurit në Tiranë.

Kalimi nëpërmjet kufirit përfaqëson një aktivitet të rrezikshëm për shkak të kontrollit serb.

Sidoqoftë, furnizimi është definuar si "i rregull", pra i vazhdueshëm.

Koha që nevojitet për të kaluar kufirin ndryshon nga disa ditë (dëshmitari J [REDACTED] në disa orë.

Ç'është e vërteta, dëshmitari S [REDACTED] D [REDACTED] K [REDACTED] (seanca dëgjimore 14 qershor 2006) duke folur për një hyrje të paligjshme në Shqipëri në fund të qershorit 1998, tha që ka shkuar nga fshati i tij Dejne në Shqipëri për gjashtë apo shtatë orë përfshirë këtu edhe pushimet.

Dejne gjendet vetëm 10/12 kilometra larg Drenovcit.

H [REDACTED] K [REDACTED] i kujtohet që ka kaluar një ditë nga Rogova në Kosovë për në Tiranë.

Ashtu edhe R [REDACTED], në përgjigje ndaj pyetjeve të shtruar nga i pandehuri, deklaroi mundësitë për të zgjedhur rrugë të ndryshme, ajo që zgjodhi ky ishte më e lehtë sepse udhëtoi së bashku me njerëz të lënduar dhe me ushtarë të armatosur lehtë.

Kjo e bëri të mundur që S [REDACTED] K [REDACTED] të shkojë në Shqipëri dhe të kthehet brenda disa ditëve.

Kjo përputhet me nevojën e luftës për të pasur sa më shumë luftëtarë në dispozicion në terren sa më shpejt.

4. Ankesa pretendon që dispozitivi do të ishte i pakuptueshëm dhe i papërputhshëm me prova për shkak se vendimi denon të pandehurin për sjellje që ndodhën "në një datë ndërmjet 1 majit dhe 31 gushtit të vitit 1998".

Sipas Avokatit Mbrojtës, vendimi gjen të pandehurin si anëtar të UÇK-së të Drenovcit të Zatriqit për gjithë periudhën, por kjo nuk do të demonstrohej me asnjë provë në dosjen e lëndës dhe do të ishte në kontrast me deklaratën e të pandehurit. Për më tej, Gjykata e Shkallës së Parë ka refuzuar të dëgjojë dëshmitarin V. M., i cili deklaroi të Gjykatësi Hetues që në atë kohë, i pandehuri nuk ishte i regjistruar në asnjë njësi, por shkotohe në vendet ku ndodhnin luftimet.

Kjo pikë e ankesës nuk është e bazuar.

Ligji Penal merr në konsideratë sjelljen e personave, kualiteteve dhe funksioneve, të cilat personi i ushtron në mënyrë konkrete më shumë se sa emrat e këtyre kualiteteve dhe funksioneve.

I pandehuri e pranon që ka ardhur dhe ka qenë i pranishëm në vendin e fakteve në fillim të majit, pra në ditën e fillimit, qëllimi i vendimit.

Çështja se a është apo nuk është zyrtarisht i regjistruar në një grup specifik luftues është e rëndësishme, por jo aq e rëndësishme sa për të përjashtuar përgjegjësinë penale të atij që konkretisht vepron si pjesë e një grupi, duke i ndarë kështu me të tjerët veprimet dhe rreziqet e tyre, duke dhënë dhe pranuar urdhrat, duke marrë përgjegjësinë e drejtimit.

Për këtë arsye, dëshmia e V. M., cituar nga ankesa, duket se është krejtësisht jorelevante.

5. Ankesa kritikon supozimin e Gjykatës së Shkallës së Parë (faqe 20 e versionit anglisht), sipas së cilit "i pandehuri S. K. pranoi ekzistencën e Qendrës së Paraburgimit në Dranovc/Drenovac".

Ky konkluzion do të kundërshtohet nga deklaratat e ndryshme të të pandehurit.

Vendimi i kundërshtuar citon deklaratat e S. K. lidhur me dijeninë e tij për ekzistencën e Qendrës së Paraburgimit në faqe 54, 55 dhe 65 deri më 67, ku këto deklarata shqyrtohen detalisht.

Përfundimi i Gjykatës së Shkallës së Parë që i pandehuri e ka ditur për Qendrën e Paraburgimit, duket i saktë në shqyrtimin e kryer nga ana e kësaj Gjykate.

Faktikisht, pohimi që ka qenë i informuar për ekzistencën e kësaj qendre është kundër interesit të të pandehurit, si element *mens rea* i krimit për të cilin akuzohet.

Në deklaratat e tij, sidomos gjatë gjykimit kryesor, përpjekja për të mohuar këtë dijeni është e qartë, brenda një kornize të një mohimi të përgjithshëm të veprave penale dhe të përgjegjësisë së tij.

Sidoqoftë, siç është rikrijuar në mënyrë të drejtë nga gjykatësi i parë, ky i përaon disa elemente bazike, të cilat përtej çdo dyshimi demonstrojnë dijeninë e tij për ekzistencën e kësaj Qendre të Paraburgimi.

Në veçanti.

Në deklaratën e dhënë në Polici më 17 shkurt 2004, në praninë e Avokatit të tij Mbrojtës, i pandehuri e qartësoi që ka shkuar në Drenovc të Zatriqit për herë të parë më 28 prill 1998 dhe që është kthyer aty më 5 maj ku mbeti në fshat.

Dy apo tre ditë pas 5 majit, në Drenovc erdhi edhe G. P., shok dhe mik i të pandehurit, komandant i Policisë Ushtarake të UÇK-së në fshat.

P. [redacted] më vonë është vrarë gjatë një sulmi nga forcat serbe më korrik 1998 dhe emri i tij i është dhënë Brigadës 124 të UÇK-së në Drenovc të Zatriqit.

“Në pyetje se a ka pasur qendër paraburgimi në Drenovc të Zatriqit, i dyshuari thotë që e din që kishin disa zyra ku i mbanin disa njerëz. Këto zyra ndodheshin në ndërtesën e shkollës, rreth 500 metra larg nga selia e UÇK-së. G. P. [redacted] ishte përgjegjës për këtë. Ky ka edhe zyrën e tij në ndërtesën e njejtë.

Në pyetjen se kush i mbante disa njerëz aty, i dyshuari thotë që vetëm G. P. [redacted] kishte të drejtë të dërgonte njerëzit në këtë ndërtesë. Në pyetjen se cilët janë sjellë në këtë ndërtesë, i dyshuari thotë që nuk e din këtë. G. P. [redacted] i ka thënë një herë që ky ka sjellur shqiptarët e Kosovës, të dyshuar për bashkëpunim me forcat serbe, dhe që disa prej tyre janë zënë në veprim...

I dyshuari thotë që ka vizituar G. [redacted] disa herë në zyrën e tij dhe tre apo katër herë ka parë që G. [redacted] kishte njerëz në zyrë që i merrte në pyetje”, ky foli shkurtimisht me shokun e tij dhe shkoi, pa vënë re gjë dhe vetëm pa që njerëzit që merrte në pyetje P. [redacted] ishin meshkuj të rritur.

Në këto zyra, P. [redacted] intervistoi edhe ushtarë të UÇK-së, të dyshuar për sjellje të padisiplinuar dhe disa ushtarë serbë që kishin dezertuar.

I pandehuri ishte i pranishëm në këto intervista edhe pse “marrja në pyetje nuk ishte detyra e tij”.

Vetëm në këtë pikë, ky tha që nuk dinte gjë për një qendër paraburgimi në Drenovc.

I pandehuri e pranoi që G. P. [redacted] i kishte përmendur emrin S. [redacted] S. [redacted] por nuk kujtohej se çfarë u tha për këtë person dhe as se a ishte ky S. [redacted] ushtar apo jo.

Në pyetjen lidhur me emrat e disa viktimave, ky e dinte që një person me mbiemrin e rrallë P. [redacted] është marrë në pyetje nga i njejtë P. [redacted] dhe me sytë e tij e kishte parë H. [redacted] K. [redacted] rrugës për në shkollë, pra në vendndodhjen e zyrave të P. [redacted]

H. [redacted] K. [redacted] erdhi me dikënd dhe i pandehuri supozoi që është dashur të merrej në pyetje nga P. [redacted] duke qenë kjo arsyeja e vetme për ardhjen në zyrën e G. [redacted]

Të pandehurit iu kujtua edhe emri M. [redacted] R. [redacted], vëllai i të cilit bënte pjesë në forcat serbe.

Ai supozoi që edhe M. [redacted] R. [redacted] është marrë në pyetje nga P. [redacted]

Duhet të vihet re që përpos mohimit përfundimtar, në pyetjen e parë lidhur me ekzistencën e qendrës së paraburgimit, i pandehuri përgjigjet duke mos e mohuar këtë, por duke përmendur disa zyra ku mbaheshin njerëzit, duke sqaruar që vetëm P. [redacted], shefi i Policisë Ushtarake dhe përgjegjës për këto zyra, kishte të drejtën për “të sjellë njerëzit” në atë ndërtesë.

Zyrat ishin mjaft afër (500 m) selisë dhe të pandehurin e informoi P. [redacted] që ky i fundit kishte sjellur shqiptarët e Kosovës, të dyshuar për bashkëpunim me serbë.

I pandehuri njezh edhe disa nga këta persona dhe i kishte parë gjatë këtyre intervistave.

Edhe pse “marrja në pyetje nuk ishte detyra e tij” ai ishte i pranishëm jo vetëm në marrjen në pyetje të dezertuesve serbë, por edhe në atë të ushtarëve të padisiplinuar të UÇK-së dhe nganjëherë edhe në marrjen në pyetje të civilëve të dyshuar për bashkëpunim me serbë.

I pandehuri mohon që ka marrë pjesë në intervistimin e këtyre civilëve, por ua din emrat disa prej tyre

Prandaj: në zyra njerëzit e dyshuar për bashkëpunim me forcat serbe, apo të zënë në veprim janë sjellur, mbajtur dhe marrë në pyetje nga Shefi i Policisë Ushtarake. Të gjitha këto elemente janë tregues të ekzistencës së një qendre të paraburgimit dhe dijeninë për këtë.

Te Gjykatësi Hetues më 18 shkurt 2004, i pandehuri konfirmoi atë që i kishte thënë policisë një ditë më parë lidhur me zyrat ku disa njerëz qëndronin në përgjegjësinë e G. P. për t'u marrë në pyetje, këta njerëz ishin të dyshuar si bashkëpunëtorë të forcave serbe.

P. ishte i njohur edhe si R. ishte Shefi i Policisë Ushtarake të UÇK-së, zyrat e të cilit ishin në shkollën e vjetër, të vendosur 500 metra larg nga selia e UÇK-së.

Gjatë seancës gjyqësore, i pandehuri ka konfirmuar deklaratat e tij të mëparshme, por dha interpretimet e tyre.

Nuk ekziston ndonjë qendër paraburgimi në Drenovc.

Sipas tij, fjala "paraburgim", pra qëllimi i pyetjes, është dashur të mendohet në mënyrë korrekte.

Në deklaratat e tij të mëparshme, i pandehuri kishte folur vetëm për zyrat, në të cilat P. u kishte lejuar njerëzve të vijnë dhe japin informata për të ndihmuar civilët dhe për të ofruar asistencë.

Njerëzit shkonin aty me vullnetin e tyre për të ofruar informata apo për të kërkuar ndihmë.

Ai shtoi që asnjëherë nuk ka deklaruar që njerëzit janë mbajtur aty për ditë të tëra apo për një javë, ata ofronin informata dhe P. konsideronte ata si bashkëpunëtorë.

Sa u përket të dyshuarve për bashkëpunim me serbët, qëllimi dhe politika e UÇK-së ishte të "korrigjonte" ata, t'i vendoste në rrugën e duhur, t'u jepte mundësinë për të bashkëpunuar me kombin e tyre dhe jo me armikun.

Njerëzit nuk "mbaheshin", por qëndronin aty derisa jepnin deklaratat apo bënë raportet". Intervistimi i të dyshuarve për bashkëpunim me serbët ishte një komponentë thelbësore në luftën e UÇK-së dhe këtë P. ia kishte përmendur të pandehurit.

"dhe secili prej tyre i nënshtrohej edukimit të UÇK-së në mënyrë që këta të punonin për kombin e tyre".

Personat që flisnin me ata që dyshoheshin për bashkëpunim e bënë këtë në mënyrë shumë njerëzore, përndryshe i pandehuri do të kishte dëgjuar për ndonjë trajtim çnjerëzor.

Ç'është e vërteta, P. i kishte përmendur emrin S. S. si bashkëpunëtor, por sigurisht që e kishte fjalën për një person, i cili tani është Gjeneral në TMK.

Kësisoj, në sqarimin e fakteve dhe deklaratave të tij të mëparshme, të dhëna gjatë shqyrtimit kryesor, i pandehuri mohon të ketë qenë në dijeni për ekzistencën e qendrës së paraburgimit, por e pohon që një ndër detyrat kryesore (thelbësore) të zyrave, të drejtuara nga P. ishte të merreshin në pyetje, pastaj të "edukohen" apo të "korrigjohen" të dyshuarit për bashkëpunim me serbët.

Duhet të vihet re që funksioni korrigjues është një ndër funksionet e një qendre të paraburgimit.

Prandaj, supozimi i Gjykatës së Shkallës së Parë sa i përket njohjes apo pranimit të ekzistencës së një qendre të paraburgimit në Dranovc/Drenovac nga ana e të pandehurit, është korrekt.

Deklarata e tij në Polici është e qartë në këtë kuptim dhe kjo është konfirmuar edhe para Gjykatësit Hetues dhe në mënyrë formale, edhe gjatë shqyrtimit kryesor.

Mospranimi i të qenurit i vetëdijshëm gjatë shqyrtimit kryesor nuk eviton që i pandehuri të pohojë që ka qenë i informuar lidhur me funksionin "korrigues" të këtyre zyrove, një funksion tjetër tipik për këtë qendër.

6. Pika e fundit e pjesës së ankesës AD/1 ka të bëjë me ligjshmërinë e deklaratës së dhënë nga dëshmitari anonim "A" dhënë Gjykatësit Hetues më 26 shkurt 2004. kjo duhet të konsiderohet si provë e papranueshme sepse i mungon pjesa e udhëzimit ligjor për këtë dëshmitar.

Kjo pikë veç është shtruar gjatë shqyrtimit kryesor në Shkallën e Parë (seanca dëgjimore më 25 maj 2006) dhe është vendosur nga kjo Gjykatë që të refuzohet kërkesa e mbrojtjes. Arsyeja e dhënë me atë rast është që shkelja e dispozitave të procedurës penale është arsyeja që nuk lejon pranueshmërinë e provës vetëm nëse kjo pasojë është shprehimisht e parashikuar me ligj (Neni 153, KPPPK) dhe në këtë rast, asnjë dispozitë e ligjit nuk parasheh papranueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit nëse dëshmitari nuk është udhëzuar ligjërisht siç është pohuar nga mbrojtja.

Deklarata e dhënë nga dëshmitari anonim "A" Gjykatësit Hetues është pranuar si provë (vendimi i 22 qershorit 2006 dhe faqja 11 e vendimit të shkallës së parë).

Kjo Gjykatë mbështet mendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Pasi që Neni 153, KPPPK, përmban dispozitë për interpretim strikt, nuk ekziston mundësia për ta interpretuar atë në kuptimin e gjërë, pra për të bërë provën të papranueshme bazuar në një hipotezë të paraparë me ligj.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit, rastet e papranueshmërisë janë paraparë në Nenin 161, KPPPK.

Dispozitat e KPPPK-së nuk janë tregues për papranueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit nëse ky person nuk ka marrë udhëzimet ligjore të paraparë me ligj, pra ato (tani) të parapara me Nenin 164.2, KPPPK.

AD2 Vërtetimi i gabuar dhe i mangët.

7. Ankesa e kundërshton vendimin sa i përket vlerësimit të kredibilitetit të dëshmitarëve dhe përdorimit të dëshmisë së Dëshmitarit Anonim në një mënyrë vendimtare, ankesa është e mendimit që situata faktike e krijuar nga kjo Gjykatë e Shkallës së Parë në këtë procedurë penale është vendosur në mënyrë krejtësisht të gabuar dhe të mangët.

Në vendimin aktual, shmangja e vërejtjeve të përgjithshme mbi rregullat për kredibilitetin e një dëshmitari apo mënyrën e përdorimit të dëshmisë së Dëshmitarit Anonim duket e nevojshme sepse ligji i përmban këto rregulla.

Këtu do të shqyrtohen pikat e secilës provë, ku ankesa pohon që ka papërputhshmëri me prova të tjera.

Mirëpo, sa i përket Dëshmitarit Anonim, që vihet re pretendimi se është shkelur ligji në rikthimin e provave, nuk është i bazuar.

Procedura penale pajisë gjykatësin me mjete (Neni 170.1 nr. 3, KPPPK), qëllimi i të cilave është shmangja e zbulimit të tipareve apo përshkrimit të jashtëm fizik të dëshmitarit.

Lista e mjeteve në këtë normë, shërben vetëm si shembull dhe nuk parandalon gjykatësin që të përdor sende të tjera për qëllimin e njejtë.

Norma e lartpërmendur parasheh përdorimin e ekranit të errët mbrojtës, atë të aparateve për ndryshimin e imazhit apo zërit, ekzaminimin e dëshmitarit në një vend tjetër, transmetuar në gjykatë nëpërmjet qarkut të mbyllur televiziv.

Sipas Nenit 172.1, Gjykata mund të nxjerrë urdhër për anonimitet, me ç'rast masat mbrojtëse të parapara me Nenin 170 janë të mjaftueshme.

Anonimiteti absolut nuk do të thotë vetëm ndalimin për të përdorur informata lidhur me identitetin e dëshmitarit, por edhe pranueshmërinë e mjeteve akoma më vendimtare për të parandaluar zbulimin e të dhënave të tij personale.

Prandaj, siç duket është e pranueshme sipas ligjit në fuqi, që përgjigjet e dëshmitarëve nëse kishte dhe nëse janë dhënë, janë dhënë nëpërmjet dëshmitarit.

Mund të imagjinohet që një ndër këta dëshmitarë ishte një grua, me ç'rast zëri i saj mund të imagjinohet lehtë si ai i një gruaje dhe kjo mund të sjellë te rreziku konkret i sigurisë së saj.

Nuk mund të pranohet vërejtja e mbrojtës që në këtë mënyrë ekziston dyshimi se a po jepte dëshmitari provë apo përkthyesi po lexonte vetëm dëshminë.

Kjo nuk është e pranueshme sepse me leximin e proces-verbalit është e qartë që pyetjet e shtruar nga të dy palët dhe nga Trupi Gjykses, janë përcjellur me përgjigje në secilën pyetje dhe kjo do të ishte e pamundur nëse dëshmitari nuk do të ishte i pranishëm dhe përkthyesi do të ishte duke lexuar deklaratat e mëparshme.

Paragykimi për ushtrimin konkret të të drejtave të mbrojtjes që anonimiteti dhe përdorimi i mjeteve të lartpërmendura mund të përmbajnë është pranuar nga KPPPK-ja në pjesën relevante.

Kredibiliteti i secilit dëshmitar dhe pesha e tij në vendimin e plotfuqishëm do të merret parasysh në çdo rast konkret të vlerësimit.

Sa i përket vlerësimit të dëshmitarëve të tillë, Gjykata e Shkallës së Parë (faqja 19 e vendimit) ka sqaruar që ka zgjedhur interpretimin më të sigurt të Nenit 157, paragrafi 3, sipas së cilit, dëshmia e një apo më shumë Dëshmitarëve Anonimë nuk mund të përdoret e vetme apo në nivel vendimtar për dënim.

Sipas Gjykatës së Shkallës së Parë "rrjedha e ngjarjes së përshkruar nga dëshmitarët anonimë nuk qëndroi si e vetme, por është mbështetur mjaft nga dëshmia e dëshmitarëve jo anonim dhe nga ajo që është deklaruar nga disa prej të pandehurve".

Përgjithësisht, kjo mënyrë e vlerësimit është në pajtim me ligjin e procedurës.

Në veçanti në këtë rast, vrojtimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është korrekt ngase vendimi nuk është sjellur vetëm me dëshmitë e dëshmitarëve anonimë dhe këto të fundit nuk e bazuan atë në një nivel vendimtar.

8. S [REDACTED] S [REDACTED]

Sa i përket zhdukjes së S [REDACTED] S [REDACTED], ankesa citon dëshmitë e H [REDACTED] M [REDACTED] dhe F [REDACTED] H [REDACTED], sipas të cilëve viktima kishte vendosur t'u bashkangjitej UÇK-së më 2 qershor 1998.

Në ankesë, S [REDACTED] përshkruhet si një aktivisti i shquar, zhdukja e të cilit duhet veshur forcave serbe.

Emri i të pandehurit nuk rezulton në dëshminë e dy dëshmitarëve të lartpërmendur e as në atë të anëtarëve të familjes së S [REDACTED].

Policiisë nuk i kishte përmendur emrin e viktimës, por atë të një tjetër S [REDACTED] S [REDACTED], i cili tani është zyrtar në TMK.

Dëshmia e dëshmitarit anonim "A" duhet të konsiderohet si plot me kundërshtime, siç sqarohet më poshtë.

Kjo Gjykatë vë re që konkluzioni i Gjykatës së Shkallës së Parë sa i përket rrethanave të këtij personi është korrekt.

Ai shkoi në zyrat e UÇK-së në Dranovc/Drenovc së bashku me dy shokë, është arrestuar dhe është mabjtur aty për të mos u kthyer më.

Sugjerimi që forcat serbe ta kenë arrestuar atë apo vrrarë nuk është i bazuar dhe nuk mund të mohojë atë që thuhet qartë nga dëshmitarët.

Në fakt:

- F [REDACTED] H [REDACTED] ka deklaruar që kur ka takuar S [REDACTED] N [REDACTED] "nuk kishte njësi serbe në rajonin tonë sepse UÇK-ja kishte çdo gjë nën kontroll".

- sipas dëshmisë së bashkëshortes së tij dhe të afërmeve, viktima S [REDACTED] S [REDACTED] kishte qenë i anëtarësuar në lëvizjen për çlirimin e Kosovës, LDK, për dy vite gjatë viteve të nëntëdhjeta.

Pastaj, S [REDACTED] është dashur ta jep dorëheqje nga pozita e tij për shkak të disa kërcënimeve nga policia serbe.

Menjëherë pas dorëheqjes nga LDK-së, kishte fjalë që ky dyshohej për bashkëpunim me serbët.

Për shkak të këtyre thashethemeve të rënda, S [REDACTED] S [REDACTED] braktisi punën e tij si avokat.

S [REDACTED] kërkoi nga LDK-ja që ta rishikojë rastin e tij, ne letrën e tij ai kategorizoi anëtarët e udhëheqësisë së degës së LDK-së si gjykatës dhe prokuror "duke e etiketuar atë si UDB (spiun për serbë)".

Kjo kërkesë mbeti pa përgjigje.

Më 2 qershor 1998, S [REDACTED] S [REDACTED] shkoi në Drenovc për t'u bashkangjitur UÇK-së.

Dy ditë më parë, ky kishte shkruar një letër për këtë seli të UÇK-së dhe e dërgoi nëpërmjet H [REDACTED] M [REDACTED].

Përgjigja e M [REDACTED] ishte që këta nuk deshën një letër, por kërkuan S [REDACTED] N [REDACTED] personalisht, prandaj ky shkoi aty të martën dhe mbeti aty (dëshmitarja M [REDACTED] S [REDACTED] 9 nëntor 2005).

- Edhe H [REDACTED] M [REDACTED] konfirmon ekzistencën e thashethemeve lidhur me bashkëpunimin e S [REDACTED] S [REDACTED] me serbët: S [REDACTED] S [REDACTED] ngutej që të shkonte në Drenovc ngase ky ishte shantazhuar si spiun për serbët.

M [REDACTED] tha që në Drenovc është dërguar në shtëpi nga një ushtar, ndërsa S [REDACTED] S [REDACTED] nuk i është lejuar sepse është dashur të qëndrojë aty ngase "ky është një individ shumë i rëndësishëm, mbase më i rëndësishëm se unë dhe ti".

Edhe vetura e Shabanit mbeti aty.

- Të nesërmen, dëshmitari R [REDACTED] S [REDACTED] shkoi në Drenovc duke kërkuar të birin dhe një person konfirmoi që S [REDACTED] ishte aty, por nuk i lejoi që ta takonte të birin.

Disa ditë më vonë, R [REDACTED] S [REDACTED] është kthyer në Drenovc në një shkollë dhe dy persona i kanë thënë që S [REDACTED] nuk ishte më aty dhe që kishte shkuar në Drenicë.

Në që të dy rastet, R [REDACTED] pa veturën e S [REDACTED] në Drenovc, afër vendit kur e kishte kërkuar të birin.

Asnjë nga familja e tij nuk e takoi më S [REDACTED]

- Që të dy, M [REDACTED] dhe H [REDACTED] rrëfejnë që ushtarët u kanë kërkuar që të shkojnë në Sebnik, ku kishte lënë veturën S [REDACTED] dhe ta dërgojnë këtë veturë në Drenovc, këtë e bënë së bashku me një ushtar të UÇK-së.

Prandaj, këto dëshmi rezultojnë që S [REDACTED] S [REDACTED] ishte i dyshuar si spion për serbët, ky dyshim ishte kaq i madh sa që ky braktisi punën e tij dhe ishte me ngut që të shkonte në Drenovc për t'iu bashkangjitur UÇK-së për të zhdukur çdo dyshim ndaj tij.

Mirëpo, është mbajtur në Drenovc, për të mos u kthyer më.

S [REDACTED] nuk iu bashkangjiti UÇK-së, përndryshe do t'i ishte lejuar të shkonte në Sebnik dhe ta merrte vetë veturën e tij.

Për më tej, vetura e tij nuk do të kishte mbetur në Drenovc kur thuhet se S [REDACTED] është nisur për në Drenicë.

Sërish: po të kishte qenë S [REDACTED] i lirë, babait të tij do t'i ishte lejuar që ta vizitonte.

Kjo mjafton për të konkluduar që S [REDACTED] S [REDACTED] mbahej i arrestuar në Drenovc.

Dëshmitari Anonim "A" e konfirmon këtë për Gjykatën duke thënë që mbahej si i arrestuar në Drenovc dhe që në mesin e të tjerëve ishte edhe S [REDACTED] S [REDACTED], si një ndër të arrestuarit.

Sa i përket përfshirjes së të pandehurit, kjo Gjykatë konsideron korrekt vlerësimin pozitiv të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjykata e Shkallës së Parë ka shqyrtuar deklaratat e anëtarëve të familjes S [REDACTED] sipas të cilëve M [REDACTED] u kishte siguruar emrat e ca personave që kishin ndalur S [REDACTED] në Drenovc dhe në mesin e këtyre emrave ishte edhe ai i S [REDACTED] K [REDACTED] deklarata e M [REDACTED], i cili mohon të ketë siguruar ndonjë emër, por pas konfrontimit me deklaratën e tij të mëparshme, pranoi që ka dhënë dy pseudonime; deklarata e dëshmitarit anonim "A" lidhur me kohën e kaluar në paraburgim së bashku me S [REDACTED] S [REDACTED] për rrahjen së cilës i është nënshtruar aty dhe lidhur me praninë e C [REDACTED], S [REDACTED] K [REDACTED] deklaratat e të pandehurit të njejtë dhe deklaratat e tjera të dëshmitarëve që do të ekzaminohen më tej dhe të cilat kanë të bëjnë me përfshirjen e të pandehurit në menagjimin e Qendrës së Paraburgimit në Drenovc.

Kjo Gjykatë është e mendimit që deklaratat e dhëna nga anëtarët e familjes S [REDACTED] janë të singerta dhe më në fund M [REDACTED] e pranoi që kishte dëgjuar ca pseudonime, edhe pse jo atë të të pandehurit.

Siç është raportuar më parë, në deklaratën e dhënë policisë, i pandehuri S [REDACTED] K [REDACTED] foli për një S [REDACTED] S [REDACTED] duke thënë që ka dëgjuar P [REDACTED] duke thënë diçka për të, që nuk i kujtohet që ka takuar ndonjëherë këtë person dhe nuk e dinte se a ishte ky S [REDACTED] ushtar apo jo.

Në shqyrtimin kryesor, K [redacted] sqaroi që ky fliste jo për viktimën, por për një S [redacted] S [redacted] tjetër, të cilin e kishte njohur më vonë; ky S [redacted] tani është Gjeneral në TMK, për këtë arsye në kohën e bisedës me P [redacted], ky nuk e dinte se a ishte ky S [redacted] ushtar, pra, a ishte ushtar apo zyrtar.

Ky S [redacted], pra Gjenerali, ishte përmendur nga P [redacted] si bashkëpunëtor i tij dhe jo i armikut.

Ky sqarim i të pandehurit nuk është bindës ngase policisë i kishte thënë që nuk i kujtohet që ka takuar ndonjëherë këtë S [redacted] ndërsa Gjykatës i ka thënë që e ka njohur S [redacted], i cili tanimë është Gjeneral.

Arsyeja tjetër është që K [redacted] kishte deklaruar në polici që nuk e dinte a ishte S [redacted] ushtar, pra a ishte në UÇK apo jo ndërsa kishte çdo mundësi të përmendte një zyrtar të lartë apo të paktën një bashkëluftëtar, të cilin K [redacted] e njihte në çastin e arrestimit të tij dhe gjatë intervistimit në polici.

Justifikimi i të pandehurit nuk është bindës sepse përpos tjerash, është dhënë vetëm gjatë shqyrtimit kryesor, pas gjithë periudhës së hetimit, prandaj nuk duket i vërtetë.

Këto elemente mjaftojnë për të konkluduar që S [redacted] S [redacted] në të vërtetë është mbajtur nën arrest në Drenovc dhe që i pandehuri S [redacted] K [redacted] e ka ditur këtë gjë dhe që ishte i përfshirë në këtë paraburgim.

Vlerësimi i deklaratave të dhëna nga Dëshmitari Anonim "A" do të bëhet më vonë për shkak se dëshmia e tij ka të bëjë me zhdukjen e jo vetëm të S [redacted] S [redacted] por edhe të B [redacted] B [redacted], H [redacted] K [redacted] dhe H [redacted] P [redacted].

9. B [redacted] B [redacted]

Sa i përket zhdukjes e tani të ndjerit B [redacted] B [redacted], ankesa kundërshton kredibilitetin e anëtarëve të familjes së viktimës dhe atë të dëshmitarëve anonimë "A" dhe "B".

Anëtarët e familjes kishin deklaruar që B [redacted] është arrestuar nga anëtarët e UÇK-së, që "A" dhe "B" shkuan aty, që këta, sidomos "A" kishte kontakte së bashku me të gjithë të pandehurit.

Ndërsa ai "B" asnjëherë nuk përmendi gjatë hetimeve emrin S [redacted] K [redacted] ndërsa gjatë shqyrtimit kryesor tha që ka takuar atë së bashku me të tjerët, në mesin e të cilëve ishte X [redacted] E [redacted] dhe "G [redacted]" X [redacted] G [redacted].

Me atë rast, "B" gjithashtu tha që ka dëgjuar emrin S [redacted] K [redacted] të përmendej nga të tjerët, por nuk ia doli ta identifikonte fotografinë e tij e as të jepte një përshkrim korrekt të pamjes së jashtme fizike të të pandehurit.

Pavarësisht nga fakti që Prokurori Ndërkombëtar tërhoqi akuzat ndaj X [redacted] E [redacted] duke mos u besuar deklaratave të "B", Gjykata e Shkallës së Parë dënoi S [redacted] K [redacted] edhe mbi bazën e deklaratave të dhëna nga "B".

Deklaratat e "B" janë kundërshtuese dhe përmendin edhe B [redacted] G [redacted] si personi i cili së bashku me S [redacted] K [redacted] dhe të tjerët rrahën "B" gjatë paraburgimit të tij.

Në këtë rast, Gjykata e Shkallës së Parë nuk i besoi "B" sa i përket përfshirjes së Islam G [redacted], i cili në atë kohë ishte i lënduar rëndë, por i besoi dëshmitarit sa i përket S [redacted] K [redacted].

Për më tej, familja e B [redacted] B [redacted] ishte e përfshirë në një konflikt gjakmarrjeje me një familje tjetër dhe "B" do të ishte përpjekur të sjellte përgjegjësinë mbi anëtarët e UÇK-së në mënyrë që t'i shmangej obligimit që rrjedh nga Kanuni. Përfundimisht, eshtrat e B [redacted] B [redacted] janë gjetur në varrezat e Pejës dhe nuk do të ishte e mundur që S [redacted] K [redacted] të mbahej përgjegjës për këtë fakt.

Gjykata është e mendimit që kjo pjesë e ankesës nuk është e bazuar.

Me qëllimin që të kthehemi më vonë te dëshmia e "A" dhe provave të tjera, këtu duhet të shqyrtohet dëshmia e "B".

Anonimiteti i dëshmitarit "B" është sjellë në dyshim gjatë shqyrtimit kryesor për shkak të komenteve të dy avokatëve mbrojtës që i shprehën këtij ngushëllime për vdekjen e një të afërmi dhe për shkak të komentit të të pandehurit X [redacted] E [redacted] i cili tha që familja e tij dhe ajo e dëshmitarit "njihen mjaft mirë".

Para dëshmitarit dhe pavarësisht nga anonimiteti i tij, të pandehurit mund të mbroheshin. Vetë dëshmitari foli për vrasjen e një të afërmi të tij.

Ky dëshmitar është marrë në pyetje nga të gjitha palët dhe duket që deklaratat e tij ishin të sinqerta, duke qenë se kundërshtimet e qarta nuk janë vendimtare për kredibilitetin e tij.

Ky ishte i pranishëm më 3 qershor në çastin e arrestimit të B [redacted] B [redacted] nga dy persona të UÇK-së, të cilët i njihte.

Më 4 qershor, një person tjetër nga "B" shkoi në Drenovc në kërkim të B [redacted] dhe është mbajtur aty për tre ditë.

"B" i kujtohet që ka shkuar në Drenovc më shumë se 30 herë në kërkim të B [redacted] B [redacted] atij nuk i ëshët lejuar t'i afrohej burgut secilën herë, personat që ishin aty i përkisnin UÇK-së.

Nga fotografitë, ky njohu shkollën, e cila ndodhej afër selisë së UÇK-së.

Përfundimisht më 13 korrik 1998, ky ia doli të takonte B [redacted] B [redacted], i cili kishte rënë në peshë shumë, ishte i parruar, i uritur, rrobat e tij kishin njolla gjaku, ky qau, takimi është mbajtur në një dhomë 4x4 dhe zgjati vetëm 20 minuta.

Ky më nuk e takoi B [redacted] B [redacted] pavarësisht nga vizitat e tij në selinë e UÇK-së në Drenovc.

Në dëshminë e tij gjatë shqyrtimit kryesor, Dëshmitari Anonim "B" nuk deklaroi që është rrahur nga I [redacted] G [redacted] dhe S [redacted] K [redacted] dhe as nuk jep përkrahim të këtij të fundit.

Në të vërtetë, kjo pjesë e ankesës nuk i referohet dëshmitarit "B".

Në Drenovc, disa persona afër selisë i kanë thënë "B" që personat që mund të zgjidhin problemet e tij ishin B [redacted] Z [redacted] dhe S [redacted] K [redacted].

"B" takoi B [redacted] Z [redacted] më 16 korrik ndërsa K [redacted] kurrë nuk e takoi personalisht.

Sa i përket E [redacted], dëshmitari "B" gjatë shqyrtimit kryesor tha që e takoi atë në Brestovc si dhe në Drenovc. Ndërsa Gjykatësit Hetues i kishte thënë që e ka takuar vetëm në Brestovc, duke mohuar kështu takimin në Drenovc.

E [redacted] mohoi ndonjë takim në Drenovc, por vuri re që dy familjet njiheshin mjaft mirë në mes vete.

Gjatë shqyrtimit kryesor, kishte një koment lidhur me rrezikun e mundshëm që do t'i shkaktohej anonimitetit të "B" me përgjigjet e dhëna në pyetjet e shtruar nga E [redacted].

Prandaj, ndonjë gabim në kujtesën e "B" lidhur me takimin me E [REDACTED] është i mundshëm: mirëpo, kjo nuk ndikon në kredibilitetin e përgjithshëm të dëshmitarit. Tërheqja e akuzës kundër X [REDACTED] E [REDACTED] nga ana e Prokurorit Ndërkombëtar nuk përmend dhe as nuk kundërshton deklaratën apo kredibilitetin e "B".

Përfundimisht, nuk ka asnjë indikacion që familja B [REDACTED] apo persona të tjera kanë bërë përpjekje që të vendosin përgjegjësinë lidhur me zhdukjen e B [REDACTED] B [REDACTED] mbi anëtarët e UÇK-së me qëllim të shmangies nga obligimet që dalin nga ligji i Kanunit, lidhur me konfliktin e gjakmarrjes.

10. H [REDACTED] K [REDACTED]

Ankesa kundërshton kredibilitetin e Dëshmitarit Anonim "TT" për shkak të disa papërputhshmërive, duke cekur që roli që ky dëshmitar i atribuon S [REDACTED] K [REDACTED] është ai i një ushtari të thjeshtë dhe pa ndonjë pozitë të veçantë funksionale ushtarake.

Gjykata është e mendimit që kjo pjesë e ankesës nuk është e bazuar, me ç'rast vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë del të jetë korrekt.

Sa i përket të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] vendimi i kundërshtuar shqyrton dëshmitë e "N" dhe "TT" në katër pika: përshkrimi i qendrës së paraburgimit në Drenovc (faqja 64, verzioni anglisht), rrëmbimin e H [REDACTED] K [REDACTED] (faqja 68), përshkrimin dhe njohjen e të pandehurve (faqet 75 dhe 76) dhe përfshirjen e këtij të pandehuri (faqja 85 dhe 86).

"N" dhe "TT", ndër të tjerët, përshkruajnë qendrën e paraburgimit në Drenovc.

Këta përshkruajnë çastin dhe rrethanat e rrëmbimit të H [REDACTED] K [REDACTED] nga i pandehuri A [REDACTED] K [REDACTED] dhe dy anëtarë të tjerë të UÇK-së.

Këta dy dëshmitarë kanë qenë shumë herë në Drenovc për të vizituar H [REDACTED] dhe për këtë qëllim, kanë biseduar me tre të pandehurit e shqyrtimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

"TT" u kujtua që S [REDACTED] K [REDACTED] i tha të bisedonte me B [REDACTED] Z [REDACTED] ndërsa ky i fundit i tha që të fliste me S [REDACTED] K [REDACTED] sepse kjo çështje ishte kompetencë e tij si komandant i policisë.

Sipas "N", më në fund dhe me lejen e P [REDACTED], ia doli të vizitonte H [REDACTED] për 15-20 minuta.

"TT" u kujtua që njëherë ishte S [REDACTED] K [REDACTED] ai që pranoi rroba dhe ushqime nga ky për H [REDACTED] dhe më vonë që të dy "TT" dhe "N" u lejuan që të vizitojnë H [REDACTED] në praninë e S [REDACTED] K [REDACTED].

Kundërshtimet në deklaratat e dhëna nga "N" shqyrtohen dhe zgjidhen nga Gjykata e Shkallës së Parë duke theksuar dhe pranuar deklaratën e tij dhënë policisë më 29 nëntor 2001, me ç'rast ky dëshmitar identifikoi fotografinë e S [REDACTED] K [REDACTED] si njeriu që i dha leje për të vizituar H [REDACTED] dhe në këtë duke refuzuar të pranonte dëshminë gjatë shqyrtimit kryesor folur për Z [REDACTED] dhe jo S [REDACTED] K [REDACTED].

Gjithashtu, "TT" identifikoi S [REDACTED] K [REDACTED] në radhitjen e fotografive.

Provat në dosjen e lëndës konfirmojnë vlerësimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Në deklaratën e dhënë Policisë më 3 korrik 2000, "N" deklaroi që S [REDACTED] K [REDACTED] me pseudonimin "C [REDACTED]" ishte një ndër anëtarët e UÇK-së, të pranishëm në vizitën H [REDACTED] H [REDACTED] ishte shumë i dobët dhe kishte njolla gjaku në rroba.

Më 29 nëntor 2001, dëshmitari "N" njohu fotografinë e të pandehurit S. K., ishte 90% i sigurt: ky njeri përshkruhet si "komandanti i policisë në burgun në Drenovc", i cili dha lejen për të vizituar H.

Te Gjykatësi Hetues, "N" përmendi S. K. si një ndër personat me të cilët foli në Drenovc lidhur me fatin e H. dëshmitari me dy shokë kishin pyetur I. S. G. i cili i kishte drejtuar te B. Z. te "komisari politik", i cili i kishte drejtuar te S. K. i cili i drejtoi te X. G. i njohur me nofkën "G".

Ata u përpoqën të bisedojnë edhe me A. K., por pa ndonjë rezultat.

"N" shkoi në Drenovc shpesh, rreth 5-6 herë, më në fund, pesë javë pas rrëmbimit të H., "N" dhe "TT" biseduan me S. K., G. P. dhe B. Z.

S. K. dhe G. P. thanë që duhet të bisedojnë me dikë tjetër, por më vonë u mundësuan "N" dhe "TT" të bisedojnë me H.

H. ishte në gjendje të rëndë, kishte rënë në peshë mjaft, ishte i parruar, kishte thonj të paprerë, rrobat i kishte të përbaltura pasi që flinte në ahur të përbaltur dhe ishte i njollosur me gjak.

"N" përshkroi S. K. si jo shumë të gjatë, flokë të zinj, jo shumë i trashë, mjaft i vogël, rreth moshës 40 vjeçe apo më i ri dhe e njohu me siguri (100%) në rradhitjen e fotografive, numër 1, fotografia nr. 23.

Rezulton që Fotografia nr. 23 është ajo e të pandehurit S. K.

Gjatë shqyrtimit kryesor (seanca më 24 maj 2006) "N" foli për një komandant me emrin Z. K. dhe një person me emrin P. ky i fundit i mundësoi dëshmitarit dhe "TT" të takojnë H. i cili u duk "pak i zbehtë".

Në pyetjen se cili e kishte arrestuar H. "N" u përgjigj duke thënë A. K. të cilin e njohte mjaft mirë.

Në pyetjen se nga e njohte ky A. K. "N" nuk dha përgjigje të qartë, duke thënë në fillim që e njohte nga ajo ditë në oborrin e H. e pastaj duke thënë që e kishte njohur më parë, pastaj "N" kërkoi që të fliste me Prokurorin dhe nuk është lejuar, më në fund tha që e ka takuar A. K. për herë të parë dy javë para rrëmbimit të H.

Çdo pyetje ishte e shoqëruar me paralajmërimin që të mos rrezikohej anonimiteti dhe siguria e tij gjatë përgjigjes.

Ishin tre persona që kishin arrestuar H.: A. K., Z. K. dhe B. dhe i treti, emri i të cilit dëshmitarit nuk i kujtohej.

I konfrontuar me përgjigjen e dhënë Gjykatësit Hetues, ku "N" kishte përmendur edhe I. G. dëshmitari e mohoi duek thënë që G. nuk ishte i pranishëm dhe që kishte ndodhur një gabim gjatë përkthimit.

Në Drenovc, "N" mbeti jashtë selisë ndërsa "TT" u fut brenda; aty "N" takoi Z. B., nuk foli me askënd me seli.

I konfrontuar me atë që i kishte thënë Gjykatësit Hetues, "N" u përgjigj duke thënë që nuk i kujtohej kjo.

Ishte "TT" ai që përmendi që ka folur me këta njerëz.

B. Z. i ka thënë "N" që nuk dinte asgjë për H. dhe e kishte drejtuar te P.

I konfrontuar me deklaratat e tij të mëparshme, "N" tha që e kishte fjalën për G [REDACTED] P [REDACTED], të quajtur R [REDACTED] dhe Z [REDACTED] K [REDACTED] por jo S [REDACTED] K [REDACTED].

"N" është kthyer në Drenovc tre herë dhe herën e tretë, ia doli të takonte H [REDACTED]. Të pranishëm në vizitë ishin Z [REDACTED] K [REDACTED] G [REDACTED] P [REDACTED] dhe një person me emrin I [REDACTED].

I konfrontuar me deklaratat e tij të mëparshme, ku kishte përmendur si të pranishëm edhe I [REDACTED] G [REDACTED], "N" u përgjigj duke përmendur një ngatërrim me dikë tjetër dhe që nuk i kujtohej që ka thënë ashtu.

Edhe deklarata e dhënë në polici nuk mund të jetë e saktë sepse Zyrtari i Policisë e kishte intervistuar për 10 orë, më vonë "N" e korrigjoi kohën për 4 orë.

Ai mohoi të ketë takuar S [REDACTED] K [REDACTED], ai kishte takuar Z [REDACTED] K [REDACTED] B [REDACTED].

"N" kurrë nuk kishte takuar S [REDACTED] K [REDACTED] në Drenovc para ofensivës së serbëve dhe deklaroi që kurrë nuk i kishte thënë këtë policisë.

I konfrontuar me deklaratat e mëparshme, sipas së cilave kishte takuar S [REDACTED] K [REDACTED] në Drenovc, "N" përsëriti që e kishte pasur fjalën për Z [REDACTED] dhe jo S [REDACTED] K [REDACTED].

Me sa e dinte ky, H [REDACTED] ka mundur të jetë liruar, kthyer në Prizren dhe arrestuar apo rënë në pritën e serbëve.

Në fotografitë (prova C) "N" njohu fotografitë e A [REDACTED] K [REDACTED] B [REDACTED] Z [REDACTED] dhe I [REDACTED] S [REDACTED].

Në Polici (2/6/2001) "TT" kishte thënë që A [REDACTED] Z [REDACTED] dhe S [REDACTED] K [REDACTED] ishin anëtarë të UÇK-së në Drenovc.

Duke folur në veçanti për Selimin, "TT" tha që ky io pandehur kishte pranuar rroba të pastra për H [REDACTED] ndërsa më vonë Agroni ishte ai që i ktheu ato të përlyera.

S [REDACTED] ishte i pranishëm kur P [REDACTED] lejoi vizitën H [REDACTED]; sërish, S [REDACTED] K [REDACTED] së bashku me anëtarët e tjerë të UÇK-së ishin të pranishëm në këtë vizitë.

Disa ditë më vonë, të burgosurit nuk ishin më në Drenovc për shkak të masave të sigurisë.

Më 29 nëntor 2001, "TT" njohu fotografinë e të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED], të përshkruar si "komandanti i policisë në burg".

Gjykatësit Hetues, "TT" i kishte deklaruar që ka biseduar me disa anëtarë të UÇK-së kur ky dhe të tjerët shkuan në Drenovc ditën pas rrëmbimit të H [REDACTED].

Në mesin e anëtarëve të tjerë të UÇK-së, ai ka folur edhe me S [REDACTED] K [REDACTED] i cili e drejtoi te B [REDACTED] Z [REDACTED], i cili ishte "komisari politik".

"TT" është kthyer disa herë në Drenovc, pa pasur miratimin që të vizitohë H [REDACTED].

Ai bisedoi sërish më Z [REDACTED] dhe S [REDACTED] K [REDACTED].

Secili prej tyre e drejtoi "TT" te tjetri, i cili do të kishte kompetencë në këtë rast: B [REDACTED] Z [REDACTED] si komisar politik dhe S [REDACTED] K [REDACTED] si komandant i policisë.

Z [REDACTED] dhe S [REDACTED] K [REDACTED] që të dy paralajmëruan "TT" dhe të tjerët që të mos vinin më.

Pasi që "TT" insistonte të kuptonte arsyet për kapjen e H [REDACTED], Z [REDACTED] e kishte pyetur nëse edhe ky dëshironte të arrestohej.

"TT" është kthyer në burg dhe kërkoi lejen e A [REDACTED] K [REDACTED] për t'i dhënë rroba H [REDACTED].

Në mes të "TT" dhe Agronit kishte plasur një grindje, së cilës i është vënë fundi nga intervenimi i S. K. i cili dërgoi A. në punën e tij dhe pranoi rrobat për H.

Rrobat e përlyra iu kthyen "TT" nga I. dhe A. K.

Ditën në vijim "TT" është kthyer në Drenovc duke sjellë rroba të pastra dhe duke marrë ato të papastra te cilat ishin te njollosura me gjak.

"TT" dhe shokët e tij të tjerë mundën të takonin H. një herë me datë 16 korrik 1998 ditën e vrasjes së P.

Në këtë vizitë kanë qenë të pranishëm disa ushtarë të UCK-së mes të cilëve S. K. dhe Z. K. B.

H. dukej se ishte dobësuar, i parruar, rrobat e tij ishin të pista, thonjtë e paprerë.

Vizita ka zgjatur 15 minuta dhe pas kësaj "TT" nuk ka takuar më H.

Një oficer i policisë, I. B. që është vrarë më vonë gjatë luftës, i ka thënë "TT" se njerëzit brenda qendrës për paraburgim mbaheshin si kafshë dhe keqtrajtoheshin.

Burgu gjendej në bodrumin e një shkolle të vjetër dhe ruhej shumë nga policia ushtarake, kishte edhe njerëz të tjerë që vizitonin të burgosurit.

"TT" ka përshkruar S. K. si mesatarisht i gjatë, me flokë të zinj me pak a shumë të njëjtën moshë me atë të X. G. 42/43 vjet.

Ai ka njohur fotografinë e S. K. (identifikim fotografik nr 1, fotografia nr 23).

Duke u përgjigjur Avokatit Mbrojtës se si ai kishte njohur S. K., "TT" ka spjeguar se ai është prezantuar me atë nga njerëzit e Ushtrisë sepse "të gjithë në atë zonë njohin S. K." me pseudonim C.

Çdo herë që "TT" ka bërë vizitë në Drenovc ai ka takuar S. K., kjo ka ndodhur rreth 10 herë.

S. K. në fillim ishte zëvendës komandant i Policisë, "TT" ka marrur këtë informacion nga I. G. B. Z. dhe të tjerë nga Policia e Drenovcit.

Më vonë, pas vdekjes së G. P. S. K. është bërë komandant i policisë ushtarake.

Në gjykimin kryesor (seancë e datës 17 maj 2006) "TT" është kujtuar për arrestimin e H. i cili është dërguar në shkollën e vjetër në Drenovc, në lokalet e policisë ushtarake të UCK-së.

"TT" ishte ushtar në Drenovc.

"TT" i ka thënë Gjykatës se ai kishte folur me S. K. vetëm rastësisht disa herë, dy apo tre herë, dhe pastaj pas ballafaqimit me deklaratat e tij të mëparshme ai ka thënë dhjetë herë, S. ishte në uniformë të Policisë në zonën ushtarake afër Shtabit.

Ai ka biseduar me B. Z. sekretari politik i cili nuk ka marrë parasysh kërkesat e "TT" dhe të tjerëve në lidhje me H.

Ky dëshmitar nuk kujtohet të jetë dërguar për të biseduar me S. K. në lidhje me H. as nëse S. ka qenë i pranishëm kur ky ka bërë vizitë H. as se kush ka autorizuar vizitën, as nëse S. ka marrë rrobat e pastra për H.

Ai nuk kujtohej sa herë ka vizituar H. dhe është përgjigjur se "Agroni e din"

Ditën e vizitës H. dukej mirë dhe i ka thënë "TT" të "shkojë në familjen e A."

"TT" ka shkuar rreth 20 apo 30 herë për të marrë rrobat e pastra dhe ato të pista.

Rrobat e pista kishin njolla gjaku, maica ishte e mbuluar me gjak në pjesën e brendshme.

Dëshmitari është ballafaquar me deklaratat e tij të mëparshme në të cilat ai kishte mohuar praninë e njollave të gjakut në rrobat që ai kishte marrë ditën e vizitës.

Ai nuk njihnte personat që frekuentonin stacionin e Policisë, ai dhe shokët e tij ishin marrë vetëm me A [redacted] dhe Z [redacted].

Atij nuk i kujtohej I [redacted] B [redacted] dhe as komentet e bëra nga ky njeri në lidhje me kushtet e të burgosurve.

“TT” është përgjigjur shumë pyetjeve duke thënë se “A [redacted] din gjithçka” dhe se ai duhej të pyetet për këtë.

Ai ka mohuar se ka pasur një grindje me njerëzit e qendrës për paraburgim dhe kur ai është ballafaquar me deklaratat e tij të mëparshme ai tha se nuk kujtohej.

I pyetur nga avokati mbrojtës nëse deklaratat e tij të mëparshme përpara Gjyqtarit Hetues ishin rezultat i zemërimit “TT” është përgjigjur se ndoshta mund të ketë pasur gabime në përkthim por jo zemërim.

Asgjë nuk kishte ndodhur mes tij dhe S [redacted] K [redacted].

Kjo Gjykatë vëren se deklaratat e dhëna nga “N” dhe “TT” gjatë gjykimit kryesor përpiqen të mohojnë atë që ata kanë thënë përpara Gjyqtarit Hetues në lidhje me përfshirjen konkrete të S [redacted] K [redacted] në paraburgimin e H [redacted] K [redacted].

Duke konsideruar këtë në mënyrë korrekte Gjyqtari i shkallës së parë gjen se kjo përpjekje nuk është bindëse.

Deklaratat e dy dëshmitarëve përpara Gjyqtarit Hetues janë dhënë në prani të Prokurorit dhe avokatëve mbrojtës.

Ato ishin të qarta, koherente, të përsëritura dhe të shoqëruara me njohjen e fotografive të të pandehurit.

Te dy kanë përmendur S [redacted] dhe Z [redacted] K [redacted] duke spjeguar rolet e ndryshme që kishin ata të dy në këtë rast, “N” ka përmendur edhe pseudonimin e S [redacted]: C [redacted] duke deklaruar se C [redacted] ishte i pranishëm gjatë vizitës së bërë H [redacted].

Në fund të deklaratave përpara Gjyqtarit Hetues gjendet fjalia “deklarata ime më është lexuar në gjuhën shqipe dhe unë konfirmoj më këtë se ajo pasqyron të vërtetën dhe procesverbalin e saktë të dëshmisë sime dhe se e kam nënshkruar atë pa qenë i detyruar”.

Kështu, nuk ka mundësi të ketë pasur gabime në përkthim apo keqkuptime në deklaratat e dy dëshmitarëve kur ata bëjnë dallimin mes S [redacted] dhe Z [redacted] K [redacted].

Deklaratat e dhëna nga dy dëshmitarët në gjykimin kryesor duken të pasigurta, të shoqëruara me tepër “nuk me kujtohet”, me nevojën për të folur me Prokurorin (“N”) apo duke shprehur një lloj sëmundje (“TT” thotë se nuk ndihet mirë, faqja 33).

Të dy janë përpjekur të spjegojnë se ishte dikush tjetër që dinte gjërat: “N” përsëriste se duhej të pyetej “TT” dhe ky i fundit që përsëriste se duhej të pyetej A [redacted] i cili din të gjitha.

Ata duket se zvogëlojnë gjërat në lidhje me kushtet e H [redacted]: në këtë pikë “TT” ka tejkalluar çdo mundësi të arsyeshme duke deklaruar se H [redacted] “dukej mirë” edhe pse këmisha e tij ishte e mbuluar me gjak.

Nuk duhet të harrohet se “TT” ishte ushtar në Drenovc, pra ai ka qenë vazhdimisht atje, ka shkuar rreth 20/30 herë për të sjellë rrobat e pastra tek H [redacted] dhe megjithatë ai pretendon se nuk ka njohur njerëzit që frekuentonin Stacionin e Policisë.

Të dy janë në kundërshtim me vetveten edhe në deklaratat e dhëna gjatë gjykimit kryesor: “N” në fillim deklaroi se është ekzaminuar nga policia për dhjetë orë dhe pastaj ai thotë

se kjo ka zgjatur katër orë, "TT" përmend tre raste kur ai ka takuar S [REDACTED] K [REDACTED] dhe pastaj ai korigjon këtë duke thënë dhjetë herë. Deklaratat e dhëna nga dy dëshmitarët në gjykimin kryesor të cilat përjashtojnë çdo lloj përfshirje të S [REDACTED] K [REDACTED] rezultojnë pra të pabesueshme. Gjykata e Shkallës së Parë mbështet vendimin e saj në deklaratat e mëparshme të këtyre dy dëshmitarëve dhe ky vlerësim është i saktë.

Këto deklaratat janë vetëm një pjesë e provave të lidhura me përfshirjen e S [REDACTED] K [REDACTED] në Qendrën për Paraburgim në Drenovc dhe në rastin konkret në lidhje me H [REDACTED] K [REDACTED]. Nuk duhet të harrohet se dëshmitari anonym "A" ka përmendur praninë e H [REDACTED] K [REDACTED] dhe se i pandehuri S [REDACTED] K [REDACTED] ka pranuar se ka takuar H [REDACTED] në oborrin e burgut dhe se ka kërkuar informata rreth tij. Dëshmitari anonim "E" kujtohet se ai është pyetur dhe rrahur nga S [REDACTED] K [REDACTED] i cili e ka pyetur mbi H [REDACTED] K [REDACTED]. Gjithë këto elemente mbështesin përgjegjësinë e të pandehurit.

11. H [REDACTED] P [REDACTED]

Ankesa kundërshton aktgjykimin dhe pohon se deklaratat e dhëna nga dëshmitarët "Z" dhe "D" në fakt nuk përmbajnë akuza direkte kundër S [REDACTED] K [REDACTED], në të dyja deklarohe se në lidhje me H [REDACTED] ata kanë pasur kontakte vetëm me G [REDACTED] P [REDACTED] i cili ka lejuar një vizitë tek i pandehuri dhe ka konfirmuar atyre se nuk është përdorur dhunë ndaj H [REDACTED]. Përkundrazi, ata deklarojnë se S [REDACTED] K [REDACTED] është parë në zyrën e P [REDACTED] është parë vetëm dy herë në Drenovc në Qershor dhe i kanë thënë dëshmitarit se kanë qenë në Shqipëri në Korrik dhe Gusht.

Gjykata e Shkallës së Parë ekzaminon rrëmbimin dhe burgimin e H [REDACTED] P [REDACTED] në veçanti në katër pika (faqet 8,55, 68-70 dhe 85-86) dhe bazon vendimin e saj në dëshminë e "Z", "D", "A", "E" dhe në prova të tjera në lidhje me përfshirjen e të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] në menaxhimin e qendrës për paraburgim.

H [REDACTED] P [REDACTED] është ndalur një herë dhe është pyetur në lidhje me H [REDACTED] R [REDACTED] një bashkëpunor i Policisë Serbe.

Më vonë, me datë 6 qershor djali i H [REDACTED] P [REDACTED] është arrestuar në Drenovc nga ushtarë të UCK-së të cilët kanë propozuar të ndërrojnë këtë djalë me babain e tij.

Kështu ditën në vijim H [REDACTED] ka shkuar në qendrën për paraburgim dhe është arrestuar ndërsa djali i tij është liruar.

"Z" ka kërkuar H [REDACTED] në qendrën për paraburgim në Drenovc, ka takuar B [REDACTED] Z [REDACTED] R [REDACTED], si dhe S [REDACTED] K [REDACTED] dhe I [REDACTED] B [REDACTED].

Ai është informuar nga I [REDACTED] B [REDACTED] se A [REDACTED] K [REDACTED] dhe R [REDACTED] ishin ata që ishin marrë me keqtrajtimin dhe rrahjen nëse kjo gjë është bërë.

R [REDACTED] i ka thënë atij se H [REDACTED] gjendej në duart e Policisë dhe i ka propozuar dëshmitarit të shkëmbejnë H [REDACTED] me një person tjetër.

"Z" ka parë H [REDACTED] me duar të lidhura apo të prangosura prapa shpinës, "shprehja e fytyrës së tij nuk ishte e mirë", në atë moment H [REDACTED] është dërguar tek R [REDACTED] dhe është ndjekur nga A [REDACTED] K [REDACTED].

"Z" ka takuar aty edhe S [REDACTED] K [REDACTED] ky i fundit ishte në uniformë ushtarake. Në një rast, me datë 12 dhe 13 qershor, "Z" ka kërkuar shefin e Policisë dhe pas një pritje ai është pritur nga S [REDACTED] K [REDACTED].

"Z" e ka pyetur atë për H [REDACTED] dhe i pandehuri është përgjigjur duke përmendur një vizitë të bërë nga njerëz prej Shtabit dhe se ata ishin duke pritur informacione.

Në faqen 86 të vendimit të shkallës së parë përmendet edhe një pikë tjetër e dëshmisë së "Z" ku ai deklaron se S [REDACTED] K [REDACTED] po bënte negociata, duke dhënë kushtet për lirin e H [REDACTED].

"D" (faqja 55) kujtohet se ai dhe H [REDACTED] ishin ndaluar nga ushtarë të UCK-së të cilët donin të dinin në lidhje me H [REDACTED] R [REDACTED], një person të cilin të dy "D" dhe H [REDACTED] e njihnin si dikë që punonte për Policinë Serbe.

Për rrjedhojë H [REDACTED] është arrestuar nga UCK-ja.

"D" ka shkuar në Drenovc në kërkin të H [REDACTED] dhe ka biseduar në lidhje me këtë me S [REDACTED] K [REDACTED] i cili e ka larguar atë.

H [REDACTED] është arrestuar pastaj nga UCK-ja.

"D" ka deklaruar se H [REDACTED] është mbajtur në paraburgim në Drenovc.

"A" ka parë H [REDACTED] në qendrën për paraburgim në Drenovc ku është mbajtur edhe ai. "A" ka njohur H [REDACTED] që më parë meqënëse atij i kujtohej se H [REDACTED] ishte i mbuluar me gjak në qendrën e paraburgimit.

Gjithashtu "E" konfirmon se ka dëgjuar se H [REDACTED] ishte dërguar në qendrën për paraburgim.

Përmbajtja e vendimit të shkallës së parë rezulton logjike në lidhje me përfshirjen e të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] në burgimin e H [REDACTED] P [REDACTED] ai konsiderohet si pjesëmarrës në menaxhimin e burgut sepse ai flet në emër të Shefit të Policisë kur ky i fundit nuk është i pranishëm dhe sepse ai negocion lirin duke parashtruar kushte.

Provat që gjenden në dosjen e lëndës konfirmojnë vlerësimin e Gjyqtarit të Shkallës së Parë. "D" është kujtuar përpara Gjyqtarit Hetues (20 shtator 2004) se H [REDACTED] ishte ndaluar më parë në maj nga UCK-ja dhe pyetur në lidhje me H [REDACTED] R [REDACTED] një bashkëpunor i Policisë Serbe, një person të cilit i kishte dhënë disa para.

H [REDACTED] ishte liruar pas marrjes në pyetje.

Mes ushtarëve të UCK-së ishte i pranishëm edhe S [REDACTED] K [REDACTED] C [REDACTED], i cili kishte dhënë urdhrin që H [REDACTED] të dërgohej në Shtab për tu marrë në pyetje.

Disa ditë më vonë, M [REDACTED] djali i H [REDACTED] ishte arrestuar nga ushtarë të UCK-së të cilët kanë propozuar të shkëmbejnë të riun me babain e tij.

Shkëmbimi është bërë dhe H [REDACTED] është arrestuar me datë 7 qershor.

"D" ka takuar S [REDACTED] K [REDACTED] edhe një herë tjetër mes qershorit dhe korrikut dhe e ka pyetur për H [REDACTED].

Përgjigja ka qenë se H [REDACTED] ishte në rregull, shëndosh e mirë, megjithatë "D" nuk është lejuar të vizitojë H [REDACTED] dhe është kthyer prapsht.

Në shtator "D" është kthyer në Drenovc, kun ë shkollë ka takuar S [REDACTED] K [REDACTED], të cilin e ka pyetur edhe një herë për fatin e H [REDACTED].

I pandehuri ka pretenduar se nuk dinte asgjë.

"D" ka përshkruar S [REDACTED] K [REDACTED] si më i shkurtë se 177cm, flokë të kuq, rreth 26-28 vjeç.

Gjatë gjykimit kryesor "D" ka shtuar se në rastin e parë, pyetjes se pse po e mbante në paraburgim H [REDACTED] S [REDACTED] K [REDACTED] i është përgjigjur "Duhet ta pyes për diçka". Në fakt H [REDACTED] ishte duke u marrë në pyetje nga një oficer tjetër i UCK-së me emër C [REDACTED].

"D" ka njohur S [REDACTED] K [REDACTED] në identifikim fotografik dhe ka spejguar se në shtator kur ai ka shkur të pyesë për H [REDACTED], ai ka kërkuar me qëllim S [REDACTED] K [REDACTED] i cili ishte "njeriu kryesor i asaj zone".

"Z" është kujtuar përpara Gjyqtarit Hetues (8 shtator 2004) se me datë 16 qershor 1998 ai ka shkuar në Drenovc në kërkim të vendndodhjes së H [REDACTED] i cili ishte arrestuar me datë 7 qershor.

"Z" është prezantuar R [REDACTED] i cili ka informuar atë se H [REDACTED] nuk kishte bërë asgjë të keqe dhe se ata kishin propozuar një shkëmbim mes H [REDACTED] dhe N [REDACTED] P [REDACTED] një bashkëpunor i Policisë Serbe.

"Z" është përgjigjur se nuk mund të dërgonte N [REDACTED] tek UCK-ja.

Të nesërmen "Z" është kthyer në Drenovc dhe ka takuar në zyrën e R [REDACTED] S [REDACTED] K [REDACTED] i quajtur edhe C [REDACTED] dhe një person të tretë.

"S [REDACTED] K [REDACTED] nuk e ka lënë R [REDACTED] të flasë" dhe ka pyetur "Z" pse kishte ardhur. "Z" ka spjeguar përsëri se nuk mund të sillte N [REDACTED] dhe S [REDACTED] K [REDACTED] i është përgjigjur "ky vazhdon të jetë kushti dhe nëse ti sjell atë person ti mund të marrësh H [REDACTED]".

Pastaj S [REDACTED] ka "urdhëruar" dëshmitarin dhe shokun që e shoqëronte të ktheheshin në shtëpi.

Disa ditëve në vijim H [REDACTED] ka dërguar në shtëpi dhëmbët e tij të vendosur për ti riparuar dhe pastaj "Z" dhe një njeri tjetër kanë shkuar në Drenovc për të sjellë dhëmbët e riparuar.

Në këtë rast "Z" është pritur nga R [REDACTED] në zyrën e tij, ishin të pranishëm edhe C [REDACTED] dhe një tjetër polic.

S [REDACTED] K [REDACTED] ka kërkuar një polici që të sjellë H [REDACTED] aty.

Vizita është bërë në shkollë të cilën "Z" e ka njohur në fotografi.

Gjatë vizitës "Z" nuk ka parë ndonjë plagë tek H [REDACTED], ky i fundit nuk ka dashur të ndërrojë rrobat.

Pas një bisede me H [REDACTED], S [REDACTED] K [REDACTED] ka thënë "Z" dhe shokut të tij se vizita kishte mbaruar dhe se ata duhej të ktheheshin në shtëpi.

"Z" ka pyetur H [REDACTED] përmes S [REDACTED] K [REDACTED] nëse ai kishte nevojë për para por ky i fundit ka refuzuar.

"Z" ka mësuar nga I [REDACTED] B [REDACTED] se nuk kishte dëshmi negative kundër H [REDACTED] përveç se "ai kishte blerë një makinë nga H [REDACTED] R [REDACTED] i cili i përkiste Policisë Serbe".

Disa ditë më vonë "Z" ka shkuar të takojë S [REDACTED] K [REDACTED] sepse R [REDACTED] kishte vdekur. S [REDACTED] i tha se gjatë kohës së ofensivës serbe ai gjendej në Shqipëri dhe se nuk e dinte se kush ishte dërguar H [REDACTED].

S [REDACTED] shtoi se ditën përpara ai ishte vizituar nga persona nga Shtabi dhe se ai u kishte dhënë atyre një listë me emrat e personave që kërkoheshin nga familjarët e tyre.

S [REDACTED] ishte në pritje të një përgjigje në lidhje me këta persona si dhe për H [REDACTED].

"Z" ka përkrahur S [REDACTED] K [REDACTED] si rreth 165-171cm, 75kg dhe e ka njohur atë në fotografi, "Z" ka mësuar nga I [REDACTED] B [REDACTED] se emri C [REDACTED] ishte S [REDACTED] K [REDACTED].

"Z" ka takuar S. K. tre herë, herën e parë me datë 17 qershor, herën e dytë në fillim të korrikut, herën e fundit në fund të gushtit apo fillim të shtatorit kur i pandehuri i ka spjeguar atij në lidhje me vizitat e personave nga Shtabi.

Gjatë dy herëve të para ai ka takuar S. K. i pandehuri ishte zëvendësi i R. Herën e tretë K. kishte pozitën që kishte R. që është Shef i Lartë i Policisë.

Gjatë gjykimit kryesor "Z" ka përsëritur deklaratat e tij të mëparshme dhe njohjet positive të fotografive të të pandehurit dhe të shkollës.

Ai ka shtuar se kur ka takuar H. në burg, ky i fundit ka pretenduar se dikush nga fshati kishte bërë akuza kundër tij.

Në shtator "Z" ka mësuar nga Z. B. se të burgosurit janë zhvendosur nga Drenovci në kohën e ofensivës serbe.

"Z" ka kërkuar shefin e Policisë dhe është pritur nga S. K. dhe ka spjeguar në lidhje me vizitën e personave nga Shtabi.

Dëshmitari anonim "O" 15 ka treguar se ka takuar H. P. dhe të burgosur të tjerë (H. T. dhe një person me emër H. me origjinë Rom) në qendrën për paraburgim të Malishevës në ditët pas datës 20 dhe 21 korrik 1998, ku ai ka kaluar gjashtë ditë.

"O" ka dhënë një përshkrim të H. dhe e ka njohur atë në fotografi.

"O" ka shtuar se trupat e H. dhe të burgosurve të tjerë janë duken të ënjtur dhe të mavijosur, ata kanë thënë se janë mbajtur në paraburgim në fshatin Drenovc dhe se ata ishin rrahur disa herë.

Duke lënë për një moment tjetër ekzaminimin e dëshmimeve të dëshmitarëve "A" dhe "E" mund të vërehet se dëshmitë e "D" dhe "Z" përshkruajnë të pandehurin S. K. si i përfshirë në thellësi në menaxhimin e burgut, në gjendje të japë urdhra Policisë Ushtarake me qëllim që të ndalojë H. dhe ta shoqërojë atë për një intervistë, të sjellë H. nga burgu për vizitë dhe mbi të gjitha të vendosë kushtet për lirimin e tij.

Ai përshkruhet si Zëvendës Shef i Policisë Ushtarake dhe është identifikuar në fotografi nga dy dëshmitarët.

Dëshmia e "O" konfirmon në mënyrë indirekte se H. ishte rrahur në Drenovc.

12. Këtu duhet të shtohet vlerësimi i deklaratave të dëshmitarit anonim "A" të cilat janë kundërshtuar në ankesë në aspektin e konsekuences dhe besueshmërisë.

Rezultoni në fakt se "A" i referohet faktit të lidhur me arrestimet e tij, paraburgimin dhe lirimin në mënyrë korrekte dhe logjike.

Sa herë që ai është pyetur, nga deklarata e parë përpara Policisë deri tek seanca e dytë e gjykimit kryesor ku atij i janë bërë pyetje nga avokatët mbrojtës, "A" ka përsëritur se ka shkuar në Drenovc herën e parë duke kërkuar B. B. (ky emër është maskuar përpara Policisë dhe Gjyqtarit Hetues) dhe se është arrestuar dhe burgosur për tre ditë, pastaj është liruar por pas disa ditësh dhe me kërkesë të dëshmitarit "B" ai është kthyer në Radoste, përsëri në kërkim të B. B. ku ai është arrestuar edhe një herë, dërguar në Drenovc, mbajtur në paraburgim për tre apo katër ditë dhe më në fund është liruar.

Gjatë gjitha intervistave "A" ka deklaruar se ka takuar B [REDACTED] B [REDACTED] dhe H [REDACTED] nga fshati Dajne vetëm gjatë periudhës së parë të tij në Drenovc, se ka takuar S [REDACTED] S [REDACTED] gjatë të dy rasteve dhe se ka takuar edhe H [REDACTED] P [REDACTED]. "A" ka njohur B [REDACTED] B [REDACTED] dhe H [REDACTED] P [REDACTED] që përpara periudhes kritike dhe i ka njohur ata.

Ky dëshmitar nuk ka njohur S [REDACTED] S [REDACTED], ai nuk ka dëgjuar emrim e tij në Qendrën për parburgim, por me vonë kur ai ka vizituar nënën e S [REDACTED].

Përshkrimi i dhënë nga "A" është ai i një njeriu të shkurtë dhe të shëndoshë, me një maicë ngjyrë gri, pantallona të gjelbër me një vijë dhe patika të pastra të bardha.

S [REDACTED] ishte shumë i fortë, tregonte një qëndrueshmëri shumë të lartë edhe pse ai ishte rrahë shumë.

H [REDACTED] nga fshati Dajne ishte një njeri i gjatë, rreth 188cm dhe kishte lëkurë të kthjellët. Këto elemente të përshkrimit duket se përputhen me ato të dhëna nga S [REDACTED] S [REDACTED] (djali i saj ishte më i shkurtë se mesatarja, fytyrë të rrumbullakët, sy ngjyrë blu, ngjyrë flokësh natyrore, i mbushur) dhe me një pjesë përshkrimi të H [REDACTED] K [REDACTED] të dhënë nga i pandehuri S [REDACTED] K [REDACTED] (një djalë shumë i gjatë).

Dëshmitë e "A" nuk deri në këtë pikë nuk kundërshtohen.

"A" ka deklaruar se ai është rrahur në mënyrë të përsëritur nga tre individë të cilët dukeshin si ushtarë të UCK-së: dy nga ata ai i ka treguar gjithmonë si Islam dhe C [REDACTED].

Ai ka mësuar emrin e C [REDACTED] vetëm më vonë. Ky njeri ishte S [REDACTED] K [REDACTED]. Ky dëshmitar ka referuar se ka pasur plagë personale nga ajo përvojë, ai ka treguar një shenjë plage në kokë dhe se që nga ajo kohë ai nuk dëgjon dhe as nuk sheh mirë dhe se ndonjëherë ai humb ekuilibrin.

"A" ka njohur fotografinë e të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] dy herë: herën e parë gjatë dhënies së deklaratës përpara Policisë (23 nëntor 2001) dhe herën e dytë gjatë deklaratës së dhënë para Gjyqtarit Hetues me datë 26 shkurt dhe 3 mars 2004 (faqja 10 e versionit anglisht, identifikimi fotografik nr 1 fotografia nr 23).

Gjatë Gjykimit Kryesor (në vitin 2006) dëshmitarit i është dhënë një lupë me qëllim që të ekzaminojë fotografitë por ai nuk ka mundur të identifikojë përsëri të pandehurin.

Ai ka spjeguar se ka qenë i sigurtë në lidhje me identifikimet e tij përpara Gjyqtarit Hetues por megjithatë prej asaj kohe shikimi i tij është përkeqësuar shumë.

Duhet të vërehet se në deklaratën përpara Policisë "A" nuk tregon fotografinë e të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] si një nga ata njerëz që e kanë kërcënuar atë por vetën si një njeri i stafit, me një pistoletë dhe një gradë të lartë.

Përpara Gjyqtarit Hetues "A" ka treguar fotografinë e të pandehurit si ajo e një oficeri apo ngjashëm.

Dëshmitë e "A" janë kundërshtuar nga avokatët mbrojtës për shkak të shumë mospërputhjeve dhe kundërshtimeve të pretenduara që mund të përmbliidhen si në vijim

Ai në vazhdimësi ka treguar emrat e vetëm dy apo tre njerëzve që e kanë rrahur atë si C [REDACTED] dhe I [REDACTED], djali i Isufit, ndërsa për të tretin ai ka treguar emrin e R [REDACTED] përpara Policisë dhe në gjykimin kryesor, ndërsa përpara Gjyqtarit Hetues ai ka folur për G [REDACTED].

Përpara Policisë "A" ka deklaruar se ka dëgjuar këta tre njerëz duke thirrur njëri tjetrin me këta emra dhe ka përshkruar:

C [redacted] si 165 cm, i gjatë i imët, flokë të pakësuar, sy të zi dhe flokë të zi dhe gri:
R [redacted] ishte 180cm, shpatulla katrore, mjekër të gjatë, sy dhe flokë ngjyrë kafe;
Personi i tretë ishte i ri, 24/25 vjeç, i imët, 170cm, mjekër të trashë, sy të zi.
Përpara Gjyqtarit Hetues "A" ka përshkruar C [redacted] si 183cm, i gjatë, rreth 88 kg, topolak.

I [redacted] nuk ishte i gjatë, flokë të zi, 26/28vjeç.

G [redacted] ishte pak më i gjatë se C [redacted] i fortë.

Në gjykimin kryesor "A" ka përshkruar I [redacted] si i imët, i ri dhe i shkurtë;

C [redacted] ishte i moshës së mesme, jo i shëndoshë dhe as i imët, ishte më i mbushur dhe i shëndoshë dhe më i gjatë se I [redacted], ai ishte 170/175 cm i gjatë.

Në gjykimin kryesor "A" ka deklaruar se ka pyetur në Drenovc dhe se ka mësuar se C [redacted] ishte S [redacted] K [redacted] dhe pastaj ka ndryshuar vendin ku ai kishte dëgjuar këtë emër nga Drenovc në Rahovec.

Duke iu përgjigjur një pyetje të palës mbrojtëse "A" tha se ai nuk kishte parë kurrë S [redacted] K [redacted] në media apo gazeta.

Përpara Policisë "A" ka deklaruar se ka takuar edhe H [redacted] T [redacted] në Drenovc ndërsa përpara Gjyqtarit Hetues ai ka mohuar këtë dhe ka spjeguar se T [redacted] ishte mbajtur në paraburgim pas tij.

Ai nuk ka johur S [redacted] S [redacted] përpara ngjarjeve dhe as ka ditur emrin e tij gjatë paraburgimit.

Ai kishte dëgjuar se S [redacted] S [redacted] dhe H [redacted] ishin në burg, ka shkuar në Prizren dhe ka takuar nënën e S [redacted] dhe ka krahasuar përshkrimin e njeriut dhe të rrobave të tij të lartpërmendur.

Përsa i përket H [redacted] atij i kujtohej gjatësia e tij dhe se kishte dëgjuar nga njerëzit për të. Kur a i ka parë, ata ishin të dy plot gjak.

Përpara Gjyqtarit Hetues "A" i janë kujtuar pesë gra që mbaheshin dhe që janë rrahur në Drenovc, ai ka deklaruar të njëjtën gjë në gjykimin kryesor por nuk kishte folur për këtë përpara Policisë.

Përpara Policisë dëshmitari i është kujtuar H [redacted] P [redacted] si i pranishëm në Drenovc gjatë periudhës së parë të mbajtjes së vetë tij në paraburgim (deklarata e datës 20 mars 2000) dhe gjatë periudhës së dytë të burgimit të tij (deklarata e datës 27 qershor 2001) ndërsa përpara Gjyqtarit Hetues dhe gjatë gjykimin kryesor atij i është kujtuar P [redacted] si i pranishëm në dhomën e tij vetëm gjatë periudhës së dytë të burgimit të tij.

Në gjykimin kryesor "A" ka ekzaminuar me vështirësi për shkak të shikimit të tij të dobët një renditje fotografish të viktimave duke identifikuar B [redacted] B [redacted], A [redacted] B [redacted] dhe H [redacted] P [redacted].

Ai gjithashtu ka identifikuar maicën që kishte të veshur B [redacted] B [redacted] e cila është sjellur në shtëpi nga dëshmitari "B".

Kjo gjykatë vlerëson dëshmitë e "A" si plotësisht të besueshme përsa i përket pjesës që i referohen ekzistencës së një qendre për paraburgim në Drenovc, periudhave të mbajtjes së tij atje në paraburgim, në lidhje se me kë është takuar atje, në veçanti B [redacted] B [redacted] dhe H [redacted] P [redacted] të cilët i ka njohur që përpara si dhe në lidhje me plagët që kanë pësuar në atë kohë ai dhe të burgosurit e tjerë.

Ai ka shkuar në Drenovc për të shpëtuar B [redacted] B [redacted], ka mundur të takojë atë (dhe ka njohur edhe këmbishën e tij) dhe pjesa tjetër nuk ka qenë qëllimi kryesor i rrugëtimit dhe vëmendjes së tij.

“A” është gjithashtu i besueshëm në lidhje me faktin se në qendrën për paraburgim ai ka takuar S [REDACTED] S [REDACTED] dhe H [REDACTED] K [REDACTED] sepse këta dy persona mbaheshin në paraburgim në Drenovc siç është përmendur nga burime të tjera dhe sepse përshkrimi i tyre i dhënë nga ky dëshmitar përputhet me atë të dy personave të zhdukur.

Fakti se “A” ka mësuar emrat e këtyre dy personave në një mënyrë të veçantë nuk duhet të duket i çuditshëm duke pasur parasysh kushtet e vështira në të cilat ai i ka takuar ata: në burg, të rrahur në mënyrë të përsëritur dhe të kërcënuar me vdekje.

Është gjithashtu i besueshëm fakti se “A” ka dëgjuar emrat e C [REDACTED], R [REDACTED] dhe I [REDACTED] kjo vërtetohet nga prova të tjera se këta persona në atë kohë gjendeshin në Drenovc.

Në veçanti “A” ka identifikuar fotografinë e S [REDACTED] K [REDACTED], si atë të një personi të parë në qendrën për paraburgim.

Të gjitha këto të lartpërmendura përbëjnë pjesën thelbësore të dëshmisë së “A” dhe janë të besueshme.

Mospërputhjet në dëshmitë e tij nuk kufizojnë besueshmërinë e dëshmitarit për pikat e lartpërmendura sepse ato i referohen elementeve të ndryshëm dhe në një mënyrë “margjinale” (si prania e H [REDACTED] T [REDACTED] apo detajeve të cilët në pamje të parë nuk mund të vlerësohen si të së njëjtës rëndësi më pjesën tjetër (pesë gratë të papërmendura përpara Policisë ku “A” ka treguar historinë e B [REDACTED] B [REDACTED] i arrestuar nga UCK-ja) apo me një konfuzion në kujtesën e dëshmitarit ndoshta për shkak të moshës së tij dhe rrethanave të kohës së luftës (prania e H [REDACTED] P [REDACTED] gjatë periudhës së parë siç ka thënë Policisë “A” apo emri i fshatit ku ai ka mësuar emrin e S [REDACTED] K [REDACTED])).

Mospërputhjet e lidhura me përshkrimin fizik të të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] duket të jenë më të rëndësishme.

Megjithatë, duhet të vërehet se edhe në lidhje me mospërputhje të tilla dëshmitari mund të ketë bërë gabime por dhe edhe pse me shikim të dobët ai ka mundur të identifikojë në fotografi të pandehurin dy herë.

Duhet të konkludohet se në fakt “A” ka parë të pandehurin në Drenovc përndryshe ai nuk do të kishte njohur fotografitë e tij.

Duhet të shtohet se “A” nuk ka identifikuar të pandehurin si njëri prej të treve që e kishin rrahur atë, por vetëm si një oficer me gradë të lartë në Shtabin e UCK-së, i parë nga qelia e burgut.

Dhe ky rol si oficer në Shtabin e UCK-së i cili është parë në lokalet e qendrës për paraburgim vërtetohet edhe nga burime të tjera si, deklaratat e vetë të pandehurit.

Gjykata vlerëson dëshminë e “A” si një provë e vërtetimit në lidhje me elementet e lartpërmendur.

Edhe pse kjo provë nuk mund të përdoret për të vërtetuar se S [REDACTED] K [REDACTED] ka rrahur personalisht “A” ajo mund të përdoret së bashku me prova të tjera për të provuar se i pandehuri ishte njëri nga personat përgjegjës për burgun dhe të burgosurit.

13. M [REDACTED] R [REDACTED] dhe H [REDACTED] T [REDACTED]

Dy pikat e ankesës duhet të trajtohen së bashku, duke qenë pjesë e përbashkët e arsyesimit të tij.

Përsa i përket M [REDACTED] R [REDACTED] ankesa pretendon se asnjë nga dëshmitarët nuk ka raportuar fakte mbi S [REDACTED] K [REDACTED] por vetëm mbi B [REDACTED] Y [REDACTED] përfshirja e të cilit duket të jetë për arsye të një grindje personale me familjen e personit të zhdukur.

Përsa i përket H. T. ankesa pohon se dëshmitari Z. T. nuk ka shkuar kurrë në Drenovc për të kontrolluar nëse viktima gjendej atje, së dyti se dëshmitari "O" ka folur në lidhje me H. T. si i burgosur në Malishevë dhe jo në Drenovc me datë 21 apo 22 korrik 1998.

Në të dy rastet grindjet personale (mes familjes R. dhe B. Z. dhe mes familjes T. dhe të akuzuarit të mëparshëm X. E.) do të ishin bazë për akuzat.

Përsa i përket M. R. Gjykata e Shkallës së Parë përdor provat e N. E. dhe H. R. si dhe të dëshmitarit anonim "X" për të provuar ekzistencën e qendrës për paraburgim në Drenovc, rrëmbimin e M. R. kushtet dhe rrahjen që ai ka pësuar gjatë burgimit dhe përfshirjen direkte të të pandehurve B. Z. dhe A. K. (duhet të kihet parasysh se kundër A. K. Gjykata nuk ka përdorur deklaratat e dëshmitarit "X").

Përsa i përket H. T. gjyqtari i parë përdor dëshminë e Z. T. mbi rrethant e rrëmbimit të viktimit dhe përdor dëshminë e dëshmitarit "X" mbi faktin se viktima është mbajtur në paraburgim në Drenovc dhe se është rrahur gjatë mbajtjes në paraburgim.

Në faqen 89 të aktgjykimit të kundërshtuar lexohet se "gjatë hetimit nuk janë paraqitur prova që implikojnë në mënyrë direkte të akuzuarin (S. K. në rrëmbimin, mbajtjen në paraburgim dhe keqtrajtimin e M. R. apo H. T. të cilët ishin arrestuar dhe mbajtur në paraburgim përkatësisht me datë 10 qershor 1998 dhe 2 korrik 1998. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se këta të dy të burgosur janë dërguar në Dranovc/Drenovac në një kohë kur i akuzuari dihej se merrte pjesë në paraburgime të tjera dhe rrahje të lidhura me këto, trupi gjykues ka gjetur se është arsyeshme të konkludohet se këta të dy të paraburgosur gjithashtu mbaheshin në paraburgim si pjesë e një veprimtarie kriminale të përbashkët të gjerë pjesë e së cilës ishte në mënyrë të qartë S. K.

Kjo Gjykatë gjen këtë arsyetim korrekt në teori meqenëse është vertetuar se a) dy viktimat janë mbajtur në paraburgim në Drenovc në periudhën kritike dhe se b) i pandehuri S. K. ishte njëri nga personat përgjegjës për menaxhimin e kësaj Qendre për Paraburgim si anëtarë i një veprimtarie të përbashkët kriminale.

Përsa i përket pikës së parë duhet të vërehet se rrëmbimi i M. R. nga ushtarë të UCK-së dhe se viktima është mbajtur i burgosur në shkollën e vjetër të Drenovcit në periudhën kritike është deklaruar në mënyrë bindëse nga dëshmitarët N. E. dhe H. R. të cilët kanë shkuar disa herë atje dhe kanë njohur ndërtesën në fotografi.

Gjithashtu N. R. në një rast ka dëgjuar dikë që bërtiste në burg.

R. i H. T. është deklaruar nga vëllai i tij Z. dëshmitari është informuar nga rrëmbyesit që të shkojë të nesërmen në Drenovc me qëllim që të marrë H. nipi i tij i ka konfirmuar se H. gjendej në Drenovc.

Dëshmitari "X" është mbajtur në paraburgim në Drenovc dhe atje ka takuar M. dhe H. T.

"X" nuk ka ditur të japë përpara dy viktimave një përshkrim fizik të H [REDACTED] gjë që nuk është kundërshtuar, dhe të thotë se ai ishte nga fshati Pirane që ishte e saktë, ai ka mundur të njohë fotografinë e M [REDACTED] R [REDACTED] dhe të thotë saktë se ai ishte nga Drenovci, Sipas "X" të tre ishin rrahur.

Në deklaratën e tij anonime "O" përmend H [REDACTED] si një i paraburgosur që ai ka takur në qendrën për paraburgim në Malishevë, në ditë pas 20 apo 21 qershorit 1998: H [REDACTED] ka treguar se është mbajtur në paraburgim dhe se është rrahur në Drenovc, "O" mund të shihte shenjat e të rrahurit.

"O" nuk e dinte mbiemrin e H [REDACTED] por ka dhënë një përshkrim fizik të tij dhe e ka njohur atë në fotografinë e H [REDACTED] T [REDACTED]

"O" ka shtuar se ka mësuar nga H [REDACTED] se ky i fundit kishte qenë arrestuar nga një person të cilin vetë H [REDACTED] kishte plagosur disa vite më parë, arrestimi ka ndodhur ndërsa H [REDACTED] po shkonte të merrte një nuse.

Z [REDACTED] T [REDACTED] i kishte dhënë Gjykatës të njëjtin spjegim.

"O" ka njohur edhe fotografinë e M [REDACTED] R [REDACTED] duke shtuar se të paraburgosurit që ai kishte takuar në Malishevë kishin thënë se M [REDACTED] kishte vdekur si pasojë e rrahjes. Të gjithë këto elemente konfirmojnë vendimin e gjyqtarit të parë në lidhje me paraburgimin e M [REDACTED] R [REDACTED] dhe H [REDACTED] T [REDACTED] në Drenovc dhe për plagët që ata kanë pësuar në atë rast.

Përsa i përket pikës së dytë, siç është vërejtur më lart (ballafaqim pjesa I.3), një person mund të mbahet si i përgjegjshëm për vepër penale të bashkëpunimit në rastet kur a) ai merr pjesë në mënyrë direkte së bashku me persona të tjerë në kryerjen e një veprë penale, b) merr pjesë në mënyrë të vullnetshme në një sistem shtypje apo keqtrajtimi që rezulton në vepra penale apo c) vepra penale është një pasojë "e natyrshme dhe e parashikueshme" e një plani të përbashkët.

Përsa i përket përfshirjes së S [REDACTED] K [REDACTED] kjo Gjykatë vëren se i pandehuri merr pjesë në arrestime të paligjshme të personave (ballafaqim provash në lidhje me S [REDACTED] S [REDACTED] dhe H [REDACTED] P [REDACTED]), në menaxhimin e qendrës për paraburgim (prova në lidhje me H [REDACTED] K [REDACTED] ishte i konsideruar Zëvendës Komandant i Policisë në burg (dëshmitari TT, Z) apo "njeriu përgjegjës i policisë ushtarake" (dëshmitari M [REDACTED] B [REDACTED] për të cilin thuhet më shumë më poshtë) i cili ka bërë të mundur që dëshmitarët të vizitojnë të burgosurit (dëshmitari N dhe Z) dhe i cili negocion kushtet e lirimit të H [REDACTED] P [REDACTED] (dëshmitari Z).

Kështu përgjegjësia e të pandehurit për arrestimet e paligjshme dhe mbajtjen në paraburgim në kushte çnjerëzore të M [REDACTED] R [REDACTED] dhe H [REDACTED] T [REDACTED] mbështetet në pjesëmarrjen e tij të vullnetshme në atë veprimtari të përbashkët kriminale që konsiston në një sistem represioni apo keqtrajtimi të personave të burgosur në Drenovc, duke rezultuar në vepër penale.

Natyra e veprës penale është ajo krimi i luftës edhe pse në lidhje me M [REDACTED] R [REDACTED] vetëm, dëshmitarët kanë përmendur një grindje që ka zgjatur shumë mes familjes së tij dhe atë të B [REDACTED] Z [REDACTED]

Kjo çështje është trajtuar bindshëm nga gjyqtari i parë¹⁵ dhe do të ekzaminohet më hollësisht në pjesën që lidhet me dëshmitarin "U", për të cilin ka ekzistuar i njëjti problem (shih pikën II.17).

¹⁵ Shih faqet 53-56 të aktgjykimit.

14. A B

Ankesa nënvizon faktin se në këtë lëndë burimet e informacionit (djali i viktimës, M K) kishte takur S K në gjysmën e dytë të gushtit 1998 dhe kishte marrë nga ai përgjigjen se aty nuk kishte të burgosur. Kjo do të konfirmonte faktin se pas datës 17 korrik në Drenovc nuk mbaheshin të burgosur dhe se i pandehuri i cili kishte qenë në Shqipëri deri në mesin e gushtit nuk kishte të bëjë fare me viktimën.

Gjykata e Shkallës e Parë nënvizon dëshminë e M B për përfshirjen e S K dëshmitari ishte në kërkim të babait të tij në fillim të gushtit dhe është drejtuar nga B Z tek S K C (të cilin dëshmitari e ka njohur në fotografi) si personi kryesor përgjegjës i policisë.

S K i ka thënë dëshmitarit se babai i tij ishte zhvendosur në Drenicë dhe nuk kishte qenë e mundur të kthehej për shkak të kushteve të rrugës.

Kjo gjykatë gjen se provat në dosjen e lëndës konfirmojnë vlerësimin e gjyqtarit të parë. M B është kthyer nga Zvicra në fund të korrikut apo në fillim të gushtit 1998 dhe është bashkangjitur UCK-së në kufirin mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Ai donte të mbrontë shtëpinë dhe atdheun e tij.

Sapo ka mbërritur në shtëpi ai ishte informuar nga vëllezërit e tij se babai i tyre, A ishte rrëmbyer me datë 13 korrik nga shtatë ushtarë të UCK-së.

Kjo ka qenë plotësisht e papranueshme për të, sepse familja e tij kishte mbështetur UCK-në.

Ai është informuar se babai i tij ishte dërguar në Drenovc.

Kështu disa ditë më vonë dëshmitari dhe njëri prej vëllezërve të tij janë nisur për në Drenovc ku ata kanë kërkuar të takonin një udhëheqës të UCK-së dhe janë dërguar tek B Z i cili njihej si "komisar politik", një "zyrtar i lartë".

Ky i fundit ka dëgjuar kërkesën e tyre për tu njofuar në lidhje me arsyet e arrestimit dhe fatin të A dhe është përgjigjur duke drejtuar dy të rinjtë për në shkollën/burg dhe të flasin me C S K i cili ishte përgjegjës i policisë ushtarake.

Dëshmitari ka mësuar nga një ushtar, I B roje burgu, se babai i tij ishte mbajtur në atë burg dhe se ajo rojë kishte sjellë atij ujë dhe ushqim.

Në momentin e mbërritjes së S K ai ushtar nuk kishte guxuar të fliste më.

Dëshmitari ka pyetur të pandehurin për fatin e babait të tij dhe përgjigja ka qenë: "Këtu në Drenovc nuk është askush, ata janë diku në Drenicë. Ne nuk mund ti sjellim këtu për shkak të kushteve shumë të këqija të rrugës. Kjo është arsyeja për të cilën ata gjenden në Drenicë". Pyetjeve të tjera të dëshmitarit i pandehuri i është përgjigjur duke i ftuar të vinin të Drenovc në fund të javës me qëllim që "të qartësohet diçka".

Dëshmitari nuk ka mundur të kthehet në Drenovc për shkak të ofensivës serbe.

Dëshmitari ka deklaruar gjithashtu se vëllai i tij S ishte ushtar i UCK-së i cili ishte vrarë gjatë një beteje kundër serbëve.

Edhe pse ai ishte anëtarë i UCK-së, në korrik të vitit 1998, S B ishte mbajtur i burgosur për disa ditë nga UCK-ja në Shtabin e Ratkovecit sepse ekzistonte një letër që përshkruante familjen e tij si bashkëpunëtorë të Serbëve.

Arsyeja duket të jetë sepse familja B kishte blerë tokë nga Serbët.

Nga dëshmia e M [REDACTED] B [REDACTED] rezulton se S [REDACTED] K [REDACTED] ishte në pozitë, personi kryesor i policisë, që i jepte mundësi të dinte për të burgosurit në burg. Dëshmitari ka takuar S [REDACTED] K [REDACTED] në gusht, që do të thotë pas vdekjes së G [REDACTED] P [REDACTED] (që ka ndodhur në mes të Korrikut), kjo konfirmon deklaratat e dëshmitarit anonim "Z" mbi rolin që i pandehuri kishte pas atij fakti.

Gjithashtu, objekti i komunikimit që ai ka marrë nga i Pandehuri konfirmon hipotezën se S [REDACTED] K [REDACTED] ishte përgjegjës për të burgosurit sepse ai dinte vendndodhjen e tyre, nevojën për ti kthyer ata në Drenovc, vështirësitë e kushteve rrugore ("Nuk mund ti sjellim ata këtu").

Është e qartë se levizjet e të burgosurve ishin detyrë e tij si personi kryesor përgjegjës i policisë.

M [REDACTED] B [REDACTED] ishte ushtar i UCK-së, vëllai i tij S [REDACTED] gjithashtu dhe ishte vrarë gjatë luftimeve kundër serbëve, ai ishte një familje dëshmorësh, këto elemente kanë bërë që Gjykata të përjashtojë çdo hipotezë komploti kundër të pandehurit si anëtarë i UCK-së.

Duhet të shtohet se M [REDACTED] B [REDACTED] nuk deklarohet në lidhje me ndonjë rrugëtim të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] në Shqipëri.

15. Dëshmitari anonim "X".

Ankesa pretendon se "X" ka pohuar fuqimisht se arrestimi dhe burgimi i tij në Drenovc ka ndodhur në shtator 1998, jashtë periudhës kohore për cilën ngrihen akuzat. Ai ka qëndruar atje një muaj, ka takuar M [REDACTED] R [REDACTED] dhe H [REDACTED] T [REDACTED] i është dhënë ushqim në mënyrë të rregullt, nuk është rrahur, nuk ka takuar kurrë S [REDACTED] K [REDACTED]

Gjykata e Shkallës së Parë bazon vendimin e saj në dëshminë e "X" në lidhje me paraburgimin e përkohshëm të këtij të fundit, të M [REDACTED] R [REDACTED] dhe të H [REDACTED] T [REDACTED] dhe në lidhje me rrahjet që ata kanë pësuar në Drenovc. Gjyqtari i Parë vlerëson se kundërshtimi i këtij dëshmitari në lidhje me rrahjet është mungesë kujtese për shkak të kohës.

Kjo gjykatë është e mendimit se kundërshtimi në lidhje me muajin kur "X" mbahej në paraburgim në Drenovc spejgohet si gabim në kujtesën e tij.

Përpara Gjyqtarit Hetues "X" ka folur për pranverë ndërsa në gjykimin kryesor ai ka përmendur shtatorin.

Fakti se "X" ka takuar M [REDACTED] dhe H [REDACTED] është konfirmuar nga fakti se, edhe pse ai nuk ka njohur më parë këta dy njerëz, ai ka qenë në gjendje të përshkruajë ata në mënyrë të sakte dhe të identifikojë në fotografi të paktën M [REDACTED] R [REDACTED].

Është konfirmuar se ishte pranverë dhe jo shtator nga deklaratat e "X" si dhe ato të "O" i cili në ditët pas 20 dhe 21 korrik 1998 në burgun e Malishevës mes të burgosurve të tjerë ka takuar H [REDACTED] T [REDACTED] i cili vinte nga Drenovci.

Çështja e rrahjes nuk mund të konsiderohet si kundërshtim i vërtetë dhe mund të gjejë spjegime të tjera përveç mungesës apo zhdukjes nga kujtesa.

Në fakt në gjykimin kryesor pas kësaj pyetje ai mohoi se është rrahur duke thënë se të burgosur të tjerë që gjendeshin në dhoma të tjera ishin rrahur.

Vetëm pas ballafaqimit me atë që ai kishte thënë përpara Gjyqtarit Hetues (se edhe ai ishte rrahur dy herë në ditë me një shkop druri dhe se kishte parë M. [redacted] dhe H. [redacted] të rriheshin) ai ka pranuar se kishte harruar shumë gjëra, ka konfirmuar se është rrahur dhe se kishte dëgjuar në një dhomë tjetër M. [redacted] dhe H. [redacted] që ishin rrahur. Gjithashtu në lidhje me identitetin e personave që e kanë rrahur "X" ka shfaqur disa probleme kujtese: në fillim ka folur për Isufin i cili ka vdekur më vonë, pastaj ka shtuar Z. [redacted] B. [redacted] të cilin ai nuk ka mundur të përshkruajë pa ballafaqimin me deklaratat e tij të mëparshme.

Ai ka spejguar se është rrahur "sa herë që kanë dashur ata" "ndoshta një herë në javë". Ai është kujtuar se është dërguar në shkollë në Drenovc për tu pyetur nëse ai ishte bashkëpunor i serbëve dhe ka konfirmuar se i është nënshtruar një trajtimi të veçantë "diçka si goditje me rrymë elektrike" e shkaktuar nga një mjet i bardhë i vendosur në fytin e tij "dhe gjithë trupi dridhej". Përsa i përket ushqimit të marrë, përpara Gjyqtarit Hetues "X" ka thënë se është ushqyer vetëm pas dy ditësh dhe më vonë "ata na kanë ushqyer me çdo gjë që kanë pasur vetë ata", në gjykimin kryesor ai deklaroi "ushqimi ishte shumë i mirë".

Kështu versioni i dhënë nga "X" në gjykimin kryesor është reduktues në krahasim me deklaratat e tij të mëparshme, megjithatë ai ka konfirmuar se është rrahur dhe se M. [redacted] dhe H. [redacted] kanë pësuar të njëjtin trajtim.

Ai ka ulur dhënë një numër më të vogël të herëve që është rrahur, ka përmendur si autorë një person i cili ka vdekur dhe një tjetër që nuk është i përfshirë në këtë procedurë, ka aritur në pikën e pabesueshme të përpjekjes për të përshkruar kushtet e paraburgimit si pothuajse normale sepse ushqimi ishte "shumë i mirë".

Kjo përpjekje për të zvogëluar numrin dhe masën e fakteve nuk bind për të njëjtat arsye si ato të dhëna në rastin e dëshmitareve "N" dhe "TT" (shih më sipër II.10): deklaratat e dhëna përpara Gjyqtarit Hetues janë marrë në prani të Prokurorit dhe Avokatëve Mbrojtës, ati ishin të qarta, të detajuara dhe logjike, ato konfirmohen në deklaratat e "O" i cili, duke folur për H. [redacted] T. [redacted] dhe të tjerë është kujtuar se ata kanë treguar se janë rrahur në Drenovc.

Më shumë sesa mungesë apo zhdukje nga kujtesa, spjegimi duket të jetë kushtet e vështira, nëse nuk është frika e vërtetë e dëshmitarit, i cili ishte anonim saktësisht për arsye sigurie.

Kjo Gjykatë vlerëson të besueshëm faktin se "X" është mbajtur në paraburgim në Drenovc në periudhën kritike së bashku me M. [redacted] R. [redacted] dhe H. [redacted] T. [redacted] dhe se të tre janë rrahur ngjashmërisht.

Përsa i përket përfshirjes së S. [redacted] K. [redacted] në këtë paraburgim duket të kujtohen vlerësimet e zhvilluara në pikat e mëparshme II.13 në lidhje me pjesëmarrjen në veprimtarinë kriminale të përbashkët lidhur me menaxhimin e qendrës së paraburgimit në Drenovc në periudhën kohore në shqyrtim.

16. Dëshmitari anonim "E"

Ankesa pretendon të kundërtën e deklaratave të këtij dëshmitari në lidhje me kohën kur ai është arrestuar, kohëzgjatjen e paraburgimit, faktin se ai fillimisht ka thënë se është

arrestuar nga S. K. dhe G. P. personalisht, se është rrahur nga S. K. dhe se është rrahur nga dy persona të maskuar.

Ankesa vëren se Prokurori nuk ka besuar këtë dëshmitar në lidhje me deklaratat e tij lidhur me I. G. dhe X. E kundër të cilëve janë hedhur akuzat.

Gjykata e Shkallës së Parë përdor dëshminë e "E" për ekzistencën e Qendrës për Paraburgim në Drenovc, për përfshirjen e B. Z. i cili e ka marrë atë në pyetje duke e akuzuar për spiunazh në dobi të serbëve (faqja 55), për praninë e H. P. M. R. dhe H. K. (nga Denje, faqet 68 dhe 69) dhe për përfshirjen e S. K. (faqja 86).

Dëshmitari është ekzaminuar tre herë në gjykimin kryesor (15 dhe 22 mars dhe 10maj 2006) dhe Gjykata e Shkallës së Parë spjeron kundërshtimet e gjetura në deklaratat e tij me kalimin e kohës, mungesa e kujtesës dhe fakti që nuk din shkrim dhe lexim, duke shtuar se ka vlerësuar pozitivisht spjegimet e dhëna nga dëshmitari sit ë ndershme mbi atë që ai "kishte parë në të vërtetë".

Kjo Gjykatë vlerëson dëshminë e këtij personi i cili përshkruan veten si bari 47 vjeçar dhe i pashkollë, i besueshëm dhe logjik, coherent dhe gjen konfirmim të jashtëm.

Sigurisht niveli kulturor i këtij personi, paaftësia për të lexuar deklaratat e tij me qëllim që të bëjë korrigjime eventuale, koha që ka kaluar, plagët e pësuar gjatë periudhës kritike (objekt i disa dokumenteve fotografike¹⁶), vështirësitë e lidhura me cilësinë e tij prej dëshmitari anonim (dhe i mbrojtur), që do të thotë frika për tu "likuiduar" ("janë vrarë shumë njerëz" siç është cituar edhe nga Gjyqtari) kuan një rol të rëndësishëm në spjegimin e këtyre kundërshtimeve, si dhe mënyra me të cilën ai është përpjekur të sqarojë se nuk është në gjendje të flasë për njerëz që ai nuk ka njohur, mënyrë të cilën gjyqtari i Parë e ka vlerësuar si të ndershme.

Në këtë rast nuk ka shenja dëshmie të rremë apo shpifje kundër të pandehurve: "E" nuk ka të bëjë fare me apo kundër B. Z. dhe S. K. dhe deklaroi me sinqeritet atë që ka parë, ka dëgjuar apo ka besuar se ka kuptuar, siç qartësohet më vonë.

Deklaratat e "E" duket të jenë logjike dhe koherente në lidhje me faktin se ai është mbajtur në paraburgim ne Drenovc, sepse ka dhënë një përshkrim të barakave prej druri ku ai ka qenë në fillim dhe të shkollës ku ai është mbajtur për tre ditë dhe ka identifikuar shkollën në fotografi.

Gjithashtu kushtet e paraburgimit dhe fakti se ai është rrahur janë të deklaruara në mënyrë bindëse: atij nuk i dhënë asgjë për të ngrënë dhe për të pirë, ka fjetur në dysheme në një dhomë ku mbahej qymyri, nuk kishte paisje tualeti dhe bënte nevojat personale në të njëjtën dhomë ku flinte, nuk i lejohej të pastronte gjakun e tij.

Deklaratat e dëshmitarëve të ekzaminuar në kapitujt e mëparshëm përmbajnë konfirmim të gjendjes së vështirë, ushqimit dhe kushteve higjienike.

Fakti se "E" është rrahur gjatë mbajtjes në paraburgim konfirmohet nga fotografitë që ai ka paraqitur në Gjykatë dhe në lidhje më plagët e tij në shpinë dhe në kokë: në dy fotografitë mund të shihen shenja dhe vraga.

"E" duket i besueshëm kur deklaroi se është ekzaminuar nga B. Z. ai jep një përshkrim fizik Z. i cili përputhet me paraqitjen e jashtme të të pandehurit; "E" përshkruan rrobat e Z. (rroba të qarta) në të njëjtën mënyrë si dëshmitarët e tjerë;

¹⁶ Fotografitë e pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë me vendimin e datës 22 qershor 2006. Shih Dosjen Konfidenciale nr 4, pika I faqet 4009 dhe 4010.

“E” njeh fotografinë e Z [REDACTED] duke shtuar se i pandehuri ishte anëtar i UCK-së dhe ky detaj është konfirmuar nga dëshmitarë të tjerë dhe është pranuar nga vetë dëshmitari ashtu siç është parë në pjesë të tjera të këtij gjykimi.

Dëshmitari është i besueshëm edhe kur thotë se në Drenovc mbaheshin disa të paraburgosur: kjo rezulton edhe nga burime të tjera.

“E” deklaroi se ka ditur për rrëmbimin e Hysenit nga Denjë.

Kur ai ka arritur në Drenovc “E” ka dëgjuar emrat e të burgosurve të tjerë, mes të cilëve H [REDACTED] P [REDACTED] por ka sqaruar se nuk ka takuar këta persona në burg.

Prania e H [REDACTED] P [REDACTED] dhe H [REDACTED] K [REDACTED] në Drenovc konfirmohet nga burime të tjera.

Lidhur me kohën e arrestimit “E” i kishte thënë policisë se ajo ishte mesi i qershorit 1998, para se Gjykatesi Jetues të verifikonte këtë datë, mirepo me vone ka folë lidhur me 17 majin duke shpjeguar se ishte analfabet dhe se nuk e dinte, mirepo ajo ishte para se të fillonte bombardimi nga ana e NATO-s.

Ne gjykimin kryesor dëshmitari kishte folur rreth vitit 1999, por pastaj konfirmoi me 9 qershor 1998 duke shtuar se nuk ishte në gjendje të thoshte datën e sakte.

Ne pyetjen e mbrojtësve “E” përmendi pranverën si kohën e arrestimit të tij në Drenovc.

Lidhur me këtë pikë kontradiktat duken të jenë të nderlidhura me kulturën modeste dhe problemet e memoiries.

Ne deklaratën e pare dhënë policisë, me e aferta ndaj fakteve, duket të jetë edhe me e besueshmja.

Sa i përket kohezgjatjes së ndalimit të tij “E”-ja i ka deklaruar policisë se ka qenë i ndaluar tri ditë në Drenovc, të njëjten ia tha Gjykatesit Hetues gjatë gjyqimit kryesor.

Ne pikat tjera dëshmia e “E”-se rezulton se është e sinqertë mirepo nuk është në gjendje të vertetojë ato që e thotë.

Kjo ka të bëjë me pikën e rrëmbimit dhe rrahjes nga ana e S [REDACTED] K [REDACTED] dhe G [REDACTED] P [REDACTED] C [REDACTED] dhe R [REDACTED].

“E”-ja deklaroi se nuk i kishte njohur këta dy persona më heret dhe se i kishte ndëgjuar nofkat e tyre që përmendeshin nga popullata.

Vecanerisht, ai kishte ndëgjuar se R [REDACTED] ishte vrarë dhe me atë rast ai kuptoi se ai paska qenë G [REDACTED] P [REDACTED], ndërsa nga njëzërit kishte ndëgjuar se “C [REDACTED] e kishte bërë atë C [REDACTED] e kishte bërë këtë” dhe vetëm pas luftës mesoi se C [REDACTED] ishte S [REDACTED] K [REDACTED].

Dëshmitari lene pershtypjen se është i sinqertë pasi që ai deklaroi se si i kishte rekonstruktuar identitetet e personave me të cilët ishte takuar dhe nga ana tjetër nuk ka asnjë dyshim se P [REDACTED] dhe S [REDACTED] K [REDACTED] të dytë ishin në Drenovc në atë kohë.

Mirepo, kjo Gjykatë konsideron se nuk është e mjaftueshme të bëhet verifikimi me siguri të mjaftueshme se në momentin e rrëmbimit C [REDACTED] ka qenë i pranishëm dhe e ka rrahur “E”-në meqenëse ky i fundit nuk ishte në gjendje të identifikonte të pandehurin në baze të fotografisë.

Në këtë rast, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e S [REDACTED] K [REDACTED] në arrestimin e “E”-se ka gjasa të ketë qenë gabim, jo e memories por të proqesit të identifikimit të ndjekur nga ana e dëshmitarit.

Mosperputhjet tjera në dëshmitë e “E”-se (vecanerisht fakti se Prokurori e ka terheqë akuzën kundër I [REDACTED] G [REDACTED] përshkak të një mosperputhjeje në dëshminë e tij) nuk

duken te ken nje ndikim vendimtar ne kredibilitetin e tij lidhur me pikat e permendura me larte.

Nga akti i terhjekjes nga ndjekja e 27 korrikut 2006 rezulton se "E"-ja ne ate moment ishte prove unike kunder te akuzuarit dhe ajo prove tregoi se ishte kontradiktore kur deklaroi para policise dhe Gjykatesit hetues gjate marrjes ne pyetje se ishte B. Z. qe e kishte kercenuar "E"-ne me arme, derisa I. G. e kishte nxite te parin qe te shtinte me arme, kurse ne gjykimin kryesor deklaroi se arma ishte ne posedim te I. G.

Kjo Gjykate nuk mundet te diskutoje aktin e terhjekjes nga ndjekja, por vetem konstaton se pikat tjera te paraqitura ketu me larte duken te jen te konfirmuara nga elementet tjera dhe keshtu qe jane te besueshme.

Sa i perkete pergjegjesise se S. K. ne ndalimin e deshmitarit "E" duhet te kujtohen konsideratat e zhvilluara ne piken e meparme II.13 lidhur me pjesemarrjen e tij ne veprimin e perbashket kriminal te lidhur me menaxhmin e qendres se ndalimit ne Drenovc gjate periudhes nen shqyrtim.

17. Deshmitari anonim "U".

Apelimi se pari pohon se deshmitet e ketij deshmitari jane ne kundershtrim lidhur me daten e arrestimit te tij (qershor ose 12 apo 16 korrik), fakt qe do te duhej te tregonte manipulimin e deshmitarit dhe se dyti nenvizon pabesueshmerine e e arsyeve te pohuara nga ana e "U" lidhur me arrestimin e tij (konflikt privat me anetaret e familjes Z. te cilat jane mohuar nga ana e deshmitarit te mbrojtes H. Z.

Gjykatesi i Instances se Pare i jap rendesi deshmise se deshmitarit "U" lidhur me rrembimin e tij nga ana e UCK-se (a. K. dhe z. B. si dhe lidhur me marrjen ne pyetje nga ana e S. K. si dhe lidhur me rrahjen e tij te urdheruar kunder viktimes nga ky i pandehur i fundit.

Arsyeja e arrestimit te tij te paligjeshem ishte nje konflikt privat ne mes te deshmitarit dhe te nje ushtari te UCK-se.

Gjykatesi i pare spjegoi dy mosperputhje ne deshmitet e "U"-se (lidhur me daten e arrestimit te tij dhe me kohezgatjen e marrjes se tij ne pyetje) si gabime te thjeshta dhe te "verteta" te cilat ishin korrigjuar ne menyre te "sinqert", pra duke mos pasur ndikim ne deshmine e tij.

Kjo Gjykate pajtohet me mendimin e gjykatesit te pare, meqe arsyet e perdorura ne apelim nuk duken te jene vendimtare.

"U"-ja kishte statusin e deshmitarit anonim dhe ka mbete si deshmitar i llojit te tillle.

Ne kete rast, nje pike e deshmise ishte lidhur me shitjen e nje patundshmerie nga ana e deshmitarit personave tjere dhe mbrojta qe ne gjendje qe te sillte njerin nga bleresit ne cilesine e deshmitarit.

Keshtu, pavaresisht nga anonimiteti i ketij deshmitari te pandehurit ishin ne gjendje te mbronin veten.

Tri deshmi te "U"-se jane ketu interesante: njera para Gjykatesit Hetues kurse dy tjera ne gjykimin kryesor.

"U" kishte deklaruar para Gjykatesit Hetues me (6 gusht 2004) se vellazereve Q. H. dhe R. Z. qe kishte shitur nje patundshmeri, shumta e cmimit nuk ishte paguar teresisht ne ai ai ne kete moment ende priste qe t'i pagueshin edhe 2525 DM.

"U"-ja ishte arrestuar dy here ne vitin 1998: hera e pare ishte ne korrik kurse hera e dyte ishte gjate periudhes kohore ne mes te 10 dhe 16 dhjetorit, kjo kishte ndodhe per shkak te borxhit te tij.

Ai se pari foli per arrestimin qe ishte bere ne dhjetor kur tre burra te maskuar e kishin rrembyer nga shtepia e tij ne Drenovc dhe e kishin sjelle ne bodrumin e shkolles.

Te tre burrat ishin te maskuar, por para prinderve te "U"-se qe qanin ata i kishin hjekur maskat.

Ata ishin N [REDACTED] Z [REDACTED] Q [REDACTED] Z [REDACTED] dhe I [REDACTED] B [REDACTED]

Gjate rruges ne shkolle tre burrat e pyeten "U"-ne se pse ai kerkonte te holla nga Q [REDACTED] dhe Nesemi dhe i thane: do te shohish se sa para do te te japim.

Q [REDACTED] e kercenoi "U"-ne me vrasje.

"U"-ja nuk ishte marre ne pyetje gjate ndalimit ne dhjetor 1998.

Marrja ne pyetje ka ndodhe ne korrik te vitit 1998 kur deshmitari ishte arrestuar per shkak te ceshtjes se njejte.

"U"-ja lidhur me arrestimin e tij ka deklaruar se ishte marre nga ana e A [REDACTED] K [REDACTED] dhe Z [REDACTED] K [REDACTED] nga Polluzha dhe eshte sjelle ne shtabin e policise ushtarake ku S [REDACTED] K [REDACTED] e kishte marre ne pyetje per nja kater ore.

S [REDACTED] K [REDACTED] e kishte pyet "U"-ne se pse kerkonte te hollat nga Q [REDACTED] dhe vellazerit e tij H [REDACTED] dhe R [REDACTED]

"U"-ja u pergjegje duke thene se kishte ca borxhe dhe per t'i paguar ato borxhe ketyre djemeve ua kishte shitur nje patundshmeri te cilet ende nuk e kishin paguar shumen e plote.

S [REDACTED] K [REDACTED] i urdheroi A [REDACTED] dhe Z [REDACTED] qe ta sillnin "U"-ne ne nje dhome tjetër, ku ishte rrahur nga A [REDACTED] me nje shkop kurse nga ana e Z [REDACTED] me nje pjese te celikut.

Rrahja zgjati perafersisht 15 minuta deri sa "U"-ja e humbi vetedijen.

Ate perseri e sollen para s [REDACTED] K [REDACTED] i8 cili e pyeti:"a guxon me me i kerkue te hollat nga Qerimi dhe vellazerit e tij?". "U"-ja hoqi dore nga te hollat dhe u lirua.

Ne shtepi "U"-ja se bashku me prinderit e tij vendosi mos me i kerkue ma te hollat.

Mirepo, ai me vone prap i kerkoi te hollat dhe ai u rrembye, u kercenua dhe u ndalua ne dhjetor, ashtu siq eshte pare me heret.

Duke u pergjegjur ne pyetje se si e kishte mesuar identitetin e S [REDACTED] K [REDACTED], "U"-ja deklaroi se disa ushtare i kishin treguar se ky person ishte udheheqesi i zyres kurse ushtaret tjere e pershendetnin me : "Tung S [REDACTED] K [REDACTED] si je?".

T [REDACTED] Z [REDACTED], i cili u vra me vone gjate luftes, e kishte pyetur deshmitarin se cka bente ne ate zyre dhe i tregoi se personi qe e mirrte ne pyetje ishte S [REDACTED] K [REDACTED] N [REDACTED] e S [REDACTED] K [REDACTED] ishte C [REDACTED], ai kishte te veshur nje uniforme te zeze te UCK-se.

Poashtu G [REDACTED] P [REDACTED], R [REDACTED], ishte i pranishem gjate marrjes ne pyetje, ai kishte te veshur nje uniforme te zeze dhe nuk ka bere ndonje pyetje.

T [REDACTED] Z [REDACTED] ja dha emerat e A [REDACTED] K [REDACTED] dhe te tjereve te permendur nga ana e deshmitarit.

"U"-ja nuk e ka identifikuar S [REDACTED] K [REDACTED] ose personat tjere te cilet i kishte permende nga fotografite te cilet kishin qene te involvuar ne rrembimin e tij, mirepo ai e njoho shtabin dhe qendren e ndalimit te UCK-se si dhe fotografite e anetareve tjere te UCK-se qe i njihnte.

Ne nje pyetje te mbrojtjes, "U"-ja nuk ishte ne gjendje qe te kujtonte daten e sakt se kur armata serbe ia kishte djege shtepine ne fshatin e tij, ne Drenovc; ai mundi me thene vetem se ajo pune kishte ndodhe dy apo tre muaj para largimit tij nga Drenovci, qe ishte me 20 dhjetor 1998.

Deshmia e pare e "U"-se ne gjykimin kryesor (14 dhjetor 2005) duke se ka qene e kushtezuar me drojen e tij qe te mos i zbulohet identiteti i tij. "U"-ja ne realitet kishte konfirmuar qe ka qene i arrestuar nga ana e A. K. dhe Z. K., qe eshte sjelle ne shtabin ushtarak ne Drenovc ku ishte marre ne pyetje nga S. K. ne pranine e G. P. S. K. e kishte pyet "U"-ne se pse kishte raporte te keqia me nje ushtar te UCK-se.

Marrja ne pyetje kishte zgjate rreth 40 minuta, i pranishem ishte edhe G. P. Pas marrjes ne pyetje S. K. i urdheroi A. K. dhe Z. K. qe ta rrahnin deshmitarin.

Rrahja ka zgjate perafersisht gjysem ore.

Pas rrahjes S. K. i tha "U"-se "nese ndodhe dicka tjeter ne do te te vrasim" dhe pastaj e lirroi.

Nje shok i tij i tregoi "U"-se kush te cilet ishin S. K. dhe G. P.

Sa i perket dites se arrestimit te tij, "U"-ja e filloi deshmine e tij duke thene se e kishte takuar S. K. me rastin e arrestimit te tij me 16 qershor 1998.

Kjo ishte hera e pare qe ai kishte qene ne shtabin e Drenovcit.

Perafersisht gjate "disa" herave qe kishte qene atje pas heres se pare "U"-ja nuk ka dashte me fole nga frika e zbulimit te identitetit te tij.

"U"-ja ishte konfrontuar me deshmine e tij qe e kishte dhene para Gjykatesit Hetues kur kishte permend muajin korrik.

Kesaj pyetjeje "U"-ja iu pergjigj se pari me daten e 12 qershorit pastaj e korrigoj veten duke thene 16 qershor; duke thene se para Gjykatesit Hetues kishte qene i hutuar kurse tash ishte i sakte duke iu falemnderuar ca shenimeve qe i kishte sjelle me veti te cilat nuk i kishte pase atehere kur eshte marre ne pyetje nga Gjykatesi Hetues.

Ai spjegoi se ai poashtu i kishte kaluar ne burg gjate vitit 2004 pershkak te borxheve te papaguara. Pas lirimit te tij ai ishte marre ne pyetje nga Gjykatesi Hetues mirepo nuk i kishte pas shenimet me veti.

Trupi Gjykues i pa shenimet e deshmitarit ku shkruante 16 qershor, derisa nje date tjeter ishte shlyer.

Sa i perket kohezgjatjes se marrjes se tij ne pyetje nga ana e S. K. "U"-ja tha se nuk i kujtohej qe te kete thene para Gjykatesit Hetues se marrja ne pyetje kishte zgjate kater ore.

Sipas asaj qe dinte me se miri dhe duke i shfrytezuar shenimet "U"-ja tha se i kujtohej qe marrja ne pyetje kishte zgjate perafersisht 40 minuta.

"U"-ja i njohu fotografite e shkolles dhe ne mesin e fotografive te njerezve, fotografia nr. 8 (ajo e S. K. si nje fotografi te nje personi qe e njihte, duke shtuar se nuk ishte ne gjendje t'ia thoshte emerin sepse kishte frike qe te zbulonte identitetin e vet.

Vetem pas ca kembenguljeve nga ana e gjyqit "U"-ja i tregoi disa fotografi tjera te personave qe i njihte (nr. 16 qe eshte B. Z., nr.27 qe eshte I. G. dhe nr.32 qe eshte I. G.) emerat e te cileve nuk deshti t'i pronoconte.

Ne pyetjeme Gjykatesit Kryesor te Trupit Gjykues se pse nuk e kishte njohur fotografine nr. 8 (ate te S [REDACTED] K [REDACTED]) para Gjykatesit Hetues, te cilen perkundrazi e njohu gjate gjykimit kryesor; "U"-ja u pergjegj se ai edhe atehere e kishte njohur ate person por kishte frike me tregua emerin e tij, ai kishte frike per jeten e vet dhe ate te familjes se vet. Per te njejten arsye nuk deshti me i perserite emerat qe i kishte treguar para Gjykatesit Hetues edhe pse ata persona nuk ishin te lidhur me faktet qe hetoheshin.

Gjate seances vijuese (10 maj 2006), "U"-ja kishte thene se e njihnte A [REDACTED] K [REDACTED] si polise ushtarak, se ia njihnte babain Shabanin dhe familjen e tij si deh qe nofken e kishte pase "N [REDACTED]".

"U"-ja e kishte pare A [REDACTED] K [REDACTED] ne Drenovc 4 ose 5 heredhe ia kishte mesuar emerin nga nje ushtar i cili me vone ishte vra gjate luftes.

Deshmitari e kishte pare A [REDACTED] K [REDACTED] poashtu dy jave pas lirimt te tij.

"U"-ja ishte marre ne pyetje nga ana e S [REDACTED] K [REDACTED] lidhur me nje problem qe ai e kishte pase me nje ushtar te UCK-se perafersisht nje jave para dites se marrjes ne pyetje.

Ai kurr nuk e kishte takuar S [REDACTED] K [REDACTED] para asaj dite, pas asaj dite "U"-ja e kishte pare te pandehurin ne ballkonin e zyres nja dy apo tri here, pa pase ndonje problem tjetër me te.

I pyetur nga ana e mbrojtjes qe te spjegonte se si e njihnte te pandehurin, nese kjo ishte nepermes ca ushtareve qe i kishin treguar se ky person ka qene udheheqesi i zyres dhe te cilet e pershendetimin me emerin S [REDACTED] K [REDACTED] ose nepermes nje shoku qe i kishte treguar se kush ishte ky i fundit, deshmitari i konfirmoi te dyat: ne ate kohe e nuk e kishte njohur te pandehurin, kishte nedjuar se ai ishte udheheqesi i zyres, pastaj nje shok poashtu ia tregoi edhe emerin e tij.

Ne seancen e 8 qershorit ishte ndegjuar H [REDACTED] Z [REDACTED] ne cilesine e deshmitarit qe ishte propozuar nga ana e mbrojtjes, i cili konfirmoi se kishte blere nje patundshmeri nga nja bashkefshatar ne fund te vitit 1997 per perfaersisht 30.000 DM.

Ai tha se e kishte bere pagesen ne tri kiste brenda nje viti.

Pagesa e fundit ishte bere pas luftes.

Disa deshmitare kishin qene te pranishem me rastin e berjes se pagesave, mirepo nuk ishte perpiluar asnje kontrate apo deftese me shkrim mbi pagesen.

Raportet e tija me shitesin ishin definuar si jo te keqia.

Deshmitari tha se kater vellezerit e tij ishin ne boten e jashtme, kurse ai dhe nje vella tjetër jetonin ne Kosove.

Duke iu pergjegje pyetjeve te Prokurorit, deshmitari konfirmoi se i kishte paguar tri kiste: e para ishte 2.000 DM; e dyta 12.000 DM. Dhe e treta 10.000 DM (qe eshte 24.000 DM).

I pyetur se a e kishte paguar dallimin prej 6.000 DM-ve, deshmitari u pergjegje se nuk ishte i sigurt lidhur me cmimin e plote, duke potencuar se nuk kishte asnje borxh.

Ai tregoi se shitesit i ngutej dhe deshironte shumen e plote menjehere, mirepo deshmitari nuk e kishte shumen e plote, keshtu qe pagoi ne kista.

Shitesi iu kishte ankuar dikujt se nuk e kishin paguar.

As ai e as vellezerit e tij nuk kane qene anetare te UCK-se.

Kjo Gjykate e konsideron kete pike te ankeses si te pabazuar.

Tregimi i "U"-se eshte koherent, pa mosperputhje vendimtare dhe e perseritur.

Sa i perket kohes se marrjes ne pyetje nga ana e S [REDACTED] K [REDACTED], "U"-ja ka treguar ne nje menyre bindese daten 16 qershor 1998.

Gjate tri deshmive te tij ky deshmitar tregoi se nuk e kishte memorien aq te mire lidhur me datat, meqe nuk ishte ne gjendje te tregonte nje ngjarje te madhe, si per shembull djegjen e Drenovcit dhe te shtepise nga ana e serbeve, duke deklaruar vetem se kjo kishte ndodhe dy apo tre muaj para dhjetorit.

Poashtu lidhur me daten e marrjes se tij ne pyetje ai permendi bashke korrikun dhe qershorin.

Mirepo data e 16 qershorit eshte konfirmuar nga ana e tij pas konfrontimit me deklaratat e tija te mehereshme dhe ishte i sakte duke iu faleminderuar shenimeve te tija qe i kishte sjell me veti.

Trupi Gjykues i kontrolloi ato shenime, mirepo deshmitari preferoi we t'i mos i dorezoje nga frika e zbulimit te identitetit te vet.

Ne pyetjen se pse nuk i kishte perdore ato shenime ai u pergjegj ne nje menyre bindese se nuk i kishte pas me veti keto shenime kur eshte marre ne pyetje nga Gjykatesi Hetues sepse posa ishte liruar nga burgu.

Gjatesia e marrjes ne pyetje qe ishte bere nga ana e S [REDACTED] K [REDACTED], duket te kete thene ne menyre bindese gjate gjykimit kryesor (40 minuta) m'u ne fund te shenimeve te deshmitarit.

Poashtu deklarata e "U"-se lidhur me borxhin qe ia kishte familja Z [REDACTED] per shitjen e patundshmerise eshte e besueshme.

H [REDACTED] Z [REDACTED] faktikisht pranoi se gjate vitit 1998 (kjo ishte koha kur "u"-ja e permendi borxhin e tij) ende nuk e mkishte paguar ne teresi te cilin mund te paguante vetem pas luftes.

Se dyti, H [REDACTED] Z [REDACTED] pranoi se shitesi deshironte te paguhej menjehere dhe ishte ankuar lidhur kete.

"U" konfirmon se i nevoiteshin te hollat per shkak te ca borxheve bile ai gjate vitit 2004 ishte burgosur per shkak te ca borxheve.

Se treti, cmimi ashtu siq eshte pranuar nga ana e H [REDACTED] Z [REDACTED] (30.000 DM) nuk perputhet me shumen qe ai thote se e kishte paguar (24.000 DM), qe mungojne edhe 6.000 DM.

Se katerti, H [REDACTED] Z [REDACTED] tregon se ka inters qe te mohoje borxhin e tij, edhe pse kistet qe i kishte paguar nuk perputhen me cmimin e plote te cilin ai e pranon.

Se pesti, "U"-ja nuk e perfshine S [REDACTED] K [REDACTED] ne borxhin e tij dhe nuk ekziston asnje arsye se pse do t'i bente shantazh ketij apo ndonje te pandehuri tjetere per kete gje.

Spjegimi i "U"-se se si e kishte mesuar identitetin e S [REDACTED] K [REDACTED] duket i besueshem sepse ne shtabin ushtarak eshte e mundur qe ushtaret te pershendesin ate me emerin e tij, disa ushtare kane mundur t'i tregojne deshmitarit lidhur me rolin e rendesishem qe e l [REDACTED] K [REDACTED] dhe me ne fund nje shok i deshmitarit ka mundur te zbuloje emerat e personave me te cilet eshte njohtuar "U"-ja.

Nuk duhet harruar se "U"-ja jetonte ne Drenovc ku ka mundur te shihte S [REDACTED] K [REDACTED] poashtu edhe pas ngjarjes se 16 qershorit 1998.

Nuk mund te harrohet se poashtu deshmitaret tjere e kane treguar S [REDACTED] K [REDACTED] si zevendes te shefit dhe me vone si shef i Policise Ushtarake te UCK-se.

"U"-ja duket te kete frike, deshmite e tij jane plote droje, deshmite e tije jane plote shqetesim qe duhet pranuar dhe lidhur me jeten e tij.

Anonimiteti gjate procedurave nuk ka mund te paraqes nje mbrojtje te mjaftueshme per te, meqenese ne nje vend te vogel nuk eshte veshtire te mesohet se kujt i takon patundshmeria tash (i takon familjes se H [REDACTED] Z [REDACTED] dhe kujt i takonte deri me 1997 (i takonte familjes se deshmitarit).

Megjithate, "U"-ja e mori vetem nje fotografi, ate te S [REDACTED] K [REDACTED]. Siq eshte pare me hheret, deshmia e tij paraqet vetem nje nga shume pjese te provave kunder te pandehurit, lidhur me rolin e tij ne menaxhmin e qendres se ndalimit dhe lidhur me trajtimin jonjerezor qe e kishte pervetesuar kunder te burgosurve.

17.1 Nje ceshtje e fundit duhet te kontrollohet ketu, qe ka te beje me natyren e sjelljes se te pandehurit me te cilen akuzohet dhe ekzistencen e lidhjes se kerkuar ne mes te sjelljes se tij dhe te konfliktit te armatosur.

Duhet te konstatohet se ekzistenca e lidhjes ne mes te sjelljes se te pandehurit dhe te konfliktit te armatosur ne rastet e nenviziara me motive personale eshte konfirmuar me jurisprudencen e Gjykkates Nderkombetare te Krimeve te Luftes ne Ish-Jugosllavine. Ne vendimin e saj te dates 12 qershor 2002 ne rastin Prokurori kunder D. KUNARAC-it et al. Dhoma e Apelit te Gjykkates Nderkombetare te Krimeve te Luftes ne Ish-Jugosllavine(1) ka konstatuar:

"58. Ne fund te fundit ajo qe e dallon nje krim te luftes nga thjesht nje krim te brendshem eshte fakti se krimi i luftes eshte formezyar apo varet nga rrethi – konflikti i armatosur – ne te cilin ky krim eshte kryer. Nuk ka nevojte te kete qene i planifikuar apo i perkrahur nga ndonje forme te politikes. Konflikti i armatosur nuk ka nevojte te jet shkaktar kryerjes se krimit por ekzistenca e nje konflikti te armatosur, se paku, ka lozur nje role te rendesishem ne aftesite e kryersit te vepres penale per te kryer ate, vendimit te tij per te kryer ate, menyra se si eshte kryer ai ose qellimi per te cilin eshte kryer. Prandaj, nese mund te vertetohet, si ne rastin e tanishem, se autori i krimit ka vepruar ne mbeshtetje te apo nen masken e konfliktit te armatosur, do ishte e mjaftueshme te konkludohet se veprat e tija kane qene pres se afermi te lidhura me konfliktin e armatosur. Konstatimi i Trupit Gjykues ne kete pike eshte i panjolla".

Kjo Gjykate konsideron se, edhe pse arsytet te cilat e shqetesuan te pandehurin ne kete rast si dhe ne ate te Murat RRUSTEMIT (shih piken e lartepemendur II.13) This Court deems that, although the reasons which moved the defendant in this case and in that of Murat RRUSTEMI (see above point II.13) duken te jene nga zenkat e mehershme private lidhur me kalimin permes patundshmerise private ne nje rast tjeter) lidhe e nevojshme ekziston ne mes te veprave te te pandehurit dhe te konfliktit te armatosur.

Sjellja e te pandehurit, ashtu siq eshte rekonstruktuar nepermes deshmise se "U"-se, mund te definohet si ndalim kunderligjor, trajtim jonjerezor dhe perdhunimi i intergritetit trupor per rrahjet dhe kercenimet qe jane shkakuar nga ai.

Arsyeja e nje sjellje te tille eshte lidhe me UCK-ne sepse "U"-ja e kishte kete problem (marredhenie te keqia) me dikend nga UCK-ja.

Ne teresi si dhe lidhur me kete pike specifike "U"-ja duket me i besueshem se H [REDACTED] Z [REDACTED], deklaratat e te cilit duken te dyshimta pershka intersit te tij per te mos paguar shumen e plote.

Sjellja e S [REDACTED] K [REDACTED] dhe te anetareve tjere te UCK-se kunder "U"-se duken te kene qene te kryera ne kuader te kontekstit te detyrave zyrtare te autorit te krimi si pjese e struktures se UCK-se te rekonstruktuar bindshem me verdiktin e sfidosur ne faqet 53-56.

Me fjale tjera ata kishin kompetencat per te arrestuar, te marrin ne pyetje dhe te rrahin "U"-ne, te kercenojne per t'i shkaktuar nje dem edhe me te madh vetem per shkak te ekzistimit te konfliktit te brendshem te armatosur.

Nen rrethana te tilla te vecanta ata si pjesetare te UCK-se e kontrollonin rajonin, i zbatonin kompetencat e policise, kishin autorizime konkrete edhe mbi qytetare.

Dhe sjellja materiale kunder "U"-se (si dhe sjellja kunder M [REDACTED] R [REDACTED]) nuk ndryshonte nga ajo qe ushtrohej kunder viktimave tjere: arrestime kunderligjore, sjellja e viktimes ne qendren e ndalimit ose ne shtab, rrahja, kercenime.

Sikurse ne rastin KUNARAC poashtu edhe ne kete rast, dhe pavaresisht nga ndonje arsye private, ekzistenca e konfliktit te armatosur ka lozur nje rol te rendesishem ne akcionet ilegale sepse autoret e krimi ishin ne gjendje t'i kryenin ato vetem pershkak te konfliktit dhe pershkak te kontrollit te rajonit nga ana e njerës pale ne konflikt, qe ishte UCK-ja.

18. Deshmitari anonim "W".

Apelimi e sfidon daten e dhene nga ky deshmitar lidhur me ngjarjen ne mes tij dhe ate te S [REDACTED] K [REDACTED] si dhe per natyren e krimi te luftes kunder popullates civile te nje permase modeste ("goditja me shuplake" e percjellur me kerkim te fajes per incidentin ne fjale).

Data (28 korrik 1998) ishte dhjete dite pas ofenzives serbe dhe ne Drenovc me nuk kishte pjestare te UCK-se.

Vec kesaj, i pandehuri ne ate periudhe kohore ishte ne Shqiperi.

Mbrojtja bene verejtje se "W"-ja nuk mundi te identifikonte S [REDACTED] K [REDACTED] ne fotografite qe i kishte pare gjate fazes se hetimeve, ai ate e identifikoi ne gjykimin kryesor pasi qe fotografia e tij tashme ishte publikuar nga ana e mjeteve te komunikimit.

Gjykata e Instances se Pare e perdori deklaraten e "W"-se per te demonstruar se S [REDACTED] K [REDACTED] e kishte marre ne pyetje se pari djalin e tij e pastaj edhe vet deshmitarin, duke e akuzuar se ishte tradhtar per shkak te paisjes se serbeve me ushqim, me ne fund i pandehuri e kishte godite rende me shpulla.

Kjo Gjykate e konsideron vleresimin e gjykatesit te pare si te drejte.

Gjate fazes hetimore "W"-ja eshte marre ne pyetje nga ana e policise (23/4/2002) si dhe nga ana e Gjykatesit hetues (11/3/2004) dhe kishte treguar se djali dhe gruaja e tij kishin shkuar ne Xerxe per te blere dicka per traktor, ishin rrembyer nga ana e policise serbe, djalin ishte rrahur dhe pastaj ishin liruar.

Kur arriten ne shtepi djali i "W"-se ishte marre nga ana e policise ushtarake te UCK-se, ne mesin e te cileve ishin N [REDACTED] B [REDACTED] i cili e kishte sjelle ne bodrumin e shkolles se Drenovcit, ku ishte marre ne pyetje dhe rrahur nga Komandant C [REDACTED] qe eshte S [REDACTED] K [REDACTED].

Ky i fundit deshironte te dinte se cfare informatash i kishte dhene serbeve ky i ri.

Pastaj djali i "W"-se ishte liruar dhe kthyer ne shtepi, ai i tregoi babait te tij se UCK-ja donte te bisedonte me te dhe se "W"-ja duhej te shkonte atje te nesermen ne mengjes.

“W”-ja shkoi ne Drenovc dhe ishte fut ne zyren e C [redacted] ne katin perdhese te shkolles. C [redacted] e priti duke i thene “eja, eja tradhtar”.

“W”-ja u muar ne pyetje nga ana e S [redacted] K [redacted] lidhur me H [redacted] K [redacted] dhe nje tjetër.

Ai u rrah aq rende nga i pandehuri sa qe u rrezua, ishte goditur ne hunde duke i shkaktuar gjakderdhje.

“W”-ja i kishte permend policise tri apo kater shpulla, kurse Gjykatesit Hetues vetem nje. Ai akuzohej se i kishte furnizuar serbet me mish te gjalle dhe te ngordhur, C [redacted] ia tregoi nje leter nga bashkefshataret e viktimes te cilet e akuzonin ate si tradhtar dhe i tha “Une nuk te kam sjell ketu; kete e kane bere njerezit tuaj”.

“W”-ja nuk mundi te lexonte lletren pershkak te gjakut ne fytyren e tij.

Ai u lirua.

“W”-ja deklaroi se nuk ishte i hidheruar ne S [redacted] K [redacted] por ne fshataret te cilet e kishin derguar letren.

Ne gjykimin kryesor “W”-ja i perseriti detajet e njejta saktesisht.

S [redacted] K [redacted] ishte hidheruar se pse dikush i kishte treguar se “W”-ja “i kishte dhene serbeve mish te gjalle dhe te ngordhur” qe do te thote “se ua ke dhene gruan dhe ushqim per te ngrene”.

“W”-ja theksoi se ishte rrahur nga C [redacted] vetem nje here, pastaj ai oficeri tjetër, I [redacted] i cili me vone ishte vra, e kishte ndale te pandehurin duke thene se “W”-ja nuk ishte ai qe ai kishte menduar se ishte.

Pas rrahjes C [redacted] kerkoi falje nga “W”-ja dhe e luti qe t’i mos i tregonte askujt se cka kishte ndodhur.

Gjykata e konsideron tregimin e “W”-se konsekuent, te sakte, konstant, prandaj plotesishte te besueshem.

Sa i perket mosperputhjeve te propozuara nga apelimi eshte konstatua si ne vijim.

Data e ngjarjes.

“W”-ja i tregoi policise daten e 19 gushtit 1998 si dite ne te cilen kur dikush (te cilet me vone dolen se ishin djali dhe gruaja e tij) shkoi ne Xerxe dhe ishin rrembyer nga serbet dhe kishin kaluar naten ne Rahovec.

Te nesermen familjaret u kthyen ne shtepi, pastaj erdhi policia ushtarake e UCK-se dhe e sollen djalin ne Drenovc.

Kur ai u kthye i tregoi babait te vet se ai duhej te shkonte te nesermen ne Drenovc.

Para Gjykatesit Hetues (ne mars 2004) “W”-ja i eshte pergjegje pyetjes se bere nga ana e mbrojtjes duke thene se kishte harruar daten e faktit, por ishte ne gusht.

I pyetur nga mbrojtja qe t’i referohet dates se deshmive te tija qe ia kishte dhene policise (qe daton nga 23 prill 2004), “W”-ja u pergjigj se nuk ishte ne gjendje te kujtonte daten e sakt te deshmise se tij, duke shtuar se kjo ishte ndoshta dy apo tre muaj me heret, pastaj ai foli per gushtin ose shtatorin e vitit 2003.

Ne gjykimin kryesor ai se pari iu referua muajit te gjashte ose te shtate te 1998, me vone Prokurorit ia kishte permend daten e 28 korikut 1998.

“W”-ja e pershkruan veten si nje njeri te moshuar, pas asaj ngjarjeje ai me nuk ishte thirre nga ana e UCK-se.

Eshte e kuptueshme se ai bene ca gabime lidhur me daten per shkak te moshes.

Megjithate, ai e njohu te pandehurin, te cilin nuk e kishte takuar ne raste tjera.

Identifikimi i te pandehurit.

“W”-ja nuk e ka njohur ate njeri me heret, disa ushtare e quanin ate C [REDACTED], ne te njejten dite “W”-ja pyeti disa ushtare per emerin e tij te cilet konfirmuan se C [REDACTED] ishte S [REDACTED] K [REDACTED].

“W”-ja e pershkruan kete njeri me nje gjatesi prej 1.71m dhe i dobet.

“W”-ja e njohu fotografine e S [REDACTED] K [REDACTED] gjate shikimit te fotografive (Prova A, fotografia nr.23) qe te dyat para policise dhe Gjykatesit hetues.

“W”-ja poashtu e njohu S [REDACTED] K [REDACTED], C [REDACTED] poashtu ne gjykimin kryesor (gjate shikimit te fotografive Prova C, fotografia nr. 8).

Pra nuk eshte drejte te thuhet, ashtu siq bene apelimi, se deshmitari nuk e kishte njohur te pandehurin ne fotografi gjate fazes se hetimeve.

Mund te shtohet se mbrojtja nxorri ne pah para Gjykatesit Hetues se “W”-ja posa e kishte identifikuar fotografine nr. 23 por jo fotografine nr.2 (nga Prova A), e cila e tregon te pandehurin e njejte.

Ne kete pike duhet te konstatohet se keto dy fotografi jane te kualitetit te ndryshem: nr.23 eshte e qarte, nr.2 nuk eshte aq e qarte, duket te jet zmadhimi i nje fotografie dhe ne kete menyre behet e paqarte.

“W”-ja e ka identifikuar njeriun i cili e kishte rrahur ne cdo rast.

Ketu duhet te shtohet se kjo ngjarje, edhepse e kufizuar ne kohe, konfirmon se i pandehuri ka qene drejtperdrejti i involvuar ne marrjen e njerezve ne pyetje, ka bere ca hetime (lidhur me “W” si dhe lidhur me njerez tjere si H [REDACTED] K [REDACTED]), poashtu ka perdore dhunen, ky eshte nje trajtim jonjerezor si kunder djali poasht edhe kunder vet “W”-se.

“W”-ja eshte i besueshem, nuk ka asgje kunder te pandehurit e as kunder UCK-se, ai i ka fale.

19. Ankesa ne fund ekzaminon dhe ven theksin mbi mbrojtjen e S [REDACTED] K [REDACTED] si dhe deshmita lidhur me alibin e tij, qe kane te bejne lidhur me qendrimin e tij ne Shqiperi gjate nje pjese te periudhes vendimtare.

Pikat e vecanta te kesaj mbrojtjeje si dhe te alibise jane ekzaminuar ketu me larte dhe krahasuar me deshmita e deshmitareve dhe provat tjera.

Rezultati eshte se mbrojtja e te pandehurit nuk eshte e besueshme sepse ajo mohohet nga shume pjese te provave te cilat konfirmojne rolin dhe involvimin e S [REDACTED] K [REDACTED] ne veprat penale me te cilat akuzohet.

Ketu nuk jane perfshire ne prova gabimet eventuale qe t’i kete bere i pandehuri per shkak te kalimit te kohes, veshtiresite e aktivitetit te tij gjate luftes, stresi apo trauma ashtu siq thekson apelimi, veshtiresi, stresi dhe trauma qe jane te zakonshme per te gjitha pjesemarresit e atyre ngjarjeve.

Ketu ne prova theksohet se te gjitha deshmita e te pandehurit jane kundershuar nga prova tjera me te besueshme; ajo e B [REDACTED] e dhene para policise ku kishte thene se i pandehuri punonte ne shtab ne Drenovc dhe se kishte ndegjuar per ekzistencen e qendres se ndalimit ne ate vend; se deshmita e S [REDACTED] K [REDACTED] se nuk dinte asgje lidhur me ate burg duket e jobindese dhe me ne fund se ai kishte pranuar se ka qene informuar lidhur me elementet faktike te cilat paraqesin elemnetet konstituive te qendres se ndalimit (shih me larte piken II.5)

Sa i perket alibise se ketij te pandehuri tashme eshte pare (pika II.3) se nuk eshte konsistente dhe nuk verteton se kishte kaluar nje periudhe te gjate dhe te vazhdueshme ne Shqiperi ashtu siq pohon.

Deshmite e deshmitareve e mohojne kete.

Perfundimisht, kriteri i interesit: i pandehuri ka interes qe te mbroje veten dhe per kete qellim ai nuk eshte i obliguar qe te tregojte te verteten.

Deshmitaret e mbrojtjes ishin bashkeluftetare, shoke ose shoqerues te te pandehurit, ata mund te kene bere ndonje gabim bile edhe te kene genjyer per te ndihmuar ate ne kete situatë: kjo eshte nje forme e interesit.

Deshmitaret e Prokurorit nuk duken te kene pasur ndonje interes kunder s [REDACTED] K [REDACTED].

Perkundrazi, disa prej tyre kane qene pjesetare te UCK-se, te tjeret kane deklaruar se e kane fale te pandehurin.

S [REDACTED] K [REDACTED] i akuzoi keta deshmitare per pjesemarrje ne nje lloj komploti kunder tij dhe UCK-se, mirepo nuk ishte ne gjendje "asnje prove te vecant" per kete pohim (22 qershor 2006, faqe 5).

Ata deshmitare kane bere ca gabime, ndonjehere binin ne kundersiztim dhe te gjitha keto pika jane evidentuar si verejtje ne apelim, jane ekzaminuar dhe zgjidhur siq eshte pare ketu me larte.

Besueshmeria e atyre personave eshte vleresuar cdo here dhe ne fund jane konfirmuar.

Nje gabim ne kujtesen e ndonje deshmitari, atehere kur eshte sqaruar sikurse eshte bere ne keto procedura, e konfirmojne autenticitetin e deshmise se tij.

Me ne fund, deshmitaret tjere kane bere ndryshime ne deklaratat e tyre vecanerisht per shkak te frikes ose arsyeve te ngjajshme mirepo edhe keto raste jane hetuar dhe vleresuar siq eshte pare ketu me larte.

AD3 Shkelja e ligjit penal

20. Verdikti eshte sfiduar sepse vendimi i pare gabimisht ka konsideruar te pranishem elementet konstituive te vepres penale te krimeve te luftes. Kurse ne faktet ashtu siq jane vertetuar ekziston mungesa e organizimit qendror dhe te struktures komanduese te UCK-se ne rajonin ne fjale: atje ishin te pranishem vetem grupe kryengritese ne ate kohe dhe deri ne tetor 1998.

Kjo pike tashme eshte ekzaminuar ketu me larte se bashku me argumentet e ngjashme te te pandehureve (shih piken I.2).

AD4 Vendimi mbi denimin

21. Denimi konsiderohet teper i rende nese krahasohet me jurisprudencen e Tribunalit te Hages.

Gjykata duhet te merr ne konsiderate rrethanat e luftes clirimitare si dhe moshen, statusin familjar, mungesen e denimeve tjera dhe situaten ekonomike te te pandehurit, si dhe sjelljen e tij gjate paraburgimit.

Duke vendosur per denimin meritor Gjykata e Instances se Pare i ka marre ne konsiderate, ne pajtim me ligjin, qe te dy faktoret te lidhur me elementet e krimit (shkalla e pergjegjesisse penale, motivet e vepres penale te kryer, shkallen e demit ose te rrezikut per personin e mbrojtur) dhe faktoret qe kane te bejne me rrethanat e faktit dhe te autorit te krimit qe perndryshe jane relevant per qellimet e denimit.

Gjykatesi i pare si udhezues e mori ligjin e rasteve te Gjykates Nderkombetare per Krimet e Luftes ne Ish-Jugosllavi si dhe ate te Gjykates Supreme te Kosoves e cila lejon kesi lloji te referencave lidhur me denimin e vendosur nga ana e Gjykatave Nderkombetare sa i perkete "faktoret e pergjithshem qe kontrollojne denimin" te identifikuar nga ato gjykata nuk dallojne nga ato te definuara ne ligjin e aplikueshem ne Kosove (Neni 41, LR te RFJ1).

Duke filluar nga keto konsiderata gjykatesi i pare bazoi denimin e cdo te pandehuri ne baze te numrit te viktimave (disa), ne baze te kushteve ne te cilat ata jane rrembyer dhe ndaluar (te definuar si trajtim jonjerezor), ne baze te menyres ose sjelljes se te pandehureve (te definuar si turperues dhe duke mosperfillte te drejtat fundamentale te viktimave, duke marre parasysh edhe rrahjen dhe demtimet qe i kane perjetuar).

Nuk eshte gjete asnje rrethane lehtesuese ne favor te te pandehureve, qendrimi i te cileve ndaj Gjykates ishte definuar si "mosperfilles".

Megjithate, denimi eshte vendose afer minimumit te parashikuar me ligj (prej pese deri me pesembdhjete vjet1).

Kjo Gjykate ne pergjithesi i ndane konsideratat e gjykatesit te pare, sepse demtimet dhe poshterimet qe u jane shkaktuar viktimave me sjelljet e ketij apo te pandehureve tjere ishin shume te vrazhda, sikurse qe ishin kushtet nen te cilat ata ishin rrembyer dhe te mbajtur ne arrest.

Mirepo, duket se eshte me vend te behet vleresimi i ketyre elementeve sebashku me disa rretana lehtesuese si rrethana te vecanta te kohes kur jane kryer keto krime si dhe rrethanat personale te te pandehureve (per S. K. ato familiare dhe ekonomike, si dhe qe nuk ka qene i denuar me pare), si dhe per kufijte e imponuar me nenin 65 te KPPK per pjesemarrje ne bashkim kriminal.

Ketyre elementeve duhet t'i shtohet nevoja per t'ia pranuar te pandehureve nje lloj kompenzimi per vonesa te paarsyeshme gjate kohes se procedurave, ashtu siq eshte pare ketu me larte (pika I.4).

Duke i marre parasysh te gjitha keto Gjykata e Instances se Dyte konsideron si te drejte dhe pasues ndaj kriterit ligjor lidhur me vendimin per te zvogeluar denimin e S. K. ne gjashte vjet burgim.

III

Ankesa e R. H. nga Prizreni si mbrojtjes i te pandehurit B. Z. eshte dorezuar me 21 mars 2008.

Vendimi instances se pare eshte sfiduar per shkak te:

- Shkelje esenciale te dispozitave te procedurave penale,
- Verifikimit te gabueshem te situates faktike,
- Shkeljes se ligjit penal dhe

- Vendimit per sanksionimin penal.

Mbrojtja propozon:

- Qe te nderrohet verdikti dhe te lirohen te akuzuarit nga aktakuza.

Bazat per ankese jane si ne vijim:

ADI Shkelje esenciale te dispozitave te procedurave penale:

1. Sipas ankeses dispozitivi eshte jo i qarte dhe kontradiktor, duke mos i specifikuar ne nje ane faktet relevante lidhur me aspektet kryesore me te cilat akuzohet i pandehuri, si dhe identiteti i personave tjere te cilet gjoja kane bashkevepruar me te, koha e arrestimeve kunderligjore si dhe identiteti i personave te arrestuar, sjelljet konkrete me te cilat eshte akuzuar si dhe ne anen tjetere baza e elementit subjektiv mbi bashkveprimin.

Kjo pike e ankeses nuk eshte e bazuar.

Dispozitivi eshte mjaft i qarte lidhur me sjelljet e ketij te pandehuri, fakti se ai ka vepruar ne bashkveprim me persona tjere dhe brenda nje ndermarrjeje te perbashket kriminele, koha e fakteve dhe identiteti i te arrestuareve dhe te personave te mbajtur ne burg.

Se pari duhet te konstatohet se dispozitivi duhet te lexohet ne teresi dhe jo vetem ne ate pjese qe ka te beje me cdo te pandehur.

Nga dispozitivi shihet qarte se dy persona qe kane vepruar ne bashkveprim me B [REDACTED] Z [REDACTED] jane bashke te pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] dhe A [REDACTED] K [REDACTED]

Kjo nuk e perjashton pjesemarrjen e te tjereve ne veper penale, idetiteti i te cileve deri tani mbetet i panjohur.

Deklarimi i pergjegjesise se nje te pandehuri ne bashkveprim me persona te panjohur nuk eshte e ndaluar as me ligj e as me logjike.

Sa i perket kohes mund te konstatohet se disa prej veprave penale te akuzuara dhe ne vecanti mbajtja ne burg ne menyre kunderligjore jane te natyres "permanente", kjo do te thote se keto duhet te zgjasin per nje kohe te caktuar per te ekzistuar.

Ne kete rast, gjate mbajtjes kunderligjore ne burg kane ndodhe ngjarje tjera te cilat e perbejne qellimin e akuzes.

Ne dispozitiv periudha kohore prej 1 maji deri me 31 gusht, gjate se ciles sjelljet kunderligjore kane ndodhe, eshte cekur ne menyre shume te qarte.

Edhe pse sipas B [REDACTED] Z [REDACTED] tregimi i muajit maj eshte gabim ashtu siq do te shihet me vone (shih piken III.4), tregimi i kohes se fakteve per periudhen vijuese eshte e qarte: gjate ketyre muajve (qe nga fillimi i qershorit deri ne fund te gushtit) viktimat jane arrestuar ne menyre kunderligjore, jane mbajte ne burg dhe jane keqtrajtuar.

Poashtu edhe emerat e viktimave jane deklaruar ne menyre te qarte ne cdo akuze individuale te dispozitivit, kjo do te thote per cdo te pandehur.

Ankesa pohon tregim te pamjaftueshem si ne dispozitiv ashtu edhe ne arsyetimin e cdo sjelljeje kunderligjore te te pandehurit ne raport me nje viktime individuale: "cili person ishte arrestuar nga i pandehuri?", cili ishte mbajte ne burg, cili ishte rrahur nga ai?

Teoritikisht, pergjegjia eshte ne Nenin 26 te KP te RFSJ-se: ai qe merr pjese ne nje ndermarrje te perbashket kriminele "eshte penalisht pergjegjes per te gjitha veprat qe

rezultojne nga qellimi kriminel te ketij bashkimi dhe do te denohet sikur ai vet t'i kish kryer ato, pavaresisht se a ka marre pjese apo ne cfare menyre ka marre pjese ne kryerjen e ciles do veper te tille”.

Kjo do te thote se, nese viktimat e permendur ne dispozitiv ishin arrestuar ne menyre kunderligjore, te mbajtur ne burg, te trajtuar ne menyre jonjerezore nga kjo ndermarrje e perbashket kriminele dhe nese B [REDACTED] Z [REDACTED] eshte anetar i kesaj ndermarrjeje atehere ai eshte pergjegjes per te gjitha veprat kriminele edhe pse ai vet nuk ka marre pjese drejtperdrejt ne disa prej ketyre veprave penale.

Praktikisht per kete rast: dispozitivi i verdiktit nuk eshte vendi ku i pandehuri duhet te kerkoj pergjigjen ne pyetjet lidhur me ekzistimin e kesaj ndermarrjeje te perbashket kriminele dhe lidhur me pjesemarrjen e tij ne te.

Dispozitivi permban vetem rezultatit e vleresimit gjyqesor te provave: ndermarrja e perbashket kriminele ekziston, B [REDACTED] Z [REDACTED] ka marre pjese ne te dhe keshtu ai eshte pergjegjes per veprat e saj.

Ne pjesen e arsyetimit te verdiktit qe ka per detyre t'i pergjigjet ketyre pyetjeve dhe sa i perket B [REDACTED] Z [REDACTED] ajo permban cdo pergjigje te nevojshme ne faqet 89-91.

Ne ato faqe mund te lexohet se ky i pandehur ka qene nje individ i njohur, ai eshte permende pothuaj gati nga te gjitha deshmitaret dhe ka pase nje rol te rendesishem ne te gjitha incidentet te cilat pohohen ne aktakuze. Ai eshte definuar si nje pjesemarrës plotesisht i sprovuar te nje ndermarrjeje te perbashket kriminele. Vec kesaj, ca prova tregojne se ai personalisht os bashkarisht ka marre pjese os ka qene i involvuar ne arrestime, mbajtje ne burg dhe trajtim jonjerezor te M [REDACTED] R [REDACTED] H [REDACTED] P [REDACTED] dhe deshmitarit “E”.

Ajo qe eshte thene ne pjesen a arsyetimit te verdiktit te sfidosur lidhur me faktet me te cilat eshte akuzuar ky i pandehur poashtu vlene edhe per elementin subjektiv te ketyre sjelljeve, gje qe qartazi eshte qellimi per te marre pjese ne ndermarrjen e perbashket kriminele per t'i kryer ato vepra penale.

Secila nga keto pika do te ekzaminohet vec e vec ne hollesi me tutje (shih piken III.5), ketu duhet te konstatohet se dispozitivi nuk e permbane shkeljen e ligjit procedural siq pohohet ne ankese.

2. Nje pike e dyte e ankeses ka te beje me gjoja shkeljen e dispozites se nenit 26 KP te RFSJ-se per shkak te mungeses se spjegimit lidhur me pjesemarrjesit dhe qellimet e grupit si dhe per eksploatimin e tij.

Kjo pike ishte adresuar ne pergjithesi ketu me larte (shih piken I.3) dhe ca detaje do te ekzaminohen me tutje lidhur me percaktimin e situates faktike.

Ketu duhet te shtohet se nuk ka dyshim se B [REDACTED] Z [REDACTED] ishte pjesetar i UCK-se ne Drenovc gjate periudhes kritike: para policise ai ka deklaruar se iu eshte bashkangjite UCK-se ne mars te vitit 1998.

Eshte pranuar nga ana e S [REDACTED] K [REDACTED] se ndaj shqiptareve qe pandeheshin si bashkepunetore te serbeve qellimi dhe “linja e veprimit” e UCK-se ishte qe t'i “korrigjonte” ata, qe t'i vej ne rruge te drejte, t'i jap shansen qe bashkepunojne me popullin e vet e te mos e bejne kete me armikun”.

Marrja ne pyetje te ketyre personave ishte nje komponente “vitale” per luften e UCK-se.

Ketu nuk behet diskutimi rreth qellimeve te pergjithshme te UCK-se ne kuader te konfliktit te armatosur, por sjelljet dhe modalitetet konkrete nepermes te cilave disa pjesetare te UCK-se i kane ndjeke ato qellime.

Ne kete rast sjelljet e te pandehureve ne kuader te menaxhmentit te Qendres se Ndalimit ne Drenovc kishin modalitete kriminele, qe ishin te barabarta me veprat penale ne fjale.

Sjelljet e tyre ishin mundesuar nepermes kontrollit te rajonit, nepermes organizates dhe pushtetit te ushtruar gjate konfliktit te armatosur nga ana e UCK-se, qellimet "vitale" te cilat te pandehurit deshironin t'i arrinin.

Ne kete menyre ata persona perdoren nje organizate ekzistuese "me qellim te kryerjes se veprave kriminele".

Ky eshte kuptimi i perdorimit te nenit 26 te KP te RFSJ-se ne kete rast.

3. Mbrojtja paraqet mendimin se denimi eshte dhene ne kundersizim te ligjit nga ana e nje gjykatesi (President i Trupit Gjykes Vinod BOOLELL) i cili sipas nenit 40.2 nr.1 te KPPPK-se nuk mund te jet anetar i trupit gjykes pasi qe ka qene President i Trupit Gjykes i cili gjate fazes paraprake te gjykimit ka vendosur per vazhdimin e paraburgimit kunder B. Z. dhe i cili e kishte aprovuar kerkesen e Prokurorit Publik per te vazhduar kohen per te paraqitur nje aktakuze (shkelje e parapare sipas nenit 403.1 nr.2).

Kjo pike eshte diskutuar dhe eshte konstatuar si jo e bazuar ne pjesen e pergjithshme te ketij denimi (shih piken e lartepermendur I.1).

4. Sipas ankeses, verdikti nuk e respekton akuzen e bashkangjitur ne aktakuze sepse e denon te pandehurin B. Z. per fakte qe kane ndodhe ne mes te 1 majit dhe 31 gushtit 1998, kurse akuza kunder tij (ndryshe nga ato kunder S. K. siq jane cekur ne aktakuzen e ndryshuar ato i referohen nje periudhe kohore me te shkurte prej 2 qershori deri me 31 gusht 1998.

Kjo pike e ankeses eshte e bazuar.

Nga aktakuza e ndryshuar qe eshte dorezuar nga Prokurori me 27 korrik 2006 rezulton se B. Z. (Padia 2) ishte akuzuar me vepren penale te krimit te luftes kunder popullates civile ne forme te trajtimit jonjerezor dhe vuajtjes se madhe ose perdhunimit te shendetit trupor dhe aplikimi i masave te intimidimit dhe te terrorit kunder te burgosureve civil te Qendres se Ndalimit ne drenovc ne nje date ne mes te 2 qershorit dhe 31 gushtit 1998, ne kundersizim me nenin 142 te KP te RFSJ-se lexuar bashke me nenet 22,24,26 dhe 30 te KP te RFSJ-se.

Verdikti i instances se pare e ka shpall B. Z. fajtor per veprat penale me te cilat eshte akuzuar ne nje date ne mes te 1 majit dhe 31 gushtit 1998.

Ne kete pike dispozitivi permban nje gabim, i cili eshte me i qarte ne cilesine e arsytimit te denimit te pare (faqe 12) sqaron se sipas aktakuzes "qe te gjitha kater te pandehurit kane marre pjese ne periudhen ne mes te 2 qershorit dhe 31 gushtit 1998 (perveq se ne rstin e S. K. data fillestare eshte 1 maji 1998) ne nje ndermarrje te perbashket kriminele" (venja e theksit eshte shtuar).

Ne asnje pjese tjeter te verdiktit nuk eshte permend pjesemarrja e mundshme e B. Z. ne veprat kriminele per nje periudhe para 2 qershorit 1998.

Eshte e qarte se ky eshte nje gabim material e autorit te dispozitivit te instances se pare.

Mirepo, nepermes ketij gabimi verdikti e tejkalon akuzen a perfshire ne aktakuzen e ndryshuar dhe bene shkeljen e nenit 386 paragrafi 1 dhe neni 403 paragrafi 1 te KPPPK-se.

Ne kete rast, sipas nenit 426 paragrafi 1 te KPPPK-se Gjykata e Instances se Dyte do te modifikojte denimin e sfiduar.

Ne kete rast modifikimi i denimit eshte i kufizuar ne kohen e kryerjes se veprave kriminele, e cila eshte reduktua ne periudhen ne mes te 2 qershorit dhe 31 gushtit te vitit 1998..

Efekti i ketij reduktimi do te mirret parasysh per sa i perket denimit.

AD2 Percaktimi i gabuar dhe jo i plote i situates faktike

5. Sipas ankeses, Gjykata e Instances se Pare nuk ka ofruar asnje prove lidhur me sjelljet kunderligjore me te cilat eshte akuzuar i pandehuri, por e denoi ate ne baze te thashethemeve te individeve.

Gjykata e konsideron kete pike si te pabazuar.

Provate qe kane te bejne me B. Z. nuk mund te definohen si thashetheme ose supozime.

M. S. dhe S. S. deshmuan lidhur me zhdukjen e S. S., te dhenat e te cilit i mesuan nga H. M.

Sipas ketyre deshmiteve, M. tregoi anetareve te familjes se ata do te mund te kontaktonin ca persona ne Drenovc per te mesuar dic me shume lidhur me fatin e S. ne mesin e atyre emerave ishte edhe emeri i B. Z. R. S. e konfirmoi kete dhe tregoi se kishte shkuar dy here ne Shtab ne Drenovc per te kerkuar B. Z.

R. S. kishte mesuar nga H. M. se B. Z. ishte komisar politik ne Drenovc, mirepo ky i fundit nuk kishte deshiruar qe ta takonte.

Gjate vizites se pare ne Drenovc, R. S. ishte i shoqeruar nga H. M. Kjo tregon se involvimi i B. Z. ne Qendren per Ndalim ishte ne realitet njera nga temat e tregimit te H. M. qe ia kishte treguar anetareve te familjes S. keshtu qe R., babai i S. S. shkoi pothuaj menjehere se bashku me H. M. ne Drenovc per te kerkuar pikerisht komisar politik B. Z.

M. i H. M. ne gjykimin kryesor nuk ishte i besueshem, sepse ai se pari mohon qe te kete permendur ndonje emer, pastaj pas konfrontimit me deshmite e tij te mehershme pranon qe te kete permendur ca nofka. Ai poashtu pranon te kete shoqeruar anetaret e familjes S. per ne Drenovc.

Nese R. S. se bashku me M. kane shkuar ne Drenovc per te kerkuar pikerisht B. Z. kjo eshte bere sepse dikush (ky eshte vet M.) e kishte permend kete emer me heret.

R. S. nuk e kishte njohur Z. para ketij momenti.

Poashtu "A"-ja foli lidhur me B Z duke e identifikuar fotografine e tij dhe suke thene se i pandehuri ishte informuar lidhur me cdo gje qe i kishte treguar deshmitari Gykatesit Hetues (deshmia e 26 shkurt – 3 Mars faqe 10).

Per sa i perket B B vlen te konstatohet se deshmitari anonim "B" kishte shkuar me shume se 30 here ne Drenovc duke e kerkuar ate person.

Ne Drenovc disa persona i kishin treguar "B"-se ne afersi te shtabit se ata te cilet do te mund te zgjidhnin problemet e tij ishin B Z dhe S K. Para Gykatesit Hetues, "B"-ja kishte deklaruar se njerezit ne Drenovc i kishin treguar se B Z ishte pergjegjes per ate burg.

"B"-ja arriti te takohej me B Z me 16 korrik, kurse K nuk e kishte takuar personalish asnjehere.

B Z i tregoi "B"-se se UCK-ja do te vinte ne Brestovc (fshati i B B) brenda 3 apo 4 diteve dhe "do te shohim se cka do te mund te bejme atje".

Keshtu "B"-ja iu drejtua B Z duke menduar se ai do te mund te ndihmonte per te siguruar lirimin e B B.

Z nuk e ka mohuar rolin e tij, duke premtuar se UCK-ja do te ishte ne gjendje te ndihmonte brenda ca diteve lidhur me kete ceshtje.

"B"-ja e identifikoi fotografine e B Z si para Gykatesit Hetues ashtu edhe ne gjykimin kryesor.

Per sa i perket H K qe te dy deshmitaret "TT" dhe "N" kishin deklaruar se ishin drejtuar, ne mesin e shume njerezve, vetem ke B Z komisar politik, i cili i drejtoi ke S K.

Keta dy deshmitare donin te vizitonin H dhe S K iu tha se njeriu qe kishte kompetenca lidhur me kete ceshtje ishte Z si "komisar politik".

"TT"-se i kujtohet se kishte biseduar me shume se nje here me Z dhe me S K dhe keta i kishin thene qe te mos kthehej aty me.

Bile Z kishte kercenuar "TT"-ne se do ta arrestonte.

Qe te dyte "N"-ja ddh "TT"-je e identifikuan B Z ne fotografi.

"TT"-ja ishte ushtar ne Drenovc, keshtu qe ai duhet t'i ket njohur pjesetaret e UCK-se dhe funksionin e tyre sa i perket Qendres se Ndalimit shume mire.

Kur ai shkoi ne Drenovc per te gjetur H P deshmitari "Z" e mori nje keshille nga Z B qe te shkonte ne shtab dhe te pyeste per B Z. "Z"-ja faktikisht u takua me Z i cili ishte i veshur me uniforme ushtarake dhe ishte i armatosur.

Z e drejtoi "Z"-ne ke G P dhe policia ushtarake.

Pas ca diteve H P u vizitua ne burg edhe pse B Z kishte ngurruar qe te lejonte kete vizite ("ata mund te shohin H, por H nuk mundet me i pa ata").

"Z"-ja e identifikoi B Z nga fotografia.

"D"-se iu kujtua se gjate ndlimit te H P ishte gjetur nje kufome qe konsiderohej se ishte e H.

Kjo kufome ishte sjelle ne shtepine e H por me vone u be e qarte se H ende ishte gjalle.

Ne ate moment B [redacted] Z [redacted] i cili ishte veshur me uniform, e ftoi "D"-ne ne zyren e tij dhe ia mori deklaratat lidhur me rrethanat qe kishin te benin me kufomen.

Pastaj Z [redacted] leshoi nje urdher se kufoma do te duhej te sillej ne Drenovc dhe pastaj ne stacionin e policise ne Rahovec, ku u ndermorren ca hetime.

"D"-ja e identifikoi B [redacted] Z [redacted] ne fotografi.

Keshtu, siq eshte konstatuar ne verdiktin e instances se pare, B [redacted] Z [redacted] jo vetem qe kishte poziten me autoritet per te cilen arsye njerezit e pyesnin lidhur me te arrestuarit, por poashtu ishte ne gjendje te ushtronte ekzaminimin e deshmitareve dhe te ipte urdhera lidhur me ndonje hetim.

Deshmitaret N [redacted] dhe H [redacted] R [redacted] shkuan ne Drenovc per te kerkuar te afermin e tyre M [redacted], ata u takuan dhe biseduan me B [redacted] Z [redacted].

I pandehuri se pari spjegoi se "cdo person i moshes 50 apo me shume vjeqare do te konsiderohet pergjegjes" (H [redacted] R [redacted]); pastaj Z [redacted] pranoi se ishte pergjegjes per rrembimin e M [redacted] R [redacted] ("Une jam ai qe ta ka marre baben"), duke shtuar se rrembimi kishte te bente me nje konflikt personal ne mes te M [redacted] dhe familjes se tij dhe se "koha ime ka ardhe. Une mund te bej cka te dua".

Deshmitaret shkuan disa here ne Drenovc dhe ishin ne gjendje te kuptonin se B [redacted] Z [redacted] ishte "ai qe vendoste atje" (N [redacted] R [redacted], ishte "komisari politik" (H [redacted] R [redacted]).

E [redacted] R [redacted] "tregoi lidhur me nje "grup te B [redacted] Z [redacted], ai eshte ai grup kryesori i te cilit i ishte i pandehuri, te cilit i bindeshin te gjitha "ne fshat dhe ne rrethine": Z [redacted] ishte komandant i UCK-se e jo ushtar.

E [redacted] dhe vellau i M [redacted] ishin rrahur nga pjesetaret e ketij grupi.

E [redacted] deklaroi se M [redacted] ishte marre ne baze te urdherave te B [redacted] Z [redacted].

N [redacted] R [redacted] deklaroi se i kishte ndegjuar klithmat e te burgosureve.

Deshmitari "X" tregoi se ai vet, M [redacted] R [redacted] dhe H [redacted] T [redacted] ishin burgose dhe rrahur ne Drenovc.

Deshmitari "O" e identifikoi fotografine e M [redacted] R [redacted], duke shtuar sete burgosurit qe i kishte takuar ne Malisheve kishin thene se M [redacted] i kishte vdeke per shkak te rrahjeve.

Keshtu qe: B [redacted] Z [redacted] kishte pranuar para deshmitareve se ai ishte pergjegjes per rrembimin e M [redacted] R [redacted] i cili sipas deshmitareve tjere ishte rrahur dhe trajtuar ne menyre jonjerezore ne Drenovc.

Z [redacted] kishte vepruar per t'u hakmarre per nje konflikt personal mirepo ai kete e beri ne kuader te detyrave te tija zyrtare si pjese te struktures se UCK-se.

Tsashme eshte pare (ne piken me larte II.17.1) se si ne rastin e M [redacted] R [redacted] dhe te deshmitarit "U" autoret e krimit mund te arrestonin civilin, t'i rrahnin dhe t'i kercononin per t'iu shkaktuar deme me te keqija vetem sepse si pjesetare te UCK-se e kontrollonin ate rajon (zonen e lire), zbatonin kompetencat e policise, kishin kompetenca konkrete poashtu edhe mbi civilin.

Dhe sjellja konkrete nuk dallohej nga ato te ushtruara kunder viktimave tjera.

Perkunde arsyenave private qe mund t'i kene pase, aksionet kunderligjore ishin te mundshme vetem nepermes ekzistimit te konfliktit dhe ne saje te kontrollit te atij rajoni nga njera ane e konfliktit, qe ishte UCK-ja.

Nepermes ketyre aksioneve kunderligjore B Z dhe te pandehurit tjere e shfrytezuan per qellime kriminele nje organizate ekzistuese, siq ishte UCK-ja.

Poashtu M B, i cili e kerkonte babain e tij A konfirmon se kishte folur me B Z i cili ishte i njohur si "komisari politik" qe eshte nje "zyrtar i larte"ne Drenovc.

6. Nje pike specifike e ankeses i eshte dedikuar deshmise se deshmitarit "E" e cila konsiderohet si kontradiktore dhe jo e besueshme.

Kjo pike e ankeses duket e pabazuar.

Ashtu siç eshte pershkruar me mire ketu me lart (shih piken II.16) "E"-ja duket te jetë i besueshem ne mesin e pikave tjera ku ai deklaroi se ka qene i burgosur ne ne Drenovc, ku ishte rrahur1 dhe te kete qene i marrur ne pyetje nga B Z i cili e akuzoi ate se ishte spiun i serbeve kunder UCK-se.

"E"-ja mbeti tri dite e tri nete i burgosur ne nje depo per thengjill, duke fjetur ne toke, pa batanie, pa ushqim dhe uje per te pire, pa mundesin per ta lare gjakun e tij apo te shkoi jashte ne tualet jashte qelise se tij.

Ne fund B Z liroi ate.

"E"-ja jap nje pershkrim te Z i cili perputhet me pamjen e te pandehurit; "E"-ja i pershkruan rrobet e Z (rrobet civile) ne te njejten menyre sikurse deshmitaret tjere; "E"-ja i identifikon fotografite e Z duke shtuar se i pandehuri ka qene pjesetar i UCK-se dhe ky detal poashtu eshte konfirmuar nga ana e deshmitareve tjere dhe eshte pranuar nga ana e vet te pandehurit ashtu siq eshte pare ne pjesa tjera te ketij denimi.

Nuk ka asnje gjurme te deshmise se rrejshme ose te shpifjes kunder te pandehurit dhe kontradiktat perfshinin ato se kush e kishte kercenuar kete deshmitar me arme: B Z (siq kishte deklaruar para policise dhe Gjykatesit hetues) ose I C (siq kishte deklaruar ne gjykimin kryesor duken te jene te spjegueshme ne baze te veshtiresive te cekura me larte qe i ka perjetuar "E"-ja.

"E"-ja ishte marre ne pyetje nga ana e B Z ashtu siq ishte rasti i deshmitarit "D" dhe ne fund ishte liruar nga ana e Z sepse ai mund te bente cdo gje qe deshironte, ashtu siç kishte i thene N dhe H R.

7. Një çështje tjetër e ankesës ka të bëjë me pretendimin e keq-interpretimit të dëshmisë së dëshmitarëve tjerë, të cilët në fakt nuk kanë deklaruar për trajtimin jo-human të kryer nga i pandehuri.

Të gjitha faktet e lartpërmendura të deklarauara nga dëshmitarët hedhin poshtë tezat e mbrojtjes: siç ishte rasti për S K, B Z ishte pjesëtarë i organizimit dhe menagjimit të Qendrës për Paraburgim dhe i trajtimit johuman i cili ishte i rezervuar për të paraburgosurit.

Kjo vërtetohet me faktin se ka mund "të marr" persona (si M R, ti intervistojë dëshmitarët apo të dyshuarit ("D", dhe "E"), ka patur mundsinë që të ndërhyjë në vizitat e të paraburgosurve (H P), ai ishte personi i kërkuar nga dëshmitarët kur këta të fundit dëshironin ti vizitonin të paraburgosurit, ai ishte me influencë si "komesar politik".

Z [REDACTED] është përgjegjës për “marrjen” dhe intervistimin e personave, dhe si rrjedhim pjesmarrje direkte në menagjmentin e qendrës së paraburgimit.

Përgjegjësia e tij pra është e bazuar gjithashtu në parimet e nenit 26 siç shihet më lartë: si pjestarë i vetëdijshëm i ndërmarjes së përbashkët kriminale ai e ka përdorur organizatën ekzistuese kriminale “me qëllim të kryerjes së veprave penale”.

I pandehuri është përgjegjës për krimet e kryera nga kjo organizatë, “si ti kishte kryer ai vetë ato, pavarësisht nëse dhe në çfarë mënyre ai vetë ka marrë pjesë në kryerjen e cilitdo nga këto vepra”.

Kushtet e paraburgimit të “E”, rrahjet që i kanë vuajtur shumë viktimat janë prova të mjaftueshme për trajtimin johuman në Drenovc.

AD3 Shkelja e ligjit penal

8. Shkelja e dispozitave që kanë të bëjnë me ekzistimin e grupit kriminal, me bashkëkryerjen dhe me ndihmën e dhënë kryerësve.

Kjo çështje është shqyrtuar dhe është hedhur poshtë më lartë (shih pikat III.1 dhe III.2).

9. Shkelja e ligjit mbi krimet e luftës, në kuptimin e mungesës së elementeve bazë për krim të luftës sepse askush nga viktimat e supozuara nuk i ka takuar partisë opozitare, meqë të gjithë kanë qenë Shqiptarë të Kosovës.

Kjo çështje është shqyrtuar dhe është hedhur poshtë si më lartë. (shih pikën I.2).

Këtu vetëm duhet shtuar faktin se të qenurit Shqiptarë të Kosovës të dytë si të pandehurit ashtu dhe viktimat nuk e përjashton vetvetiu ekzistimin e krimit të luftës sepse ky ishte një konflikt i brendshëm i armatosur, konflikt në mes të njerëzve që kanë jetuar në të njëjtin Shtet dhe ndonjëherë u kanë takuar të njëjtës kombësi.

Në fakt, viktimat kanë qenë të dyshuara nga UÇK-ja të kenë qenë bashkëpunorë të Sërbëve, që do të thotë tradhëtarë të popullit të tyre në favor të armikut.

AD4 Vendim mbi sanksionet penale

10. Ankesa e konsideron dënimin e ngarkuar si tepër të rëndë dhe pretendon mungesën e arsytimit sa i përket dënimit të vënë të pandehurit, dhe në veçanti nuk ka marrë parasysh situatën e tij ekonomike dhe sociale.

Tashmë është konstatuar në një pjesë të këtij aktgjykimi lidhur me vlerësimin e dënimit të vendosur nga gjykatësi i shkallës së parë kundër S [REDACTED] K [REDACTED] (shih pikën më lartë II.21) se Gjykata e Qarkut të Prizrenit ka konsideruar faktorët që janë të lidhur me elementet e krimit (shkalla e përgjegjesisë penale, motivet e kryerjes së veprës penale, shkalla e dëmtimit apo rreziku i objektit të mbrojtur) dhe faktorët që kanë lidhje me rrethanat e faktit dhe të kryerësve përndryshe të rëndësishme për qëllimet e dënimit, sidhe praktika e ligjit të Tribunalit të Hagës.

Gjykatësi i shkallës së parë e ka bazuar dënimin për secilin të pandehur në një numër të viktimave (disa), kushtet nën të cilat ata janë rrëmbyer dhe paraburgosur (të karakterizuara si trajtim johuman), në mënyrën e sjelljes së të pandehurve (të karakterizuar si poshtues dhe shpërfillje e të drejtave elementare të viktimave, duke

patur parasysh gjithashtu rrahjet dhe lëndimet që ta i kanë pësuar), pa gjetur ndonjë rrethanë lehtësuese, megjithatë vendosi për dënimin afër minimumit të parashikuar me ligj (prej pesë deri pesëmbëdhjetë¹⁷).

Kjo Gjykatë ndanë pikpamjet në përgjithësi me gjykatësin e shkallës së parë, sepse lëndimet dhe poshtrimet e shkaktuara viktimave me sjelljen e këtre dhe të pandehurve të tjerë ishin shumë të rënda, sidhe kushtet nën të cilat at u rrëmbyen dhe u paraburgosën. Mirëpo si duket do të ishte e duhur që të vlerësohen këto elemente së bashku me disa rrethanat lehtësuese si rrethana të veqanta për kohën kur janë kryer krimet dhe kushtet personale të të pandehurve (për B. Z. situata e tijë ekonomike dhe sociale), si dhe limitet e dhëna sipas nenit 65 të KPPK-së për pjesmarrjen në bashkimin kriminal. Për më tepër vendimi i shkallës së parë është modifikuar pjesërisht në favor të B. Z. përmes reduktimit të periudhës kohore të veprave penale të cilat tanimë nuk përfshijnë periudhën nga 1 Maji deri më 1 Qershor të vitit 1998. Këtyre elementeve duhet shtuar nevojën për njohjen e njëfarë kompensimi për secilin të pandehur për vonesën e paarsyeshme në kohë të procedurës, siç shihet më lartë (pika I.4). Duke patur të gjithë këtë parasysh Gjykata e Shkallës së Dytë e konsideron të drejtë dhe në pajtim me kriteret ligjore sa i përket dënimit, që ta reduktojë dënimin për B. Z. në gjashtë vite burgim.

IV

Ankesa e [redacted] nga Prishtina si avokat mbrojtës i të pandehurit A. KI është paraqitur me 20 Mars 2008. Aktgjykimi i shkallës së parë është sfiduar për shkak të:

- shkeljeve esenciale të procedurës penale Neni 403 par. 1, pika 10,12 dhe par.2 pika 1 dhe 2 të KPPK-së,
- shkelja e ligjit penal,
- përcaktimi i gabuar dhe i mangët i gjendjes së fakteve dhe
- vendimi mbi Dënimin.

Avokati mbrojtës propozon:

- të ndërrohet vendimi duke e liruar të pandehurin nga akuzat, ose
- ta pushojë lëndën dhe ta kthejë atë në Gjykatën e Shkallës së Parë për rigjykim, njikohësisht të urdhërohet ndërprerja e paraburgimit.

Bazat e ankesës janë si në vijim.

AD1 Shkelje e konsiderueshme e dispozitave të procedurës penale

1. Ankesa pretendon se ka pohime të paqëndrueshme në dispozitiv dhe kundërshtime në mes të dispozitivit dhe pjesës së arsyetimit.

¹⁷ Dënimi me vdekje i paraparë në Nenin 142 KP RFJ është zavendësuar me 15 vite burgim, shih Gjykata Supreme e Kosovës 21 Korrik 2005 në lëndën Prokurori kundër Latif Gashit dhe të tjerëve.

Në veqanti, sipas ankesës A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] rezulton si i dënuar dhe i liruar për akuzën lidhur me dëshmitarin "X".

Kjo pikë është e pabazë.

Duke lexuar dispozitivin dhe gjithashtu arsyetimin e vendimit të shkallës së parë (faqja 9,11 dhe 14) është e qartë se ky i pandehur është liruar nga akuza lidhur me dëshmitarin "X" sepse ky dëshmitarë kurrë nuk është marrë në pyetje nga ai dhe se deklaratat e "X" nuk mund të përdoren kundër këtij të pandehuri.

"X" është marrë në pyetje në shqyrtimin gjyqësor me 30 Nëntor 2005, ndërsa A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] është ekstraduar nga Zvicra me 09 Dhjetor të vitit të njëjtë, aktakuza ndaj tij ishte konfirmuar me 28 Shkurt 2006 dhe më vonë në procedura e tij është bashkuar me procedurat kundër të pandehurëve të tjerë.

Kështuqë nuk ka dënim të A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] lidhur me "X" dhe dispozitivi nuk mund të definohet si kontradiktor.

2. Ankesa e konsideron dispozitivin si të paqartë dhe kontradiktor, me mungesë që të specifikojë në një rën anë identitetin e personave të tjerë të cilët pretendohet se kanë vepruar së bashku me të pandehurin dhe në anën tjetër konsiderimi i periudhave të ndryshme kohore për kryerjen e veprës së njejtë penale nga të akuzaurit e tjerë.

Kjo pikë është e pabazë.

Siç është parë tashmë lidhur me pretendimet analoge në ankesën për B [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] (shih pikën më lartë III.1), të tre të pandehurit S [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], B [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] dhe A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] janë dënuar sepse ata kanë vepruar në bashkupim mes veti dhe me të tjerët deri tani persona të panjohur.

Kjo është e lejuar logjikisht dhe ligjrisht dhe mbi të gjitha është e provuar në dosjen e lëndës.

Deklarimi i përgjegjesisë së të pandehurit në bashkupim me persona të panjohur nuk është e ndaluar me ligj e as sipas logjikës.

Gjithashtu koha e fakteve qartë është paraqitur: prej 1 Majit deri më 31 Gusht.

Ky specifikim i përkohshëm nuk është tërësisht i saktë në lidhje me sjelljen e A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] i cili ishte i akuzuar vetëm për periudhën nga 2 Qershori deri më 31 Gusht: në më të pikë kjo Gjykatë do të kthehet më tej (shih më tej IV.4.b).

Sidoçoftë kohëzgjatja e përcaktuar nga gjykatësi i shkallës së parë është i saktë: faktet kanë zgjatë rreth katër muaj, gjatë kësaj kohëzgjatje secili nga të pandehurit ju ka bashkangjitur kësaj veprimtarie penale për një periudhë të caktuar dhe është dënuar vetëm për këtë.

3. Sipas ankesës vendimi është i kundërshtueshëm lidhur me bashkveprimin e neneve 22 dhe 26 të KP të RSFJ, të cilat në fakt janë të papajtueshme me njëra tjetrën.

Gjithashtu kjo pikë është e pabazë siç është shënuar më lartë (shih pikën I.3).

Këtu mund të shtohet se nga dosja e lëndës rezulton pjesmarrja e drejtëpërdrejtë e A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] në disa arrestime joligjore dhe keqtrajtime të viktimave: kjo do të thotë se në disa raste specifike bashkveprimi i tij në kryerjen e krimeve kundër civilëve.

Në rastet tjera ky i pandehur është përgjegjës në pajtim me parimet e nenit 26 të KP të RSFJ për pjesëmarrjen në bashkëveprimet penale i cili ka kryer krimet që burojnë nga plani i rëndomtë penal.

Aplikimi i sotëm i dy dispozitave ligjore të ndryshme (nenet 22 dhe 26 të KP të RSFJ) fakteve nuk është e ndaluar për shkak të kompleksitetit, kohëzgjatja e veprës penale dhe sjelljet e ndryshme sidhe niveli i pjesëmarrjes i secilit të pandehur në segmentet e krimit. Ku për "segmentin e krimit" mendohet në sjelljen e secilit të pandehur në lidhje me secilën viktimë.

4. Ankesa pretendon se vendimi i sfiduar tejkalon aktakuzën për dy arsye të ndryshme: a) e marrë dënimin e të pandehurve si sjellje të të pandehurve lidhur me viktimat për të cilët aktakuza nuk është konfirmuar, dhe b) dënimi është i lidhur për periudhën kohore (prej 1 Majit deri më 31 Gusht 1998) që është i ndryshëm nga koha e shënuar në aktakuzë (prej 2 Qershorit deri më 31 Gusht).

Kjo Gjykatë e konsideron pikën e parë të pabazë, ndërsa pika që ka të bëjë me kohën e kryerjes është e bazuar, siç është parë tashmë në ankesën e B. Z. a) Neni 376.1 i KPPK-së i siguron Prokurorit Publik mundësinë për ta ndryshuar aktakuzën në pajtim me situatën faktike si provohet nga dëshitë e prezentuara në shqyrtimin gjyqësor.

Kjo nënkupton rregullsinë e ndryshimeve të paraqitur nga ana e Prokurorit kundër A. K. me 27 Korrik 2006, si për identitetin e viktimave ashtu dhe për ligjin në fuqi (neni 26 i KP të RSFJ).

Në këtë lëndë nuk është i bazuar pretendimi se është tejkaluara aktakuza, meqë Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur në pajtim me akuzën e marrë nga aktakuza e ndryshuar.

b) Nga aktakuza e ndryshuar e paraqitur nga ana e Prokurorit me 27 Korrik 2006 rezulton se A. K. (akuza 4) është akuzuar me veprën penale krime të luftës kundër popullatës civile në formë trajtimit johuman dhe vuajtjes pamasë apo shkelja e shëndetit trupor dhe aplikimi i masave të friksimit dhe terrorit kundër të paraburgosurve civil në Qendrën e Paraburgimit në Drenovc në datat mes 2 Qershorit dhe 31 Gushtit 1998, në kundërshtim me nenin 142 të KP të RSFJ lexuar me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP të RSFJ.

Vendimi i shkallës së parë e shpallë A. K. të fajshëm për veprat penale me të cilat akuzohet për kohën në mes të 1 Majit dhe 31 Gushtit 1998.

Në këtë pikë dispozitivi përmban një gabim, i cili është më shumë evident se sa arsyetimi i aktgjykimit i parë (faqja 12) i cili sqaron se në pajtim me aktakuzën "që të katër të pandehurit kanë marrë pjesë gjatë periudhës në mes të 2 Qershorit 1998 dhe 31 Gushtit 1998 (përveqse në rastin e të pandehurit S. K. data e fillimit është 1 Maj 1998) në ndërmarrjen e përbashkët penale" (është shtuar theksimi).

Në asnjë pjesë tjetër të aktakuzës nuk është përmendur pjesëmarrja e mundshme e A. K. në veprën penale për periudhën para 2 Qershorit 1998.

Është i qartë gabimi material i autorit të dispozitivit të shkallës së parë.

Megjithatë përmes këtij gabimi vendimi tejkalon akuzën e marrë nga aktgjykimi i ndryshuar dhe e shkel nenin 386 paragrafi 1 dhe nenin 403 paragrafi 1 nr 10 të KPPK-së.

Në këtë rast, në pajtim me nenin 426 paragrafi 1 i KPPK-së Gjykata e Shkallës së Dytë do ta modifikojë aktgjykimin e sfiduar. Në këtë rast modifikimi i aktgjykimit është i limituar për kohën e kryerjes së veprës penale, i cili reduktohet për periudhën në mes të 2 Qershorit dhe 31 Gushtit të vitit 1998.

Efekti i këtijë reduktimi do të konsiderohet varësisht nga dënimi.

5. Sipas ankesës në fazën hetimore ka ardhur vërtetë deri te shkelja e të drejtës së dëshmitarit që të jetë i përfaqësuar nga avokati mbrojtës, sepse dëshmitari nuk ka qenë i përfaqësuar gjatë pjesës së parë së hetimeve që kanë filluar me 15.04.2004.

Kjo pikë e ankesës është e pabazë.

Neni 73.1 i KPPK-së siguron çështjen e mbrojtjes së detyrueshme, në mes të të cilave vjen si provë: pika nr 2) "në seancën ndëgjimore për paraburgim dhe gjatë gjithë kohës kur ai apo ajo gjindet në paraburgim; 3) nga paraqitja e aktakuzës, nëse aktakuza është ngritur kundër tijë apo asaj për veprën penale të dënueshme me burgim prej së paku tetë vjetë".

Neni 70 i Ligjit mbi Procedurën Penale të RSFJ (LPP) i dhënë në pjesën përkatëse sa i përket mbrojtjes së detyrueshme vetëm "3) kur aktakuza është ngritur për shkak të veprës penale për të cilën dënimi me burgim prej 10 vjetësh apo dënim më i rëndë mund të shqiptohet sipas ligjit".

Në këtë lëndë kundër A. K. Gjykatësi Hetues Ndërkombëtar i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit ka lëshuar vendimin, të datës 20 Shkurt 2004, për të kryer hetimin dhe të njejtën ditë ka lëshuar një urdhërarrest. Me 15 Prill 2004 gjykatësi Hetues Ndërkombëtar lëshoi një vendim të ndryshuar për të kryer hetimet dhe për të caktuar paraburgimin kundër A. K.

Mbi bazën e këtijë vendimi të ndryshuar Gjykatësi Hetues Ndërkombëtar ka lëshuar urdhërarrestin e dytë dhe ka kërkuar lëshimin urdhërarrestit ndërkombëtar meqë i dyshuari besohej se jetonte në Zvicër.

Me kërkesën e Autoriteteve Zvicrane për ekstradimin formal Gjykatësi Kryesues Ndërkombëtar kërkoi me 8 Janar 2005 asistencë ligjore nga Departamenti i Drejtësisë dhe po të njejtën ditë i ka mbyllur hetimet kundër A. K. duke e dërguar dosjen te Prokurori Publik Ndërkombëtarë në pajtim me nenin 174 paragrafi 1 dhe 2 të LPP.

A. K. ishte ekstraduar nga Zvicra me 9 Dhjetor 2005 dhe në orën 16:00 të së njejtës ditë ishte arrestuar mbi bazën e urdhërarrestit të datës 15 Prill 2004.

Avokati Mbrojtës ishte caktuar për interesat e A. K. nga ana e vëllaut të tijë S. S. K. me 9 Dhjetor 2005 (dokumenti 2 i dosjes 1 lidhur me këtë të pandehur).

Prokurori Publik Ndërkombëtar ka paraqitur propozimin për caktimin e paraburgimit dhe me 11 Dhjetor 2005 në orën 15:00 i pandehuri është paraqitur në seancën ndëgjimore për paraburgim.

A. K. ishte i asistuar nga avokati i tijë mbrojtës.

Që nga atëherë A. K. ishte gjithnjë i asistuar nga i njejtë avokat mbrojtës.

Aktakuza kundër këtijë të pandehuri është ngritur me 28 Shkurt 2006 dhe është konfirmuar përmes vendimit të datës 30 Korrik 2006.

Gjykatësi për konfirmim ka drejtuar dhe e ka hedhur poshtë kërkesën e mbrojtjes kundër të gjitha provave të mbledhura gjatë hetimeve në mungesë të klientit të tijë apo të

avokatit që e përfaqson atë. Pika qëndrore e arsytimit të tijë është se as LPP (neni 168) e as KPPPK (neni 237) nuk kërkojnë prezencën e të pandehurit dhe/apo avokatin e tijë për marrje në pyetje të dëshmitarit gjatë fazës së hetimeve.

Kjo Gjykatë ndanë konsideratat e Gjykatësit për Konfirmim.

Prania e avokatit mbrojtës nuk ishte e detyrueshme në pajtim me LPP dhe KPPPK gjatë fazës së hetimeve nëse jo gjatë seancës ndëgjimore për paraburgim dhe në momentin e ngritjes së aktakuzës.

A. K. ishte i asistuar dhe i përfaqësuar në procedurë që nga seanca ndëgjimore për paraburgimin e tijë me datë 11 Dhjetor 2005.

Nuk është gjetur aktakuzë e ndryshuar me datë 27 Korrik 2005 me emërin e këtij të pandehuri, por një aktakuzë e ndryshuar, e lidhur gjithashtu me A. K. të datës 27 Korrik 2006, kur ai është përfaqësuar siç duhet.

Një problem tjetër mund të lidhet me pranueshmërinë e provave, meqë deklaratat e mblldhura pa praninë e të pandehurve apo të avokatëve të tyre mbrojtës.

Ky problem është i adresuar dhe i zgjidhur me nenin 156 paragrafi 2 i KPPPK i cili e njeh pranueshmërinë e këtyre deklaratave "kur të pandehurit apo avokatit mbrojtës ju ipet mundësia ta sfidojë atë me marrjen në pyetje të atijë dëshmitari gjatë ndonjë faze të procedurës penale".

Mundësia ju është dhënë të dyve edhe të pandehurit edhe avokatit të tijë mbrojtës në shqyrtimin gjyqësor.

Deklaratat e dëshmitarëve të cilët nuk janë shqyrtuar nga A. K. (Siç shihen më parë në pikën IV.1 dëshmitari anonim "X", pastaj gjithashtu H. M., F. H. dhe R. B. nuk janë përfshi në vendimin kundër tijë.

6. Ankuesi pretendon se arsytimi (e jo dispozitivi) i vendimit e përmend arrestimin joligjor, paraburgimin, rrahjen dhe torturimin si të qytetarëve Sërbë ashtu edhe atyre Shqiptarë të Kosovës kurse në dosjen e lëndës nuk ka gjurmë të kësaj sjellje kundër Sërbëve të Kosovës.

Kjo pikë është e pabazë dhe irelevante.

Dispozitivi qartë e konstaton se secili i pandehur është i dënuar për shkak të pjesëmarrjes së tijë në arrestimin joligjor dhe paraburgimin, trajtimin jonjerëzor, vuajtjeve tej mase apo shkelje e shëndetit trupor të civilëve Shqiptarë të dyshuar për bashkpunim me Sërbët.

Nuk ka vendim lidhur me sjelljen e bëra ndaj viktimave civilë Sërbë të Kosovës.

Si rrjedhim nuk ka vend për ankesë për këtë pikë.

Ajo që është shkruar në faqet 7 dhe 8 të arsytimit lidhur me politikën e UÇK-së ndaj qytetarëve Sërbë të Kosovës cmun të interpretohet si vërejtje e përgjithshme se çfarë ka mund të ndodh në Kosovë gjatë luftës apo lidhur me komunikatat e UÇK-së ku përmenden sulmet si ndaj Forcave Sërbe ashtu edhe likuidimin e bashkpunëtorëve në Janar/Shkurt 1998 (shih faqen 50 të vendimit të së shkallës së parë).

Sidoqoftë nuk është relevante meqë asnjë rast i civilëve Kosovarë Sërb nuk është i raportuar në dosjen e lëndës.

7. Sipas ankesës deklaratat e dhëna Policisë nga dëshmitarët duhet të hedhen poshtë si të papranueshme, në vend që të përdoren në vendim.

Kjo pikë është e pabazë.

Siç është vërejtur më parë (shih pikën IV.5), neni 156 paragrafi 2 i KPPK e miraton pranueshmërinë e deklaratës së dhënë nga një dëshmitarë Policisë “kur të pandehurit apo avokatit mbrojtës ju është dhënë mundësia që ta sfidojë atë me marrjen në pyetje atë dëshmitarë gjatë ndonjë faze të procedurës penale”.

Me përjashtim të dëshmitarëve të ri (“X”, H M F H dhe R B) të cilët nuk janë marrë në pyetje nga ana e A K apo nga avokati i tij mbrojtës dhe deklaratat e të cilëve nuk janë përdorur kundër këtij të pandehuri, të gjithë dëshmitarët e tjerë janë marrë në pyetje nga ai.

Kështuqë sipas ligjit për procedurë deklaratat e dhëna Policisë gjithashtu janë prova të pranueshme.

AD2 Shkelja e ligjit penal (neni 404 pika 1, 4 dhe 6 i KPPK)

8. Ankesa e sfidon vendimin me hipotezën e ekzistimit të krimit të luftës.

Ankuesi pohon:

- mosekzistimin e konfliktit të mbrendshëm të armatosur në kohën kritike në ato pjesë të Kosovës ku veprat penale i ngarkohen të pandehurit;
- mosekzistimi i organizimit qëndror dhe i strukturës komanduese të UÇK-së në regionet faktike,

- se akuza e planit të përbashkët penal është i supozuar por jo i provuar;

- aplikimi i gabuar i dispozitave të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar, sidhe Protokolit II të katër Konventave të Gjenevës;

- fakti se krimi i luftës kundër popullatës civile nuk mund të rezultojë nga sjelljet të cilat janë individuale, josistematike dhe të shtrira gjërësisht dhe nuk janë të bazuara në diskriminim

- në vendim asnjë dëshmi nuk është prezentuar lidhur me shkeljen e nenit 5.1 të Protokolit II të katër Konventave të Gjenevës: pra për mungesën e ushqimit, ujit të pishëm, kujdesi për shëndetin dhe higjienën e të paraburgosurve, asnjë krahasim nuk është bërë në mes të kushteve të fundit dhe i popullatës civile në atë territor.

Pikat lidhur me ekzistimin e konfliktit të brendshëm të armatosur si dhe me organizimin e UÇK-së, gjithashtu edhe pika që ka të bëjë me akuzën e ndërmarrjes së përbashkët penale tashmë janë adresuar në pjesën e parë të këtij vendimi (shih pikat I.2 dhe I.3)

Sa i përket pikave të tjera, duhet vëretjru si në vijim:

8.1 Mbrojtja e sfidon pjesën e dispozitivit ku thuhet se i akuzuari “i ka paraburgosur në kushte jo humane pa patur akses në proces” viktimat.

E drejta për “proces të përkatës” është e paraprirë në nenin 6 të Protokolit II në katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949.

Mirëpo neni 2.2 i protokolit të njëjtë e parashikon se “në fund të konfliktit të armatosur, të gjithë personat që kanë qenë të privuar nga liria.... për arsësyet që kanë të bëjnë me atë

konflikt... duhet të gëzojnë mbrojtjen e neneve 5 dhe 6 deri në përfundimin e atij lloj privimi apo kufizimi të lirisë”.

Kjo do të thotë se mbrojtja e neneve 5 dhe 6 nuk gjen aplikim giatë konfliktit, por vetëm në përfundimin e tij.

Pra sipas mbrojtjes, cdo referim në këtë vendim në “proces përkatës” është i gabuar.

Kjo pikë është në fakt e pabazë.

Vendimi i Shkallës së Parë si në dispozitiv ashtu edhe në arësyetim është qartë e referuar vetëm në krimin e luftës për trajtim jo human dhe vuajtje pa masë apo shkelje e shëndetit trupor të të paraburgosurve civilë, që përbën aplikimin e masave të frikësimit dhe terrorizimit që përbën shkelje të ligjit kombëtar (nenet 142, 22, 26 dhe 30 KP RSFJ) dhe ligjit ndërkombëtar (neni 3 i lidhur me Konventat e Gjenevës, CA3, dhe Protokoli Shtesë II të Konventave të Gjenevës, PSHII).

Çdo referim në procesin e drejtë është bërë vetëm me qëllim të sqarimit të situatës materiale nën të cilat të paraburgosurit kanë vuajtur, por nuk ka asnjë ndikim në dispozitat ligjore të aplikueshme.

Me fjalë të tjera, të pandehurit nuk janë dënuar se nuk kanë respektuar të drejtat e të paraburgosurve, për shkak të procesit të drejtë të ligjit, por, për shkak se kanë rrahur, turpëruar, dhe ndarë tërësisht nga familjet e tyre, dhe i kanë mbajtur në kushte degraduese, gjithashtu edhe lidhur me shëndetin dhe higjenën e tyre.

Vendimi i sfiduar, (faqja 62) e pranon se në rastin e konfliktit të brendshëm të armatosur, e drejta për të arrestuar dhe mbyllur civilët mund të “implikohet nga gjuha” e përdorur nga CA3 and dhe nga Protokoli Shtesë II (PSHII). Pavarësisht, e drejta për tu trajtuar në mënyrë humane është shprehimisht e garantuar.

Prandaj, nuk ka dënim për shkelje të garancave të parapara në nenin 6 të Protokolit Shtesë II dhe këtu nuk ka bazë për këtë pikë që të ankohet.

Mund të shtohet vërtetimi se Protololi II ka për qëllim të zhvillojë dhe të plotësojë nenin 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës (CA3) dhe jo për ta ndryshuar atë, si që gabimisht e ka paraqitur ankesa në favor të A. K.

Për këtë, Protokoli II nuk e modifikon apo pjesërisht abrogon por thjesht e integron dhe rrit shumë dispozitat e përgjithshme të CA 3.

Kjo veçanërisht është në rastin e “garancive thelbësore” (neni 4 APII), kjo në njërin anë është obligim për të trajtuar të gjithë personat në mënyrë humane në të gjitha kushtet ata të cilët nuk kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në luftime dhe në anën tjetër ndalimi i asnjë a) shkelje e jetës, shëndetit dhe aftësisë fizike dhe mendore të personave, në vecanti vrasja si dhe trajtimi mizor sic është tortura, gjymtimi apo ndonjë formë dënimi me vdekje ... e) shkelje e dinjitetit personal, në vecanti trajtimi turpërues dhe degradues ... h) kërcënimi për të kryer vepra të mëparshme.

Të gjitha këto dispozita tashmë përmbahen në CA3, edhe pse në një formë më pak të detajuar.

Në CA3 gjithashtu përmbahet edhe ndalimi i “d) aprovimi i dënimit dhe aplikimi i ekzekutimeve pa vendim paraprak i shpallur nga një gjykata e aprovuar në mënyrë të

rregullt, i cili i ofron të gjitha garancitë juridike të cilat janë të njohura si të domosdoshme nga popullata e civilizuar”.

Ky është thelbi i procesit të drejtë ligjor dhe aplikimit i CA3 nuk është i kufizuar për kohën “në fund të konfliktit të armatosur”.

Për këtë, cdo referim në procesin e drejtë të ligjit në vendimin e shkallës së parë nuk mund të shihet si i papërshtatshëm.

Çdo shqyrtim tjetër në këtë pikë mund të duket i tepërt sa i përket objektit të këtij vendimi.

Pavarësisht, mund të ketë dyshim se interpretimi i drejtë i nenit 2.2 të PSHII është ai që i ka dhënë avokatët mbrojtës dhe para tij nga Gjykata Supreme e Kosovës në lëndën L. G. dhe të tjerët (AP-KZ 139/2004), sipas të cilit neni 6 i APII nuk mund të aplikohet deri në fund të konfliktit të armatosur.

Dyshimet janë të dy llojeve: logjike dhe gabimet në shtyp.

Dyshimi logjik mund që të jetë se një konventë ndërkombëtare, e dedikuar që të mbrojë individët e paarmatosur nga rreziku i konfliktit të mbrendshëm të armatosur, mund që në disa pjesë të mos gjejë aplikimin gjatë konfliktit por vetëm pas tij, kur rreziku dhe arsytet për mbrojtje kanë pushuar apo së paku janë të vogla.

Në të vërtetë, paragrafi i fundit i nenit 6 përmbanë një dispozitë (sa i përket amnestimit të personave të cilët kanë marrë pjesë në konfliktin e armatosur) i cili aplikohet vetëm “në fund të në fund të luftimeve”.

Kjo do thotë që, në pajtim me tekstin e nenit 6, dispozitat e tjera duhet të gjejnë aplikim gjithashtu gjatë konfliktit.

Si duket më e preferueshme do të ishte interpretimi i ApII neni 2.2 i cili nuk e kufizon por e zgjat mbrojtjen e individëve.

Meqë LNH (Ligji Ndërkombëtar Humanitar), si Konventat e Gjenevës dhe Protokolet Shtesë të tyre i referohen kohës së luftës apo konfliktit të mbrendshëm të armatosur¹⁸ është e qartë, pa një dispozitë të veçantë, që nuk mund të aplikohet në kohën e pas konfliktit.

Në këtë rast neni 2.2 e shqyrton situatën e privimit të lirisë të të burgosurve për arsytet që kan të bëjnë me konfliktin, situata e garantuar, por e pa përfunduar gjatë konfliktit.

Në lidhje me këta persona këto dispozita i zgjasin garancitë e nenit 5 dhe 6, të cilat janë në fuqi gjatë konfliktit, për periudhën pas konfliktit dhe derisa paraburgimi i tyre zgjatë.

Neni 2.2 i PSH nuk duhet të lexohet në kuptimin që jo vetëm në fund të konfliktit por në kuptimin që gjithashtu edhe në fund të konfliktit këto garancione të gjejnë aplikim.

Këto interpretime duket se janë më qëndrueshme me qëllimet njerëzore ku bazohen Konventat e Gjenevës sidhe Protokolet Shtesë.

Në këtë kuptim duhet mbajtur në mend vendimi i Dhomës së Apelit të Tribunalit për Jugosllavinë në lëndën Prokurori kundër Dusko TADIC (paragrafi 67-69)¹⁹.

¹⁸ Neni 2 i Konventës së Gjenevës IV: “për më tepër dispozitat të cilat do të implementohen në kohë të paqes, Konventa e tanishme do të aplikohet në të gjitha rastet e deklarimit të luftës apo të ndonjë konflikti të armatosur”; Neni 1 i PSH II: “ky protokol... do të aplikohet në të gjithasha konfliktet e armatosura”.

¹⁹ Prokurori kundër Dusko TADIC, 2 Tetor 1995 vendimi në kërkesën e mbrojtjes për ankesë kalimtare mbi Jurisdikcionin.

“67. Ligji humanitar ndërkombëtar mbikqyrë sjelljen konfliktet e armatosura si ato kombëtare dhe ndërkombëtare. Ankuesi me të drejtë potencon se për të patur aty shkelje të këtij ligji, aty duhet të ketë konflikt të armatosur. Definicioni i "konfliktit të armatosur" mvaret varësisht nëse luftimet janë ndërkombëtare apo kombëtare por, përkundër pretendimit të Ankuesit, sfera e përkohshme dhe gjeografike e konflikteve kombëtare dhe atijë ndërkombëtar zgjatet përtej kohës dhe vendit të saktë të luftimeve. Sa i përket kornizës së përkohshme të referimit të konfliktit të armatosur ndërkombëtar, secila nga katër Konventat e Gjenevës përmban gjuhën që aludon se aplikimi i tyre mund të zgjatet përtej ndërprerjes së luftimit. Për shembull, të dyja Konventat I dhe III aplikohen derisa personat e mbrojtur të cilët kanë mbetur nën pushtetin e armikut janë liruar dhe riatdhesuar ...

69. Referimi gjeografik dhe i përkohshëm për konfliktet e brendshme të armatosura është po ashtu e gjerë. Ky koncept reflektohet në faktin se përfituesit e nenit të përbashkët 3 të konventave të Gjenevës janë ato që janë pjesë aktive (ose nuk janë më pjesë aktive) në veprime ushtarake. Kjo tregon se rregullat që përmban neni 3 aplikohen gjithashtu në konceptin e ngushtë gjeografik të arenës aktuale të veprimeve në luftim. Në mënyrë të ngjashme, gjuha e përdorur në Protokolin II të Konventave të Gjenevës (një traktat i cili, sic do ta shohim në paragrafet 88 dhe 114 në vijim, mund të konsiderohet si i aplikueshëm në disa aspekte të konflikteve në ish-Jugosllavi) sugjeron gjithashtu një kufi të gjerë. Së pari, ashtu si neni 3, ai mbron shprehimisht "të gjithë personat që nuk kanë marrë pjesë drejtpërdrejtë ose kanë reshtur së marri pjesë në veprime ushtarake." (Protokoli Shtesë i Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe që ka Lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosur Jo-Ndërkombëtarë, 12 dhjetor 1977, neni 4, para.1, 1125 U.N.T.S. 609 (këtej e tutje Protokoli II). Neni 2, paragrafi 1, thotë:

"ky Protokol do të aplikohet [. . .] për të gjithë personat të *afektuar* në konfliktin e armatosur siç është definuar në nenin 1."(Id. Në nenin 2, para. 1 (shtuar theksimi).)

E njëjta dispozitë është përcaktuar në paragrafin 2 që:

"[N]ë fund të konfliktit, të gjithë personat të cilët kanë qenë të privuar nga liria ose liria e të cilëve ka qenë e kufizuar për arësyet e lidhura më konfliktin, si dhe ata të privuar nga liria e tyre apo liria e të cilëve është kufizuar pas konfliktit për arësyet të njëjta do të gëzojnë mbrojtjen e nenit 5 dhe 6 deri në fund të këtij privimi apo kufizimi të lirisë."(Id. Në nenin 2, para. 2.)

Sipas kësaj dispozite së fundit, kufiri i përkohshëm i rregullave të aplikueshme është e qartë që i tejkalon veprimet ushtarake aktuale. Për më tepër, natyra relativisht e gjerë e përdorimit të gjuhës "për arësyet që kanë lidhje më një konflikt të tillë", sugjeron edhe një kufi të gjerë gjeografik gjithashtu. Lidhja që kërkohet është vetëm një lidhje mes konfliktit dhe privimit të lirisë, jo që privimi të jetë shkaktuar në mes të betejës".

8.2 Sipas ankesës krimi i luftës kundër popullatës civile nuk mund të shkaktohet si pasojë e sjelljeve individuale, jo sistematike dhe të shpërndara dhe të cilat nuk janë të bazuara në diskriminim.

Provat e mbledhura në këtë lëndë tregojnë se sjelljet për të cilat akuzohen të pandehurit nuk ishin individuale por sistematike dhe të shpërndara.

Numri dhe karakteristikat e viktimave, kohëzgjatja e paraburgimit të tyre, organizimi i qendrave të paraburgimit me ndërtesën ku gjendej, numri i kryesve të veprës, qëllimi i paraburgimit dhe marrja në pyetje janë të gjithë elementë të cilat e mohojnë supozimin e mbrojtjes.

Jo vetëm individët e thjeshtë kanë kryer krime kundër individëve të tjerë, por anëtarët e një organizate (UCK) kundër personave të dyshuar që të jenë anëtarë apo së paku bashkëpunëtorë të një organizate tjetër (Ushtria Serbe).

Menaxhimi i Qendrës së Paraburgimit ka zgjatur për disa muaj dhe ishte organizuar në ndërtesat e vecanta, ku secili aktor ka patur role specifike për të komanduar, arrestuar, mbikqyrur, marrjes në pyetje dhe rrahjen e të paraburgosurve.

Kjo mund të konsiderohet që ka qenë sistematike dhe me karakter të gjerë.

Sa i përket diskriminimit, këtu mund të thirremi në atë çka është parë me lart: fakti që të dy të pandehurit si dhe viktimat ishin shqiptarë të Kosovës, nuk e përjashton në vetvete ekzistencën e krimit të luftës meqë ky ka qenë një konflikt i brendshëm i armatosur, dmth konflikt në mes njerëzve që kanë jetuar në të njëjtin shtet dhe herë herë i kanë takuar të njëjtës kombësi.

Në fakt, viktimat kanë qenë të dyshuara nga UCK-ja të kenë qenë bashkëpunëtor të Serbëve, do të thotë tradhëtarë të popullit të vet në favor të armikut.

Të dyshuarit se i takon armikut në vetvete është formë e diskriminimit.

8.3 Përfundimisht, sa i përket kushteve të të paraburgosurve dhe krahasimi me kushtet e popullatës civile mund të vërehet si në vijim.

Më 13 korrik 1998 "B" takoi Bedri Berishën i cili ishte shumë i dobët, i kishte lidhur pantallonat me litar, ishte i parruar dhe shumë i uritur, kërkoi ushqim por "B"-së nuk i është lejuar që të sjellë ushqim, ka qajtur dhe ka kërkuar të shohë vajzën e tij, mirëpo edhe kjo ishte e pamundur.

Këmisha dhe pantallonat e B [redacted] B [redacted] ishin me shenja gjaku.

"B"-ja nuk ishte më i lejuar të vizitonte B [redacted] B [redacted] përkundër faktit që dëshmitari shkoi në Drenovc më shumë se 30 herë.

“N”-ja dhe “TT”-ja ia arritën një herë të vizitojnë H [REDACTED] K [REDACTED] në Qendrën e Paraburgimit në Drenovc.

H [REDACTED] ishte në gjendje shumë të keqe, kishte humbur shumë peshë, ishte i parruar, dhe kishte thonj të paprerë, të veshurat me shumë baltë, meqë ai flinte në shtalla të baltosura për tri javë dhe kishte njolla gjaku: të gjitha këmishat kishin njolla gjaku.

Vizita ka ndodhur në prezencë të tre oficerëve të policisë të cilët e bënë të qartë që biseda me të paraburgosurin ishte lejuar vetëm për çështje familjare.

“N”- shtoi se i kishte treguar G [REDACTED] P [REDACTED] se “N”-ja dhe TT-ja ishin njerëzit e parë në tërë Kosovën që kishin privilegjin që të vizitojnë të paraburgosurin.

I [REDACTED] B [REDACTED] i ka treguar “TT”-së se njerëzit brenda Qendrës së Paraburgimit janë mbajtur si kafshët dhe janë keqtrajtuar.

Edhe pse H [REDACTED] P [REDACTED] nuk ka bërë asgjë të keqe, ai është mbajtur dhe i është propozuar për një ndërrim me N [REDACTED] P [REDACTED], i cili njihej si bashkëpunëtor i Serbëve.

Këtë kusht R [REDACTED] ia ka komunikuar “Z”-së dhe më vonë e ka konfirmuar edhe S [REDACTED] K [REDACTED]

“Z” e vizitoi H [REDACTED] vetëm një herë dhe nuk ka vërejtur te ai lëndime. Megjithatë H [REDACTED] nuk ka dashur ti ndërroj të veshurat e tijë.

“O” tregoi se e kishte takuar H [REDACTED] P [REDACTED], H [REDACTED] T [REDACTED] dhe një të paraburgosur tjetër në qendrën e paraburgimit të Malishevës në ditët pas 20 ose 21 Korrikut 1998, ku i kaloi gjashtë ditë.

Trupat e H [REDACTED], H [REDACTED] dhe i një të treti dukeshin të ënjtura dhe me mavijosje, ata thanë që kishin qenë të paraburgosur në fshatin e Drenovcit dhe se ishin rrahur shumë herë.

“A” takoi B [REDACTED] B [REDACTED] dhe H [REDACTED] P [REDACTED] në Qendrën e Paraburgimit: B [REDACTED] e kishte faqen e djathtë shumë të ënjtur “sikur të kishte të varura dy kilogram material aty”; H [REDACTED] ishte i mbuluar në gjak.

“A” takoi dy të paraburgosur të tjerë S [REDACTED] S [REDACTED] dhe H [REDACTED] K [REDACTED], që të dy ishin me gjak.

S [REDACTED] S [REDACTED] “memzi mund të ja shihje sytë”, ai ishte i shkurtër por shumë i fortë dhe ka treguar “durim të madh edhe pse ata e rrahën shumë keq”.

Gjithashtu “A” ishte i rrahur me shkop dhe i shqelmuar në tërë trupin dhe ka pësuar lëndime personale, dyshemeja oshte e mbuluar me gjak.

Në Qendrën e Paraburgimit nuk kishte ujë për të larë veten, “A” dhe të tjerët janë quar jashtë në disa gropa me ujë brenda.

Toaleti, “vetëm për nevojat e juaja personale”, ishte në koridor.

Nuk ishin të lejuara vizitat dhe buka e uji i janë sjellur “A” nga I [REDACTED] B [REDACTED]

Të afërmeve të M [REDACTED] R [REDACTED] nuk u është lejuar që ta vizitojnë atë.

Sidoçoftë N [REDACTED] R [REDACTED] ka dëgjuar dikë duke uluritur brenda qendrës së paraburgimit.

“O” ka njohur fotografinë e M [REDACTED] R [REDACTED] duke shtuar se të paraburgosurit që ai ka takuar në Malishevë thanë që M [REDACTED] ka vdekur si pasojë e rrahjeve.

"E" ishte i paraburgosur dhe i rrahur në Drenovc siç shihej nga fotografitë e vrageve (shenjave të lëndimit) të tijë.

Ai ishte i paraburgosur për tri ditë e tri netë gjatë së cilës kohë atijë nuk i është dhënë asgjë për të ngrënë dhe pirë.

"E" i është dashur të flejë në dysheme të dhomës ku mbahej qymyri pa asnjë batanije për tu mbuluar.

Ai nuk kishte pajisje të toaletit dhe ai duhej ta ndihmojë veten në të njejtën dhomë ku ai flinte.

"E" nuk i lejohej të lante gjakun e tijë.

"U" ishte arrestuar, dërguar në Drenovc dhe rrahur për arsytet tashmë të shqyrtuara.

Pasi ai mohoi ato që kishte thënë, "U" u lirua.

"E" ishte arrestuar, dërguar në Drenovc, marrë në pyetje dhe rrahur nga S [REDACTED] K [REDACTED] aq fortë sa që ai u rrëzua, të rrahurat i kishte në hundë prej së cilës dilte gjak. Një ditë më parë djali i tijë gjithashtu ishte rrëmbyer nga UÇK-ja, pastaj i marrun në pyetje dhe i rrahur nga i pandehuri.

Të gjitha elementet e lartpërmendura japin një shpjegim të kushteve nën të cilat u mbajtën të paraburgosurit në Drenovc, kushte të cilat mund të cilësohen si "çnjerëzore".

Ato kushte nuk kanë të bëjnë asgjë me ato të popullatës civile të të njejtës zonë, pra të Drenovcit dhe rajonit përreth.

Është jashtë çdo dyshimi se popullata civile vuajti nga vështirësitë dhe privimi që dolën nga konflikti.

Megjithatë ata civilë nuk ishin në paraburgim, nuk u rrahën apo u kërcnuan nga UÇK-ja, kishin mundësi të kërkonin ushqim dhe gjëra tjera, nuk ishin të ndarë nga familjet e tyre. Për këto arsye kushtet e të paraburgosurve ishin pakrahasueshëm më të vështira se sa popullata lokale civile.

9. Ankesa pohon pretendimin e shkeljes së nenit 22 të KP të RSFJ për shkak të mungesës së dëshmisë për A [REDACTED] K [REDACTED] lidhur me pjesëmarrjen e tijë materiale në krim dhe për dëshirën e tijë që të marrë pjesë në atë, dhe

- pretendimi i shkeljes së nenit 26 të KP të RSFJ meqë UÇK-ja nuk ishte bandë apo grupim kriminal dhe se të tre të pandehurit nuk e kanë organizuar shoqatën e përbashkët kriminale.

Sa i përket pjesëmarrjes së A [REDACTED] K [REDACTED] në veprat penale për të cilat akuzohet duhet që të lexohet në Vendimin e Shkallës së Parë (faqet 94 – 98) se ky i pandehur personalisht ka rrëmbyer H [REDACTED] K [REDACTED] (dëshmitarët "N" dhe "TT") dhe M [REDACTED] R [REDACTED] (dëshmitarët N [REDACTED] dhe H [REDACTED] R [REDACTED] rrëmbeu dhe e rrahu "U".

A [REDACTED] K [REDACTED] është parë nga dëshmitarët duke vepruar si rroje i ndërtesave të Qendrës së Paraburgimit të Drenovcit, ku ai ishte anëtarë i Policisë Ushtarake (për këtë pikë shih deklaratën e S [REDACTED] K [REDACTED] dhënë para Gjykatësit Hetues me 18 Shkurt 2004 faqja 9).

A [REDACTED] K [REDACTED] ishte drejtëpërsëdrejti i involvuar, si Polic Ushtarak, në menagjimentin e Qendrës së Paraburgimit: prej tijë "TT" kërkoi lejen për ti dorëzuar të veshurat H [REDACTED] K [REDACTED] dhe nga ai "TT" pranoi ato të palara të cilat ishin me njolla gjaku.

Oficeri i Policisë, I [REDACTED] B [REDACTED] më vonë gjatë luftës i vlarë, i tha "TT" se njerëziz brenda Qendrës së Paraburgimit mbaheshin sikurse kafshët dhe keqtrajtoheshin.

"TT" ishte ushtarak në Drenovc, për këtë ai mund të vrojtonte se çfarë ndodhte në Qendrën e Paraburgimit.

Siç është parë më parë, "Z" shkoi në Drenovc për të kërkuar H. P. Nga I. B. ai u informua se A. K. dhe R. ishin ata që merrnin pjesë në keqtrajtimet dhe rrahjen e të burgosurve nëse ato janë bërë (dëshmia para Gjykatësit Hetues me 8 Shtator 2004 faqja 6).

Në Drenovc "Z" e ka parë H. me duart e lidhura apo të prangosur, të shoqëruar nga A. K.

"Z" ka shkuar në Drenovc shumë herë dhe çdo herë ka takuar A. K. në shkollë apo ndërtesat e Policisë Ushtarake duke u marrë me detyra të mbikqyrjes dhe kontrollimit të vizitorëve.

"U" ka deklaruar se ka qenë i arrestuar nga A. K. dhe më vonë i rrahur nga i njëjti me shkop.

Këto elemente e bazojnë provën e pjesëmarrjes direkte dhe të qëllimshme, në pajtim me nenin 22 të KP të RSFJ, të të pandehurve për krimet që akuzohen.

Ai ishte anëtarë i Policisë Ushtarake dhe ka shërbyer në Stacionin Policor të Drenovcit, ku të paraburgosurit keqtrajtoheshin dhe ai këtë e ka ditur mirë (ballafaqimi i ngjarjes me të veshurat e H. K. të njollosura me gjak, të cilat u dorëzuan nga ana e të pandehurit, ballafaqimi se çfarë ju tha I. B. dëshmitarëve "TT" dhe "Z" dhe ngjarja e lidhur me "U").

"Si rrjedhim A. K. ishte pjesë e ndërmarrjes së bashkuar kriminale i akuzuar në pajtim me nenin 26 të KP të SFRJCC SFRY për të gjithë të pandehurit.

Se UÇK-ja nuk ishte bandë kriminale por ishte përdorur nga disa pjestarë të sajë për qëllime kriminale kjo është studiuar më herët (shih pikat I.3 dhe III.2).

AD3 Përcaktimi i gabuar dhe jo i plotë i situatës faktike

10. Sipas ankesës në kohën kritike i pandehuri A. K. ishte në Prishtinë, duke studiuar në Fakultetin Juridik dhe jo në vendin e kryerjes së veprave penale.

Vetëm më vonë, diku rreth 21 apo 22 Qershorit, ai ju bashkua djemve të rinjë që bënë rroje në fshatin e tij dhe shkoi në Shqipëri ku atje qëndroi afërsisht tri javë nga fundi i Qershorit deri më 27 apo 28 Korrik me qëllim të gjetjes së armëve.

Vendimi i Shkallës së Parë e ka shqyrtuar këtë pikë në faqet 95 – 98, ku janë ekzaminuar deklaratat e dëshmitarëve lidhur me pjesëmarrjen e të pandehurve në veprat penale, mbrojtja e A. K. dhe deklaratat e dëshmitarëve në mbrojtje të S. D. K.

Kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

Dëshmitarët e prokurorisë japin data të cilat janë të ndryshme nga ato që tregohen nga i pandehuri: "N" dhe "TT" flasin për 4 Qershorin si datë e rrëmbimit të H. K. nga A. K. dhe ushtarët tjerë, N. and H. R. përcaktojnë 10 Qershorin si datë e rrëmbimit të M. R. nga i njëjti i pandehur, "U" tregon datën e 16 Qershorit si datë kur ai vetë u rrëmbye nga ky i

pandehur, "Z" tregon se 16 Qershori ishte dita e parë që ka takuar A K në Stacionin e Policisë në Drenovc.

Këta dëshmitarë nuk shihet të kenë patur arsye për ta shantazhuar të pandehurin, e as që A K ishte në mundësi për të treguar këto lloj të arsyeve.

Alibi i të pandehurit për ditët para 20 Qershorit 1998 duket i dobët.

Ai marrë pjesë në studime të Juridikut në Prishtinë, por fakulteti zyrtarisht ishte i mbyllur nga Sërbët që nga viti 1990.

Rrjedhimisht ai dhe studentët tjerë Shqiptarë ti ndjekin ligjeratat fshehurazi në shtëpitë private.

Pjesmarrja e tij në ligjerata në periudhën kritike nuk mund të vërtetohet siç me të drejtë e ka vrojtuar gjykatësi i shkallës së parë.

Tregimi i tij për udhëtimin nga Prishtina në Dejne nuk e provon datën e këtij udhëtimi. I pandehuri pohon që ka qëndruar tri javë në Shqipëri, por ai ka mundur të ofrojë si provë vetëm dëshminë e S D K në të cilën ai ka thënë se ky person është kthyer në Kosovë pas dy ditësh.

I pandehuri e ka dëgjuar lajmin për arrestimin e bashkë të pandehurve gjatë vitit 2004, dhe e ka parë si më të arsyeshme të ikë nga Kosova në vitin 2005.

Dëshmia e S K duket jo e besueshme nga gjykatësi i shkallës së parë.

Ky dëshmitar ka rënë në kontraditë kur ka thënë se ka patur interes të vecantë për studimet e të pandehurve përderisa ka qenë jashtë shtetit, kurse që nga fundi i prillit 1998, kur ishte në Kosovë nuk është interesuar më për këto studime.

Dëshmitari ka deklaruar që e ka takuar të pandehurin më 19 qershor dhe se ka shkuar në Shqipëri me të në fund të qershorit, por nuk mund të pohojë ku ka qenë A K përpara 19 qershorit dhe gjatë ditëve pasi dëshmitari është kthyer nga Shqipëria në fillim të korrikut.

Sic është parë tashmë në alibinë e S K udhëtimi në dhe prej Shqipërisë mund të kishte zgjatur më ditë të tëra ose vec disa orë, dhe nuk ka prova të bindshme se A K ka qenë jashtë Kosovës dhe Drenovcit gjatë gjithë kohës që ai pretendon.

Ankesa pretendon një vlerësim të gabuar të dëshmisë së dëshmitarëve "Z", "N", "U", "X".

Përsa i përket "X"-it, duhet të ceket se dëshmia e tij nuk është përdorur nga gjykatësi i shkallës së parë lidhur me këtë të pandehur.

Sa i përket dëshmitarëve të tjerë, dëshmitë e të cilëve janë ekzaminuar më herët (shiko pikat IV.9 dhe IV.10) mund të shtohet si në vijim.

"Z"-i nuk e shpjegon një "thashethem" kur tregon se cka ka mësuar nga I B por një dëshmi de relato, e cila është e pranueshme dhe duhet të vlerësohet me kujdes

përderisa personi që i ka treguar këto fakte nuk mund të ekzaminohet për shkak të vdekjes apo shkaqeve të tjera.

Përsa i përket I B dhe pjesëmarrjes së tij në qendrën e paraburgimit të Drenvocit, për këtë tregojnë dëshmitarët "TT", "Z" dhe M B, atë se çfarë u ka thënë K B, gjithashtu lidhur me të pandehurin, duket si logjike dhe konsistente dhe nuk ka dëshmi se ai u ka thënë "thashetheme" dëshmitarëve.

"N" dhe "TT" konfirmojnë se A K e ka rrëmbyer personalisht H K.

"U"-ja ka deklaruar se ka qenë i arrestuar nga ana e A K dhe më vonë i rrahur me shkop nga i njëjti.

12. Sipas ankesës, gjykatësi i shkallës së parë gabimisht e ka konsideruar si krim luftë faktin e përfshirjes si viktimë M R, i cili ishte rezultat i një konflikti privat të mëparshëm.

Kjo pikë tashmë është ekzaminuar dhe refuzuar më parë (shih pikën më lart II.17.1).

Kjo ngjarje ka ndodhur brenda kontekstit të detyrave zyrtare të ushtruara nga të pandehurit si pjesë e strukturës së UCK-së.

Në rastet e M R dhe të dëshmitarit "U", kryerësit kanë mundur të arrestojnë, rrahin dhe ti kërcënojnë ata për të shkaktuar dëm më të madh vetëm se si pjesëtarë të UCK-së ata kanë kontrolluar zonën, kanë ushtruar pushtetin e policisë, dhe kanë patur pushtet konkret mbi civilët.

Dhe sjellja konkrete nuk ishte ndryshe nga ajo që kanë përdorur kundër viktimave të tjera.

Përkundër arsyeve të mundshme private të fshehura, veprimet ilegale ishin të mundura vetëm përmes ekzistencës së konfliktit, në sajë të kontrollimit të asaj zone të përfshirë në konflikt, që ishte UCK-ja, dhe nëpërmjet keqpërdorimit të kësaj organizate për qëllime kriminale nga ana e të pandehurve.

AD4 Vendimi mbi sanksionet kriminale

13. Ankesa pretendon se vendimi është i padrejtë duke i dënuar të pandehurit me të njëjtin dënim prej 7 viteve, duke mos marrë parasysh sjelljet e ndryshme, moshat dhe shkallën e përgjegjësisë kriminale.

Sipas apeluesit, vendimi është i padrejtë përsa i përket dënimit, gjithashtu në krahasim me vendimet e Tribunalit të Hagës, të cilat janë cituar nga gjykatësi i shkallës së parë: ai i referohet dënimeve të ngjashme të cilat janë shqiptuar për krime më serioze.